


DITURIA ISLAME

Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës
Tryezë shkencore



Muharrem Blakçori
shqipëruet i Kuranit Fisnik

(Jeta dhe vepra)
(1894 - 1968)



6 qershor 2024, Prishtinë

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 404 • KORRIK 2024

RRUGA E ZOTIT ËSHTË TRIUMFI

ZEKATI I KULTURAVE BUJQËSORE

FLLADE MËSHIRONJËSE
NGA VENDET E SHENJTA



EDITORIAL

- 4 Kurthi i tundimit dhe imunizmi kundër tij

HYTBE


- 5 Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Kurban Bajramit

FETARE

- 8 Jeta dhe vepra e Ali Jakup Xhenkçilerit nga Gjilani
Bünyamin Albayrak
- 12 Kërkimi i mbrojtjes të Zotit në këndvështrimin e kaptinës El Felek
Dr. Valmire Batatina – Krasniqi
- 16 Krijimi i Ademit sipas Imam Maturidiut
Dr. Osman Nuri Demir
- 20 Zekati i kulturave bujqësore
Dr. Muhamed Stublla
- 24 Rrugë e Zotit është triumfi!
Granit Sadiku
- 28 Kush është “Ebu Bekri” yt?!
Blerim Musliu
- 30 Seuda bint Zumah – e veja që e martoi Pejgamberi a.s.
Samire Bilalli
- 33 Fllade mëshironjëse nga vendet e shenjtë
Mimoza Sinani

FAMILJE & EDUKIM

- 36 E drejta e grave për punë
Dr. Violeta Smajlaj
- 40 Ruajtja e distancës në raportet tona
Mr. Arton Musliu
- 42 Prindërit dhe fëmija që ti ke, jo fëmija që ti doje...
Entela Hidri



AKTUALITET

- 44 Ndikimi i pavarësisë së Kosovës në përmirësimin e statusit të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut
Murtezan Idrizi

PERSONALITETE

- 46 Jeta dhe personaliteti shkencor i mufesirit bashkëkohor, Muhamed Ali Sabunit
Blerton Bahtiri
- 49 Kontributi i Ibën Mexhidit (1430 – 1500) në zhvillimin e shkencave të gjeografisë
M.sc Artan Mehmeti

HISTORI


- 52 Medreseja “Alauddin” në Prishtinë dhe rrugëtimet e saj
Azmir Jusufi
- 55 Dokumentet arabe në arkivat shqiptare
Mr. Vehbi Shatri
- 58 Historia mbi 100-vjeçare e takimit emocionues ndërmjet babis dhe të birit në haxh
Agron Canolli

REPORTAZH

- 58 Udhëtimin që nuk e përshkruajnë dot fjalët
Bajram Zeqiri

AKTIVITETE

- 63 U mbajt Tryezë shkencore kushtuar shqipëruetit të Kuranit, Muharrem Blakçorit



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 404 • viti 38 • Korrik 2024
• Dhul-Hixhe 1445 - Muharrem 1446
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"IliriPrint", Prishtinë



“Do të ketë (gjithnjë) thirrës pranë portave të zjarrit – xhehenemit, kush iu përgjigjet atyre, ata e hedhin në zjarr. Ata janë njerëz që i përkasin lëkurës sonë dhe flasin me gjuhët tona...”

(Muhamedi, a.s.)

Kurthi i tundimit dhe imunizmi kundër tij

Për aq kohë sa ka jetë në tokë, këtu do të mbetet e gjallë mosmarrëveshja ndërmjet të vërtetës dhe të kotës, si dhe do të mbetet dinamik “konflikti” ndërmjet së mirës dhe të së shëmtuarës. Pasuesit e dy rrugëve të kundërta do të vazhdojnë të ftojnë njerëzit në rrugët e tyre. I Dërguari ynë i fundit, Muhamedi a.s. mbetet përfaqësuesi më besnik i thirrësve në rrugën e drejtë të Zotit. Ai, me besnikëri, fton në atë që kishin ftuar paraardhësit e tij nga pejgamberët e Zotit. Nuk dridhte gjuhën e tij për të mashtruar askënd, e as nuk lajkatonte fjalët që të lajthiste asnjë njeri. Përkundrazi, kishte durimin dhe priste derisa edhe përfaqësuesit e rrugës së gabuar, idhujtarët, ateistët e femohuesit të përfundonin fjalët e tyre, e pastaj fillonte duke cituar fjalët e Allahut. Në një takim që pati me të Utbe ibën Rebian – idhujtar arab, në tentim që ky i fundit po e bënte që t’ia mbushte mendjen të Dërguarit të Zotit që të hiqte dorë nga misioni i tij, ai e dëgjoi Utben deri në fund, e tek pastaj i tha: “A e përfundove çfarë pate për të thënë o Ebu Velid?” Ai tha: “Po!” Atëherë i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, filloi të lexonte ajetet e kaptinës Fussilet: “Ha, Mimë. I zbritur prej Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Libër që ajetet e tij janë të shkoqitura, duke qenë Kuran arabisht për një popull që di ta kuptojë. Është përgëzues dhe qortues, po shumica e tyre ia kthyen shpinën, andaj ata nuk dëgjojnë...” (Fussilet, 1-4). Muhamedi a.s., ashtu siç ishte skajshmërisht i sinqertë përderisa lexonte të vërtetat e Kuranit publikisht para njerëzve, por me po të njëjtin pasion e sinqeritet, sqaronte për të gjithë për rrezikun e atyre që i kanë vënë detyrë vetes mashtrimin e lajthitjen e shoqërive njerëzore. U rrëfente për ata njerëz që gjatë gjithë historisë, do të gjinden buzë rrugës së drejtë, e që me zërin e tyre kumbues do të ftojnë njerëzit që të braktisin rrugën e besimit. I Dërguari ynë, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, i përshkruante të tillët si “thirrës pranë portave të skëterres” kur ai thoshte: “Do të ketë (gjithnjë) thirrës pranë portave të zjarrit – xhehenemit, kush iu përgjigjet atyre, ata e hedhin në zjarr. Ata janë njerëz që i përkasin lëkurës sonë dhe flasin me gjuhët tona...” (El Buhari, 3606). Këtu kemi një skicim të një kategorie që veprimtaria e tyre rrezikon të ardhmen – ahiretin e secilit besimtar. Hadithi, pos saktësisë dhe autenticitetit të pa kontestuar të tij, flet në mënyrë të qartë për kurthin e tundimit, që rëndom bien në të, ata që naivitetin dhe vetëdijen e ulët e kanë pjesë të pandashme e karakterit të tyre. Andaj, me plotë gojën duhet thënë se mediokriteti mbetet tipari që nga mesi ynë duhet flakur sa më parë. Ai s’përket me natyrën e besimtarit dhe asnjëherë nuk i bie tamam atij.

“Thirrësit pranë portave të zjarrit”, janë kategoria e përsëritshme e njerëzve që nuk mungojnë asnjëherë, në asnjë epokë historike, dhe për shkak të kapaciteteve të tyre të larta lajthitëse gjejnë turma të mëdha njerëzish që u duartrokasën dhe që verbërisht i pasojnë. Të tillët, i kanë vënë vetes për detyrë joshjen, tundimin dhe tërheqjen tinëzore e njerëzve drejt rrugës së gabuar, andaj atë edhe e kryejnë me më së shumti pasion.

Sipas përshkrimeve të interpretuesve të hadithit në fjalë, kjo kategori e njerëzve janë ata që në vend të besimit të pastër në Zotin Një, ftojnë në mohim të hyjnitetit të Tij apo ortakëri në besimin e kulluar ndaj Tij. Në vend të virtyeteve të moralit, ftojnë në shthurje e braktisje të vlerave të tij. Në vend të zbatimit të drejtësisë dhe vendosjes së rendit në tokë, ngarendin pas tiranisë dhe synojnë përhapjen e trazirave në të. Po këta, përqeshjen dhe ironizimin me pasuesit e rrugës së Islamit e kanë si mjet, ndërsa abuzimin me të vërtetat i marrin gjithnjë si strategji.

A janë të shumtë këto kategori edhe sot? Natyrisht se po! Me se duhet përballur? Me fuqinë e argumentit dhe me qartësinë e të vërtetave të mahnitshme që i përmbajnë burimet kredibile të fesë së Zotit tonë. Vetëm në këtë truall nëse me maturi lëvrojmë, atëherë një të ardhme të ndritshme shoqërive tona u garantojmë.

Mr. Driton Arifi

Hytbeja e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e festës së Kurban Bajramit

Haxhi është një deklaratë praktike e parimit të barazisë dhe vëllazërisë ndërmjet njerëzve

Vëllezër dhe motra,

Të dashur qytetarë!

Sot është dita e parë e Kurban Bajramit. Në këtë mëngjes të bukur e përplot me begati të dhuruara nga Zoti Fuqiplotë, myslimanët nga e mbarë bota ua kanë mësy xhamive për t'i kryer obligimet e tyre, për ta falur namazin e Bajramit dhe për t'iu drejtuar Zotit Krijues, me lutjet që të na dhurojë begati e të mira, e të na i falë mëkatet tona.

Sot, së bashku me miliona haxhilerë nga e mbarë bota, të cilët gjenden në Meken e shenjtë për ta kryer haxhin, janë edhe një numër i konsiderueshëm i vëllezërve dhe motrave tanë nga Kosova dhe vendet e tjera shqiptare, por edhe nga mërgata e largët, të cilët, bëjnë lutje për faljen e mëkateve dhe për begati nga Krijuesi Fuqiplotë. Ata bëjnë lutje edhe për dashurinë ndaj atdheut, e cila buron nga besimi i drejtë dhe sinjeriteti i thellë, luten për sigurinë e atdheut, me lutjen që e bëri Ibrahim i a.s., për Meken e bekuar.

Zoti xh.sh., thotë: *“Dhe kur Ibrahim tha: ‘O Zoti im! Bëje këtë qytet të sigurt e të paqes dhe furnizoj banorët e tij me fruta të çdolloj!’”* (El Bekare, 126).

Shprehja e dashurisë për atdheun në lutjet e përditshme, është një ndjenjë e natyrshme, e lindur në brendësinë shpirtërore, dhe që rritet me rritjen tonë. Ajo na jep ndjenjën se asgjë nuk krahasohet me ngrohtësinë e tokës ku jemi krijuar dhe ushqyer. Dashuria ndaj atdheut është një dhuratë e pasqerishme, është simbol i identitetit, historisë, qytetërimit e krenarisë, prandaj themi se është detyrë jona që ta duam, ta ruajmë dhe ta mbrojmë vatanin tonë. Në këtë mënyrë bëhemi qytetarë të një vendi ku jetohej me dinjitet, e për t'u bërë të tillë, kërkohet që të jemi bashkë, t'i qëndrojmë besnikë atdheut, duke e promovuar atë në të gjitha fushat dhe në çdo vend, por edhe në Mekën e largët.



Kurban Bajrami është një rast i mirë për t'iu afruar edhe më shumë Zotit të Madhëruar me veprat tona të mira, për ta falënderuar Atë për bekimet e Tij dhe për ta pastruar shpirtin dhe zemrën prej mëkateve. Këtë e arrijmë duke e kryer haxhin, duke therur kurbanin, duke kryer vepra të mira, duke zgjatur dorën e ndihmës për të varfrit dhe nevojtarët, e duke mbështetur vlerat fisnike që thërrasin për dashuri reciproke, dhembshuri, lidhje familjare dhe konsolidim të vlerave të vëllazërisë, bashkëjetesës dhe solidaritetit ndërmjet njerëzve.

Festat tona fetare duhet të shfrytëzohen për të sjellë lumturi dhe gëzim në zemrat e atyre që kanë nevojë, duke trajtuar të sëmurët e vizituar të afërmit, duke shkëmbyer urime me miqtë dhe duke i mbjellë këto vlera në mendjet dhe zemrat e fëmijëve dhe të rinjve tanë.

Vetëm kështu forcojmë edhe më shumë trungun tonë familjar, e ushqejmë atë me vlerat fetare dhe kombëtare, dhe e ruajmë atë me një pastërti fisnike, ashtu siç e kemi amanet nga të parët tanë.

Të nderuar vëllezër dhe motra,

Bashkërisht duhet të bëjmë edhe më shumë në rritjen ekonomike, rritjen e standardit për një jetë edhe më të mirë në Kosovë, në mënyrë që të zvogëlojmë migrimin e popullatës tonë nëpër vende të ndryshme të botës.

Në anën tjetër shohim se nataliteti ka rënë, se Kosova dhe vendet e tjera shqiptare po zbrazen në përmasa të mëdha. Çiftet e reja hezitojnë të kenë më shumë se një apo dy fëmijë. Ftoj çiftet e martuara të kenë më shumë fëmijë, ngase edhe këtë ia kemi borxh Kosovës sonë, të mos frikohen çiftet e reja për riskun e familjes, ngase risku është kompetencë e Zotit xh.sh., të mos bëhemi shkakhtarë për mbylljen e një numri të foshnjoreve, çerdheve, shkollave, xhamive, ngase do të na gjykojë e ardhmja e vendeve tona.

Të dashur qytetarë,

Zoti i Madhëruar i ka caktuar dy festa fetare për robërit e tij myslimanë, Fitër Bajramin dhe Kurban Bajramin. Ai i ka ligjësuar ato për vendime dhe kuptime të mëdha, përfshirë këtu edhe falënderimin dhe lavdërimin e Tij. Ne festojmë Kurban Bajramin dhe jemi të lumtur, falënderojmë Zotin e Madhëruar për gjithçka që na ka dhuruar dhe gjithçka që do të na dhurojë në të ardhmen.

Kryerja e haxhit dhe therja e kurbanit janë dy rituale kyçe, të cilat i japin domethënien dhe ia shtojnë vlerën festës së Kurban Bajramit. Haxhi është një ndër veprat më të mira të Zotit i Madhëruar pas besimit. Muhamedi a.s., ka thënë: "Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim përveç Xhenetit."

Haxhi është një deklaratë praktike e parimit të barazisë dhe vëllazërisë ndërmjet njerëzve. Në haxh, shpirti i barazisë zbulohet në formën e tij më të lartë, e kuptimet e vëllazërisë theksohen në format më të mira. Destinacioni është një, qëllimi është një, veshja është një, thirrja është një, qëndrimi është një dhe pjesëmarrja e përbashkët në ritualin e njëjtë është një.

Pra, me një fjalë, barazia ndërmjet myslimanëve arrihet edhe praktikisht në haxh, pavarësisht dallimeve të tyre nga raca, gjuha, apo vendet e tyre nga vijnë. Aty, të gjithë janë të barabartë.

Prej sekreteve të thirrjes për në haxh, është se njerëzit do të vijnë nga të gjitha anët e botës, ashtu siç po ndodh edhe sot, e për të cilën jemi dëshmitarë edhe ne.

Për këtë, Zoti xh.sh., na bën me dije përmes thirrjes së Ibrahimit a.s., drejtuar njerëzimit për kryerjen e haxhit, kur thotë: "Thirri njerëzit për haxhillëk, ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta." (El Haxh, 27).

Haxhi është edukim e përmendje e shpeshtë e Zotit xh.sh., është monolog lutjesh, e rikujtim i nisjes për në botën tjetër. Përsosmëria dhe kënaqësia më e madhe e njeriut qëndron në arritjen sa më të madhe të përkushtimit ndaj Zotit xh.sh.. Sa më shumë që besimtari ta arrijë atë përkushtim, aq më e madhe është përsosmëria dhe aq më e lartë është grada e tij.

Në haxh, ky kuptim bëhet jashtëzakonisht i qartë kur besimtari në tërësi i nënshtrohet dhe i dorëzohet Zotit.





Haxhiu sikur largohet nga streha e kësaj bote, duke migruar me tërë qenien e tij te Zoti i tij, duke lënë pasurinë, familjen, shoqërinë, i zhveshur nga rrobat e përditshme e i veshur me ihram.

Me përulje para Zotit të tij, lëviz mes ndjenjave me zemër të nënshtuar para Madhërisë së Tij, syve të përplotur dhe gjuhës që përmend Zotin pa ia nda, shpreson në mëshirën e Zotit, dhe është i gatshëm për amanetet e marra në mënyrë që të arrihet devotshmëria dhe bukuria e Islamit.

Ky është qëllimi i nënshtimit dhe përkushtimit ndaj Zotit, këtu qëndron arsyeja e fshirjes së mëkateve dhe falja e tyre, duke hyrë kështu në një jetë të re e të mbushur me mirësi dhe lumturi.

Ky kuptim bëhet edhe më i dukshëm në haxh, pasi që, nuk është urdhëruar as tavafi – rrotullimi rreth Qabesë, as ecja mes Safasë dhe Merves, e as dalja në rrafshnaltën e Arafatit, përveçse për përmendjen e Zotit përmes këtyre adhurimeve dhe lutjeve.

Zoti xh.sh., thotë: *“Dhe madhëroni Allahun në (tri) ditët e caktuara (të teshrikut)...”* (El Bekare, 203).

Me të drejtë mund të themi se haxhi konsiderohet si një shtyllë e asaj mbi të cilën është ndërtuar feja islame. Ai është një edukatë e afërsisë së devotshmërisë dhe një lloj edukimi i sjelljes, që kombinon llojet e afërsisë me Zotin e Madhëruar.

Të nderuar vëllezër dhe motra,

Në këtë Bajram, myslimanët therin kurban në shenjë falënderimi për Zotin e Madhërisë, për bekimet e shumta dhe të panumërta që Ai na i ka dhuruar.

Zoti xh.sh., thotë: *“Prandaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!”* (El Kevther, 3).

Besimtari sakrifikon si shprehje e mirënjohjes ndaj Zotit të Plotfuqishëm që e krijoi atë në këtë jetë. Kurban i është përkujtim i pejgamberit tonë, Ibrahimit a.s., dhe ringjallje e synetit të tij.

Ai në sprovën e tij me të birin, Ismailin a.s., u tregua i durueshëm dhe iu nënshtua urdhrit të Zotit të Madhëruar, urdhër, të cilin nga mirësitë e pakufishme të Zotit, Ai e zëvendësoi me prerjen e kurbanit.

Kurban i është një falënderim për Zotin e Madhëruar, për bekimet e pasurisë dhe jetës. Ai është një nga ritualet e Islamit. Kurban i është përshkruar si mjet për t’iu afruar Zotit të Madhëruar dhe si një përgjigje ndaj urdhrit të Tij. Kurban i është zgjerim për shpirtin, mirësi për familjen, nder për mysafirin, dashuri për fqinjin, bamirësi për të varfrin. Është dëshmitar i sinqeritetit të besimit të robit në Zot.

Zoti xh.sh., thotë: *“Në të vërtetë, namazi im, kurban i im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.”* (El – Enam, 162).

Kurban i është ritual përmes së cilit besimtari mëson durimin dhe sprovën, mëson preferencën e pejgamberëve për bindje ndaj Zotit të Madhërisë, dhe gjithashtu mëson se dashuria e tyre për Zotin ishte edhe më e madhe se dashuria për familjen dhe fëmijët. E gjithë kjo është një nxitje për besimtarin dhe se durimi dhe gatishmëria e kryerjes së urdhrit është arsyeja e shpërblimit dhe e gradimit prej Zotit xh.sh..

Myftiu Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, më 16 qershor 2024

Jeta dhe vepra e Ali Jakup Xhenkçilerit nga Gjilani

Bünyamin Albayrak

Ai ishte një njeri i kauzave më të mëdha, njeri i shkencës, mençurisë, ideve, kulturës, një njeri i përkushtuar për Islam. Nga kjo kauzë asnjëherë nuk kishte hequr dorë. Ishte një personalitet shembullor dhe i rrallë fetar, i mbjellë si një farë në vendet Ballkanike, që më vonë të fuste rrënjë dhe do të jepte fruta në Anadoll. Ai ishte Ali Jakup Efendiu, një mendimtar i mirë, intelektual i ndritur, dijetar pionier, me një ndjenjë të fortë përgjegjësie ndaj popullit, historisë, kulturës dhe vlerave kombëtare e morale.

Kombet dhe shtetet nuk formohen apo ekzistojnë nga luftërat, ato as nuk krijohen e as nuk e mbahen gjallë nga lufta, por as nuk mund të shkatërrohen. Besimet dhe idealet janë vlerat më të rëndësishme që e bëjnë kombin komb, shtetin shtet dhe tokën atdhe.


Dijetarët e pionierët e palodhur janë ata që i bashkojnë këto besime dhe ideale me shoqërinë dhe japin shembull përmes jetës së tyre, që nuk kanë frikë të vrapojnë dhe të luftojnë në rrugën e së vërtetës.

Një nga këta dijetar pionier është hoxha ynë, Ali Jakup Xhenkçileri, i cili është ndër heronjtë tanë thuajse të panjohur dhe pa emër. Është nga dijetarët që kanë vënë vulën në shekullin e fundit nga aspekti i strukturës së kulturës e dijes.

Në këtë pjesë të shkrimit tonë, në të cilën përpiqemi t'ju prezantojmë dijetarët pionier, shpresoj se do t'ju rrëfejmë për Ali Jakup Efendiun dhe do të nxjerrim mësim nga jeta e tij. Le të fillojmë me një deklaratë të tij: "Ata që humbën garën nuk janë të fundit që hynë në garë, të humburit janë ata që vetëm shikojnë nga larg dhe kurrë nuk u përpoqën të vrapojnë, të konkurrojnë dhe të mundohen për të."

Ali Jakup Xhenkçiler lindi në vitin 1913 në qytetin e Gilanit, atëherë sanxhaku i Prishtinës - Kosovë. Babai i tij ishte hafëz Hyzejn Efendiu, i cili u shkollua në Medresenë Fatih në Stamboll. Nëna e tij ishte zonja Hyrishahe.

Ali Jakup Efendiu jetën e tij 75 vjeçare e kishte kaluar në vende të ndryshme. Në vendlindjen e tij kishte qëndruar 23 vjet, më pas 21 vjet në Egjipt dhe pjesën tjetër 31 vjeçare të jetës së tij e kishte kaluar në Turqi.



Vinte nga një familje katolike shqiptare prej Shkodrës. Për këtë arsye familja e tij ishte përmendur edhe si "Shkodranët". Të etërit e tyre ishin bërë myslimanë në kohën kur osmanët kishin ardhur në Ballkan. Gjyshërit tanë, aq mirë e kanë predikuar dhe përfaqësuar Islamin sa që, atë kohë në vendet Ballkanike të thuash turk, kuptohej si të thoshe mysliman, sepse kur dikush atë kohë bëhej mysliman, i thuhej u bë turk. Hoxhë Ali Jakupi, lidhur me këtë kishte thënë: "Nëse ne sot jemi myslimanë dhe jemi të lidhur për kulturën tonë, kjo është për shkak të osmanlive, Zoti qoftë i kënaqur nga ta, sepse ata kanë ardhur te ne dhe ne, na vetëdijesuan duke na kujtuar të bëhemi myslimanë. Në këtë mënyrë pra ne fituam mundësinë që këtë botë ta fitojmë për të mira dhe ahiretin ta kthejmë në xhenet. Po që se nuk do të vinin osmanët dhe nuk na kumtonin neve Islamin, çfarë do të ishte gjendja jonë? Të mos harrojmë se këto nuk janë vetëm fjalët e mia, ky është mendimi i gjithë Ballkanit. Ka nga ta që habiten se si unë i

dua dhe mbroj osmanët. Unë atyre u them: ‘të nderuar’ si të mos duhen osmanët. Ata jo vetëm që kanë bërë hyzmet në Ballkan, por i kanë shërbyer Islamit në mbarë botën. Sa shumë dëshmorë e shehidë ka dhënë ky popull i ndershëm. Ata derdhën gjakun e pastër të tyre dhe kanë dhënë sakrifica të mëdha. Për këtë arsye, them se kush tradhton këtë komb, kurrë nuk do të gjejë shpëtim! Të tillët, gjatë gjithë historisë as që kanë shpëtuar, dhe nuk do të shpëtojnë.”

Ali Jakupi ishte rritur në një familje fetare dhe të arsimuar. Kishte dy motra më të mëdha, të cilat ishin bërë hafëze të Kuranit. Ai kishte dëshirë të madhe që edhe vetë të bëhej hafëz si motrat dhe babai, por nuk arriti.

Familja është foleja më e rëndësishme për arsimimin e njeriut. Pikëpamja e Ali Jakupit për botën dhe ngjarjet në të, njohuritë e tij për të, përkushtimi ndaj kulturës u formësuan në familjen e tij. Ai, gjatë gjithë jetës së tij qëndroi kështu. Në moshën tetë vjeçare, Ali Jakupi filloi arsimin bazë katërvjeçar në një shkollë serbe në Gjilan. Nga mëngjesi deri në mesditë shkonte në shkollë serbisht, ndërsa pasdite mësonte shkencat islame dhe turqishten nga i ati. Shkollën fillore e kishte mbaruar në moshën dymbëdhjetë vjeçare.

Kjo ishte një kohë kur edhe motrat e tij e kishin përfunduar hifzin e Kuranit. Mirëpo, ai edhe me gjithë dëshirën e madhe që kishte nuk mundi të bëhej hafëz. Kjo gjë ndikoi që ai të mërzitej gjithë jetën e tij. Tani pra, erdhi dita që ai të shkonte në Egjipt, ku atje do të takohej dhe njoftohej me një nga dijetarët dhe kolosit e kohës, Ali Ulvi Kuruxhu. Kur ky dijetar mësoi se Ali Jakupi i dinte shtatë gjuhë, e kishte përgëzuar atë, e më pas Ali Jakupi lidhur me rëndësinë e hafëzllëkut drejt rrugës së diturisë thotë: “Shumë i respektuar, ah sikur të mos i dija shtatë gjuhë e në vend të tyre të isha hafëz sikurse ju.”

Prindi i tij gjithmonë kishte dëshirë të flaktë që i biri të përparonte drejt rrugës së diturisë. Për këtë arsye, atë e dërgoi në medresenë e Gjilanit. Ai e mbaroi medresenë për tri vjet me radhë dhe aty diplomoi qysh në moshë të re. Lidhur me atë se çfarë ka fituar nga medreseja ai thotë: Për studime shkova në Shkup e Egjipt, dhe atje pash e vizitova shumë medrese, mirëpo në asnjërën prej tyre nuk e gjeta ngrohtësinë sikurse ishte në medresenë e Gjilanit. Kjo medrese më ka dhënë gjëra aq të rëndësishme sa që nuk mund t’i braktisja gjatë gjithë jetës sime. Faleminderit Allahut që më ka mundësuar që aty të lexojë çdo ditë nga dy xhuza prej Kuranit. Kështu që zgjohesha një orë para namazit të sabahut lexoja një xhuz deri në kohën e namazit, dhe një xhuz tjetër në mes namazit të akshamit dhe jacisë. Këtë gjest dhe përvojë të mirë e mora nga medreseja dhe nuk e braktisa gjatë gjithë jetës sime.”

Ali Jakupi i cili mbaroi studimet në medrese, tanimë kishte marr një rrugë, një obligim që jetën e tij ta bëje vakëf në këtë

Pikëpamja e Ali Jakupit për botën dhe ngjarjet në të, njohuritë e tij për të, përkushtimi ndaj kulturës u formësuan në familjen e tij. Ai, gjatë gjithë jetës së tij qëndroi kështu.

profesion. Tani e pas, çfarë do të bënte ai? Të vazhdonte studimet në shkollat serbe dhe të merrte një zanat atje apo të përvetësonte mësimet në fushën e fesë dhe të vazhdonte kështu?

Dijetarët janë njerëz që jetën e tyre e bënë vakëf në rrugën e diturisë dhe urtësisë. Po i tillë u bë edhe dijetari Ali Jakupi. Erdhi më koha që të merrte një vendim pasi mbaroi medresenë. Ai, këtë e bisedoi me familjen e tij. Familja i propozoi dhe e këshilloi që rruga më e mirë dhe më e dobishme është ajo që të vazhdoje këtë drejtim, ngase kjo do t’i ndihmonte që t’i shërbente Islamit dhe myslimanëve kudo që do të shkonte. Gjithashtu kjo rrugë do të ndihmonte në zhvillimin e fesë, sepse myslimanët kishin nevojë që të mos mbesim mbrapa në këtë aspekt dhe se rruga e vetme që ata t’i shpëtoje është rruga drejt diturisë. Gjithashtu ata e këshillojnë që ta arsimojë veten në shumë fusha, të mos ndahet nga shkenca dhe që të mundohen me gjithë forcën që kishte.

Këshillat e tyre dhe të parisë rreth tij ndikuan fuqishëm tek Aliu, ku ai u orientua të merrte rrugën në këtë drejtim. Ai, në një rast këto këshilla të marra i shpjegonte kështu: “Unë jam nga të tillët që kanë prejardhje të thellë dhe rrënjësore fetare. Po që se ata do të më linin të lirë, unë do të mbyllesha në një vend të vetëm dhe bëhesha një person i mbyllur dhe asket. Por, ata nuk më lan të tillë që të veçohesha. Më kapën dhe më thanë që, ti patjetër duhet t’i kapësh rrugës së diturisë dhe sa të është e mundur të mësosh që të behësh një dijetar. Kështu që unë u obligova të veproja ashtu. Tani, kur shikoj mbrapa, them me vete, sa mirë që ata më kanë këshilluar kështu. Tani, unë jam falënderues dhe mirënjohës i madh ndaj tyre dhe bëj dua për ta.

Ai, pasi zgjodhi rrugën e dijes, filloi të hulumtoje rrugët e tjera drejt një arsimimi më të avancuar. Ky kërkim, atë e dërgoi në Shkup te Medreseja “Meddah” në vitin 1927. Për fat të keq, në kohën kur ai shkoi atje, atë kohë medresetë e asaj kohe si dhe qendrat e dijes edhe në Perandorinë Osmane kishin filluar të pësonin rënie. E në anën tjetër, shkenca dhe dija në këtë rrugë të fesë duhej të rritej dhe zhvillohej nga njerëz dhe institucione kualitative e vendore. Fatkeqësisht atë kohë ishte e vështirë që një qendër e tillë të gjendej në vendet Ballkanike.

Ai donte që të gjente një qendër studimi më kualitet të lartë. Kishte hulumtuar shumë shkolla e medrese, dhe më në fund kishte vendosur që të studionte në Shkup, te Medreseja “Meddah”. Kjo ishte një medrese mjaft e vjetër e mbetur nga Perandoria Osmane, ku për një kohë të gjatë nuk kishte funksionuar dhe kishte mbetur e braktisur. Kështu që kur Ataullah Kurtishi mori udhëheqjen e saj, kjo medrese filloi të përparoi dhe t’i rikthehet ditëve të vjetra. Ataullah efendiu kishte krijuar një kuadro cilësorë dhe kualitativë. Atëherë

pra, më pas kjo medrese filloi të njihet si “Shkollë e Lartë Islame”. Derisa Ali Jakupi merrte mësimet islame nga Ataullah efendiu, në anën tjetër ai mësoi sintaksën dhe letërsinë turke nga Sejfeddin Efendiu.

Ai nuk u ndal në rrugën e diturisë. Kështu pasi mori mësimet në Medresenë “Meddah”, kthehet në Gjilan dhe nga aty merr rrugën për në Bosnje. Atje hy në një provim pranues përpara profesorëve, intelektualeve dhe gjykatësve në mënyrë që të studionte në Mektebin Nuvvab. Derisa ishte në vitin e tretë në këtë shkollë, i vdes i ati, dhe meqë ishte fëmija më i madh i familjes, i duhej që për një kohë të merrej me punët familjare. Megjithatë, kjo ndërprerje e studimeve, nuk e zmbropsi dashurinë e tij ndaj diturisë, por edhe më tepër e motivoi atë. Ai aspak nuk e kishte qëllimin që të merrte diplomë e të punonte diku. Për të kërkimi i diturisë ishte qëllimi i tij final dhe një çlirim i pa fund. Ky çlirim, padyshim se do të ishte rrugëtimi i tij drejt Egjiptit.

Ai ishte një dijetar, i cili nuk kishte ndonjë synim përfitimi të ndonjë pozite të kësaj bote, autoritet apo interes material. Ishte i vetëdijshëm se rrugëtimi drejt saj ka vështirësi, donte guxim dhe angazhim të madh. Për këtë arsye ai gjithmonë ishte në pozicionin e hulumtuesit ndaj dijes, urtësisë dhe shkencës. E dinte shumë mirë se në cilat vatra dhe institucione shkencash do ta gjente atë. Në të njëjtën kohë ai e dinte se një atmosferë dhe vatër e tillë nuk gjendej në vendet Ballkanike. Atëherë pra, çfarë do të bënte, si të vepronte? Pas shumë hulumtimeve të bëra, këto përgjigje dhe këtë vendim e mori me shkuarjen e tij në Az’har të Egjiptit. Ishte shumë e vështirë që në kushtet e asaj kohe të Jugosllavisë të udhëtohej në Egjipt, e aq më e vështirë për një person si ky që nuk i kishte kushtet e mira ekonomike. Por ky vetëm se kishte marrë një vendim të tillë, pavarësisht mundësive dhe kushteve të vështira.

Udhëtimi filloi nga shtëpia e tij në Gjilan, e që stacioni i parë i tij u bë Shkupi. Pasi qëndroi aty dhe njoftohet me shokë të ndryshëm, shkoi në Greqi që të marrë vizën në Athinë nga ambasada Egjiptiane. Ai, pasi aplikoi për vizë, mori një përgjigje jo të kënaqur, se atë duhej të priste së paku dy muaj. Kjo e shqetësoi, sepse nuk kishte mundësi të qëndronte aty për dy muaj të tërë. Më pas takohet me dikë që i preferon të shkonte në Gjenevë. Aty takohet me myftiun, dhe pas bisedave, myftiu vendos që atij t’i ofrojë një punë, ngase edhe kishin nevojë. Por ty të mungon vetëm xhybeja dhe shalli i tha myftiu. Kështu më pas atij ia sjell xhyben dhe shallin pastaj e prezantoi atë para xhematit. Duke e parë zgjuarsinë dhe ilmin e tij, xhemati kërkoi që ai të mos shkonte diku tjetër por të punonte aty si imam. Por ky u thotë se qëllimin e ka që të shkojë në Egjipt për studime, dhe me lejen e Zotit pas

Ai ishte një dijetar, i cili nuk kishte ndonjë synim përfitimi të ndonjë pozite të kësaj bote, autoritet apo interes material. Ishte i vetëdijshëm se rrugëtimi drejt saj ka vështirësi, donte guxim dhe angazhim të madh.

një viti gjatë muajit ramazan mund të kthehet për detyrë, ku më pas ndahet nga aty duke marrë lutje mirësie nga ta. Ai, sapo mori lajmin që i kishte dalë viza për Egjipt, erdhi në Athinë, e mori vizën dhe u nis atje.

Pasi mori rrugën në vitin 1936, pas disa muajve arrin në Egjipt. Synimin e kishte që të regjistrohej në Universitetin e Az’harit, dhe këtë dëshirë e realizoi pas dy muajve qëndrimi aty. Qëllimi i ardhjes së tij në Egjipt nuk ishte që të merrte një diplomë e të siguronte një punë për një jetë komode. Ai kishte vendosur që të mësonte vetë, të mësonte të kuptonte vetë dhe t’ua përcillte të tjerëve. Kishte qëllimin që myslimanët të dalin nga gjendja e rendë që kishin, të kalojnë në atë hap dhe sistem të ndershëm që atyre u takon. Për këtë arsye, me të ardhur në Egjipt, ai filloi t’i trokiste dyert e dijetarëve të fundit të Perandorisë Osmane, të takohet me ta dhe të mësonte nga ta. Padyshim se dera që trokiti e takoi me dijetarin e madh të perandorisë osmane, Shejhul Islam Mustafa Sabri Efendiu. Që nga takimi i parë filloi një miqësi, vëllazëri dhe lidhje e fortë në mes të dyve deri kur Mustafa Sabriu ndërroi jetë më 1954.

Lidhja e tyre ishte thajse përtej raporteve fëmijë-prind, pra në masën sikur shpirti dhe trupi. Mustafa Sabriu e merrte atë me vete kudo që shkonte dhe atë e prezantonte sikur “këshilltar” para atyre që e pyesnin. Kur ata mbanin takime të veçanta të ligjëratave nuk e thërriste më emër, por i drejtohej si “evlija”. Por që të dy e dinin se ky epitete ishte i fshehur në të jetuarit sipas porosive hyjnore, të përqendruar ndaj fesë së Allahut.

Ali Jakupi, assesi nuk donte të ndahej nga kjo vatër e shkencës, por ai u kishte dhënë një premtim xhematit në Gjenevë. Që këtë premtim ta realizojë, dy vjet radhazi shkoi atje gjatë muajit ramazan të mbante vaiz dhe t’ua falte namazin. Xhemati e paguante për këtë shërbim që po bënte, ndërsa ai me këto të holla planifikonte të blinte librat që i duheshin dhe një pjesë tjetër ta dërgonte te familja e tij në Kosovë, të cilët ishin në kushte të vështira. Kështu që ai me anije niset për Egjipt. Për fat të keq në anije takon një djalë të ri, i cili e kishte mashtruar duke i kërkuar të holla që t’i shfrytëzonte për myslimanët në Amerikë. Më pas kërkoi që një letër t’ia dërgonte familjes së tij në Egjipt. Ali Jakupi, i besoi këtij të riu dhe ia dha të gjitha të hollat që kishte. Ndërsa kur shkoi te familja e tij ta dërgonte letrën, aty takoi familjaret të cilët i treguan se ai manipulonte në këto forma. Mirëpo ky aspak nuk u mërziu nga ky rast. E mërziu vetëm fakti që dikush në emër të Islamit bën këso mashtrime.

Kur Mustafa Sabriu dëgjon për këtë rast i thotë: “Pa shih biri im Ali efendi! Imani është begatia më e madhe nga të gjitha vlerat, e në mënyrë të veçantë besimi në kader. Kështu që mos gabo të thuash “ah sikur” e të futësh në dyshimet e



sjella nga djalli. Mos shiko më mbrapa sepse kush e di, ndoshta ka shumë fshehtësi edhe në jetë.

Pas një periudhe mbi njëzet vjeçare të qëndrimit të tij në Egjipt, Ali Jakupit i vijnë mundësi shumë të mira në jetë. Por ai, që nga vegjëlja e kishte ëndërr që të shkonte në Turqi e të bëhej pjesë e arsimit dhe edukimit atje.

Ai gjatë gjithë jetës së tij, si për vete ashtu edhe për familjen e tij, islamizimin e tyre e llogariste si një borxh që ua kishin osmanëve. Për këtë arsye ai kishte zgjedhur që pjesën e jetës tjetër ta kalonte atje pasi që edhe e llogariste si vend të vet. Në këtë mënyrë të kontribuonte në ri zgjimin dhe ngritjen e Islamit në aspektin shkencor dhe mendor te ky popull që kishin udhëhequr botën me shekuj.

Në kohën kur ishte si nëpunës në bibliotekën e Universitetit në Kajro, mori lajmin se Ambasada e Egjiptit në Ankara po kërkonte një përkthyes. Ky pra ishte një rast i mirë të cilin veçse e kërkonte. I nënshtrohet provimit dhe e kaloi atë me një sukses të lartë sikurse i kishte kaluar edhe të gjitha provimet e tjera. Kështu që tanimë i kishte ardhur koha të lulëzonte dhe në vitin 1975 u nis për Anadoll të cilin shumë e donte. Në një anë kur ai po kryente punët në ambasadë, në anën tjetër kërkonte hapësirë të diturisë e shkencës që të gjejë studentë apo vatra të arsimit që të kontribuonte. Mirëpo këtë nuk mundi ta gjejë ashtu si. E mendonte, dhe kjo veçse e dëshpëroi, sepse ai nuk kishte ardhur këtu që të fitonte të holla, por ta shpërndante diturinë e tij. Për këtë arsye ai dha dorëheqje nga Ambasada në Ankara dhe kthehet në Stamboll ta kërkonte atë që dëshironte.

Kur kishte ardhur në Stamboll, nuk kishte ndonjë vend për banim, dhe vendosi ta kontaktoj shokun e tij që vite më parë e kishte njoftuar në Egjipt dhe që bashkë kishin shkuar edhe në haxh, kryeimamin e xhamisë Bejazit, Abdurrahman Gürses. Hoxha i nderuar e kishte marrë në shtëpinë e tij për një vit me radhë në cilësinë e mysafirit dhe gjatë tërë vitit ai kishte punuar si mualim atje. Pastaj gjeti një punë si kontabilist në një fabrikë dhe me preferencën e hoxhës Abdurrahman

Gürses dhe bashkëshortes së tij, në vitin 1961 martohet me znj. Muammere, një bijë e ndershme osmane.

Ali Jakupi, gjatë gjithë jetës së tij derisa pensionohet e bëri punën me përpikëri. Përkrahë kësaj çdoherë që i jepej mundësia angazhohej në punët për dituri dhe shkenca islame. Sikurse çdo dijetar tjetër i shquar, edhe Ali Jakupi, ka kontribuar në shpërndarjen e dijes së tij. Shtëpinë e tij e kishte shndërruar në medrese dhe aty i mësonte nxënësit dhe edhe të rriturit që kërkonin dije. Më në fund arriti të angazhohej në një vatër shkencash për të cilën vite me radhë e imagjinonte. Kjo vatër ishte Qendra për Studime dhe Trajnime Haseki në Stamboll.

Në mes viteve 1976-1980, kishte ligjësuar tefsir, kalam, belagat, etj.. Përmes kësaj pune ai u bë shkak në nxjerrjen e shumë kuadrove të ligjëruesve, myftive, nëpunësve fetarë pranë Kryesisë së Çështjeve Fetare të Dijanetit. Ai gjithashtu ua mësoi edhe gjuhën arabe nxënësve të kursit të Kuranit Tuğba. Po ashtu nuk u ndal së shpjeguari veprat Ihyâu ulû-middîn, Edebu'd-dunjâ ve'ddîn, Medâriku't-Tenzîl ve Dîvânu'l-Mutenebbî në xhami të ndryshme si: Emir Buhari, Mihrimah Sultan, Mesih Paşa ve Atikali Paşa. Nuk i anashkaloi as studentët e nivelit master dhe doktoratës, të cilëve vazhdimisht u ndihmonte për kërkime shkencore, por edhe u dha mbështetje në aspektin e tubimit të bursave nga bamirësit që kontribuonin për studentët.

Lidhur me edukimin dhe arsimimin e studentëve ai thoshte: “Gjëja më e mirë që unë e kam dëshirë në këtë botë është angazhimi me studentë, edukimi dhe arsimimi i tyre. Por unë nuk arrita ta bëjë këtë aq sa kisha dëshirë. Por për mua është kënaqësi që edhe për një student të vetëm të ndaj nga koha ime, orë, ditë apo javë të tëra, sepse kjo rrugë e këtij profesioni që ne kemi marrë është rrugë që të çon tek Allahu.”

Këtë biografi dua ta përmbylli me fjalët e Mustafa Atalar, i cili ka shkruar një libër dy vëllimesh për të, e në vëllimin e dytë ai shprehet: “Gjëja që më së shumti e ka dashur dhe çmuar hoxha Ali Jakup ishte që të jepte kontributin e tij në rrugën e diturisë, kulturës dhe edukimin e të tjerëve. Ai nuk priste asnjë shpërblim material derisa e kryente këtë shërbim në edukimin e të tjerëve dhe për këtë ai e kishte flijuar veten e tij. Asnjëherë nuk ka ndodhur që ai ta kthente pas dikë që ka kërkuar diçka nga ai.”

Me këtë rast dua që t'i lutem Allahut ta mëshirojë atë dhe të gjithë ata hoxhallarë e dijetarë që kanë dhënë maksimumin e edukimin fetar të brezave. Zoti na mundësoftë që edhe ne të ndjekim rrugët që ata kanë ecur dhe të jemi të dobishëm për të tjerët!

Hoxha Ali Jakupi ishte paralizuar në vitin 1983 dhe kjo gjendje e tij i zgjati për pesë vjet me radhë. Kështu më 22 maj 1988, ia dorëzoi shpirtin Allahut në Stamboll. Me një pjesëmarrje të madhe nga xhemati dhe të studentëve, xhenazja e tij u fal në xhaminë Fatih dhe u varros në varrezat Edirnekapi Sakızağacı po në Stamboll.

Përktheu dhe përshtati:

Phd. Zymer Ramadani

Kërkimi i mbrojtjes te Zoti në këndvështtrimin e kaptinës El Felek

Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Në këtë kaptinë sqarohet se duhet mbështetur në Allahun e Madhërishëm dhe duhet të kërkohet prej Tij mbrojtje nga e keqja e krijesave, nga dëmi i errësirës së natës dhe nga e keqja e magjistarëve dhe ziliqarëve.

Kaptina El Felek, e shpallur para kaptinës En Nas dhe pas kaptinës El Fil, në radhitjen kuranore zë vend në xhuzin e fundit të Kuranit, respektivisht si kaptina njëqind e trembëdhjetë e tij. Kjo kaptinë e shkurtër, por e një rëndësie të veçantë, e shpallur në Mekë,¹ përbëhet nga vetëm pesë ajete, që në vete ngërthejnë tematikën e mbështetjes së njeriut dhe kërkimit të ndihmës tek Allahu i Madhëruar prej dëmit të çdo krijese, prej së keqes së njerëzve të prishur, të cilët veprojnë në errësirën e natës kur ngryset plotësisht, prej dëmit të mashtruesve/gënjeshtarëve si falltor e magjistarë, prej së ligës së smirëziut kur vepron sipas zilisë së tij. Kjo kaptinë njihet me emrin El Felek – kaptina e agimit, sabahut, emër i marrë nga ajeti i parë i saj ku thuhet: “*Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit.*”²

LIDHMËRIA E KËSAJ KAPTINË ME KAPTINAT E TJERA

Kurani është libër hyjnor që mbart opinion të gjithanshëm dhe të përgjithësuar, që ndikon mbi ndërgjegjen e lexuesit, që ndriçon intelektin, imagjinatën dhe mendjen e njeriut, ndërsa përmbajtja dhe forma stilistike e tij janë të mahnitshme. Të këtillë kemi dhe lidhmërinë në mes të kaptinave apo ajeteve kuranore të cilat shprehin vlerat e mrekullisë së ligjërimit kuranor. E sa i përket lidhmërisë së kësaj kaptine me kaptinat e tjera kuranore vihet në pah fakti se kjo kaptinë përmban një lidhmëri të fuqishme përmbajtësore me atë paraprake El Ihlas, në të cilën sqarohet e



vërteta se Krijuesi i gjithësisë është i pastër nga çdo gjë që nuk përkon me Madhërinë dhe cilësitë e Tij, dhe se vetëm Atij i drejtohet çdo krijesë për çdo nevojë dhe kërkesë, ndërsa në këtë kaptinë sqarohet se duhet mbështetur në Allahun e Madhërishëm dhe duhet të kërkohet prej Tij mbrojtje nga e keqja e krijesave, nga dëmi i errësirës së natës dhe nga e keqja e magjistarëve dhe ziliqarëve.

Se lidhja mes kaptinave në Kuran prej fillimit e deri në fund është hyjnore, dëshmon edhe lidhja në mes të kësaj kaptine dhe asaj të parës në radhitjen kuranore, pra El Fatiha, ngase në ajetin e 4-të të saj, përderisa kërkohet ndihmë vetëm prej Allahut të Plotfuqishëm duke thënë: “*Vetëm Ty të adhurojmë dhe*

vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”,³ në kaptinë El Felek, po ashtu udhëzohet që të kërkohej ndihmë e mbrojtje vetëm prej Tij, nga shumë të liga dhe të këqija të kësaj bote, të dukshme e të padukshme dhe prej të ligave të njerëzve.⁴

VLERA E KAPTINËS EL FELEK

Sa i përket vlerës dhe praktikës që përmban kjo kaptinë, në shumë hadithe të Pejgamberit a.s., të cilat janë shënuar pothuajse në të gjitha koleksionet e mëdha të hadithit është përmendur se kjo kaptinë është e një rëndësie të veçantë. Një ndër to është edhe transmetimi nga Ebu Abdullah bin Aish el Xhuheni, i cili kishte thënë: “Më ka thënë i Dërguari i Allahut: “O Ibën Aish! A të tregoj për lutjet më të mira dhe më të vlefshme, me të cilat kërkohej mbrojtje tek Allahu i Lartësuar?” “Po, si jo, o i Dërguar i Zotit”, ia ktheva unë. Atëherë më tha: “Lexoji këto dy sure: “Kul eudhu bi rabbi’l felek” dhe “Kul eudhu bi rabbi’n-nas.”⁵ Në lidhje me këtë po ashtu transmetohet se Aisheja r.a., te këtë thënë: “Çdoherë që i Dërguari a.s. binte për të fjetur, mbledhte shuplakat e tij, u frynte atyre dhe lexonte: “Kul huvallahu ehad”, “Kul eudhu bi rabbi’l felek” dhe “Kul eudhu bi rabbi’n-nas”, pastaj me shuplaka prekte trupin a tij aq sa arrinte, duke filluar prej kokës dhe fytyrës së tij. Këtë veprim e përsëriste tre herë radhazi.”⁶

KËRKIMI I MBROJTJES TE ZOTI I LARTËSUAR

Edhe kjo kaptinë, sikurse kaptina që zë vend para saj në radhitjen kuranore El Ihlas, fillon me shprehjen “kul/ Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit”⁷, e cila është pjesë e vahjit, e mesazhit profetik të të Dërguarit të Allahut. Mirëpo për dallim nga kaptina El Ihlas,⁸ në këtë kaptinë ky urdhër përçon një mesazh mëshire, dhembshurie dhe këshille hyjnore të Krijuesit drejtuar të Dërguarit të Tij në veçanti dhe të gjithë besimtarëve në përgjithësi me këshillën se kujt duhet t’i drejtohen për mbështetje dhe ndihmë. Shprehja “eudhu”, që në aspektin leksikor përmban kuptimin e strehimit, mbrojtjes dhe mbështetjes të dikush nga të liga të mundshme, në këtë varg kuranor paraqet kërkim mbrojtjen e njeriut tek Allahu i Lartësuar. Shprehja “felek”, e cila zë vend vetëm në këtë kaptinë të Kuranit madhështor dhe kuptimi linguistik i së cilës është ndarje apo çarje, në kontekstin e vargut kuranor paraqet agimin e mëngjesit që respektivisht simbolizon ndarjen e dritës nga errësira me fillim të dritës së parë të

Zoti i felekut është Allahu i Madhëruar që prej mos ekzistencës nxjerr në ekzistencë çdo gjë, prej errësirës së natës sjell dritën e agimit, prej vështirësisë nxjerr çlirimin, prej pikëllimit gëzimin dhe prej frikës sigurinë.

agimit.⁹ Në këtë kontekst mesazhi i ajetit kuranor mund të kuptohet: “Thuaj, kërkoj strehim dhe mbrojtje tek Zoti i sistemit që ndan/krijon duke krijuar dhe ndarë.” Në këtë kuptim në kaptinë El Enam thuhet: “S’ka dyshim, Allahu është zbërthyes i farës (i kokrrës së saj) dhe i bërthamës (së pemës). Ai nxjerr të gjallin nga i vdekuri dhe Ai është nxjerrës i të vdekurit nga i gjalli. Ky është Allahu, e si atëherë shmangeni. (nga besimi).”¹⁰ Një pjesë e dijetarëve islam po ashtu shprehin qëndrimin se shprehja “felek” nënkupton “një vend të mbyllur në xhehenem”, “një shtëpi, pus në xhehenem” apo është edhe një nga “emrat e vetë xhehenemit.”¹¹ Sipas interpretuesve të Kuranit urtësia e përdorimit të emrit “Rabb” në vend të emrit “Allah” në këtë ajet kuranor qëndron në faktin se emri “Rabb” është në harmoni me kuptimin e përgjithshëm të kaptinës, pra mbështetjen dhe strehimin te Zoti i Lartësuar. Ngase emri Rabb nënkupton Zotëruesin e rububijes mbi të gjitha krijesat e Tij, domethënë Ai që i krijon dhe i sundon ato, si dhe i drejton/udhëheq dhe i rregullon/sistematon çështjet e tyre. Në lidhje me këtë Taberiu thekson se emri Rabb në gjuhën arabe ka disa kuptime. Tek ata, zotëria të cilit i binden të tjerët quhet rabb. Njeriu që përmirëson diçka quhet rabb. Zotëruesi i diçkaje quhet rabb. Gjithashtu, ka edhe disa kuptime të tjera, mirëpo të gjitha kthehen te njëra prej këtyre tri kuptimeve. Pra, Rabbi

(Zoti) i Madhërishtë, është Zotëria të Cilit askush nuk i shëmbëllen dhe ngjason në zotërimin e Tij. Ai është që i përmirëson çështjet e krijesave të Tij përmes dhuntive të cilat ua jep atyre në formën e plotë dhe të përsosur dhe është Sunduesi/Zotëruesi të Cilit i përket i gjithë krijimi dhe urdhri.¹² Në këtë kontekst kuptimi i ajetit është: “Kërkoj mbrojtje dhe strehim te Zoti i agimit i cili na nxjerr nga errësira e natës në ndriçimin e ditës. Ai është Zoti i Cili na nxjerr nga fatkeqësia e natës për të arritur lumturinë e ditës.”¹³ Pra Zoti i felekut është Allahu i Madhëruar që prej mos ekzistencës nxjerr në ekzistencë çdo gjë, prej errësirës së natës sjell dritën e agimit, prej vështirësisë nxjerr çlirimin, prej pikëllimit gëzimin dhe prej frikës sigurinë.

Rrëfimi në kaptinë vazhdon me ndriçimin e së vërtetës se nga çka duhet të kërkohej mbrojtje dhe strehim, duke thënë: “Prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi.”¹⁴ Sipas Raziut në lidhje me frazën “çdo krijese” në këtë ajet kuranor kemi tre mendime: i pari, me këtë mund të aludohet në dëmin dhe të



Kaptina
përfundon
duke theksuar
se në mesin e
veprimeve të
liga që vijnë
nga njerëzit
shpirtligë po
ashtu është
edhe smira, në
lidhje me të
cilën thuhet:
“edhe prej
dëmit të
smirëkeqit, kur
sipas smirës
vepron!”

krijësive shtazore, insekteve dhe mikrobeve, helmeve dhe zjarrit, nga e keqja e mëkateve dhe e vetvetes dhe çdo gjë që mund të sjellë dëm.¹⁵

Nga gjërat që duhet të kërkojmë mbrojtje-strehim te Zoti, të përmendura në këtë kaptinë është edhe: “Prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht.”¹⁶ Shprehja “gasik/errësirë” është një fjalë gjithëpërfshirëse që është interpretuar në shumë kuptime. E para, me këtë shprehje nënkuptohet

errësira e natës, e cila zbret shpejt në tokë dhe mbulon gjysmën e rruzullit tokësor, kurse fjala “vekab” do të thotë “ka hyrë/përfshi”, dhe simbolizon shtrirjen e errësirës në tokë.¹⁷ Në këtë kuptim në një ajet tjetër kuranor thuhet: “Fale namazin kur zbret (nga zeniti) dielli, e deri në errësirën e natës dhe duke bërë lutjen (namazin) e agimit.”¹⁸ Fakti që është theksuar errësira e natës në kaptinën Felek, tregon se ashtu siç në këtë kohë e keqja fillon të përhapet dhe punët e këqija të veprohen, ashtu dhe dëmi i kafshëve të egra dhe helmuese është më i pranishëm për njeriun. Andaj në një mënyrë simbolike është më se e nevojshme të kërkohej mbrojtje para se e keqja të përhapet. Në këtë ajet, veçanërisht është inkurajuar strehimi tek. Allahu i Lartësuar që sjell agimin, nga të gjitha fatkeqësitë dhe të ligat që dalin posaçërisht gjatë natës. E dyta, qëndrimin se shprehja “gasik” paraqet hënën në të sosur të saj, në fund të muajit, sepse në një transmetim thuhet që i Dërguari a.s. e kishte porositur Aishen r.a. me fjalët: “Kërko mbrojtje tek Allahu i Madhëruar prej hënës në të sosur, sepse kjo është “gasiku” - errësira kur ngryset”.¹⁹ Sipas Mevdudiut, interpretimi i saktë i këtij hadithi është se hëna dallohet vetëm gjatë natës. Edhe pse është në qiell gjatë ditës, ajo nuk shihet. Prandaj, kuptimi i fjalëve të Pejgamberit a.s. është “Kur hëna dallohet, pra gjatë kohës së errësirës, strehohuni tek Allahu.”²⁰

Rrëfimi në kaptinë vazhdon me kërkim mbrojtje tek Allahu i Lartësuar edhe prej mashtrimeve e falleve, të cilat e hutojnë njeriun: “Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja.”²¹ Me fjalë të tjera, kërkoj strehim tek Allahu nga të këqijat e krijuara nga ata që punojnë me lloj-lloj nyjash, fijesh dhe litarësh, nga e keqja e shpirttrave magjistarë, apo e grave dhe burrave magjistarë, apo e shoqërive të cilat në një formë të pa kuptuar dhe të fshehur bëjnë magji dhe merren me falle. Falli dhe magjia në Islam janë në mesin e dukurive të shëmtuara, të ndaluara dhe nuk u lejohet myslimanëve që të mashtrohen me fjalët dhe premtimet që thonë magjistarët apo falltorët dhe as të mashtrohen me numrin e shumtë të

njerëzve që u drejtohen si pasojë e padijes, sepse ata janë gënjeshtarë dhe njerëz të prishur. Pejgamberi a.s. e ka ndaluar frekuentimin e tyre, të pyeturit e tyre dhe besimin te fjalët që thonë, sepse kjo është diçka shumë e urryer që mbart me vete rrezik të madh dhe përfundim të shëmtuar: *“Largohuni prej shtatë gjërave shkatërruese.” Sahabët i thanë: “Cilat janë ato, o i Dërguari i Allahut?” E ai tha: “Shirku (t’i bësh shok Allahut në krijim e sundim), magjia (sihri), mbytja e dikujt që e ka ndaluar Zoti, përveçse me arsye, marrja e kamatës, marrja (grabitja) e pasurisë së jetimit, ikja nga fushëbetetja dhe akuzimi i grave të ndershme e besimtare (për amoralitet)”*.²²

Kaptina përfundon duke theksuar se në mesin e veprimeve të liga që vijnë nga njerëzit shpirtligë po ashtu është edhe smira, në lidhje me të cilën thuhet: *“edhe prej dëmit të smirëkeqit, kur sipas smirës vepron!”*²³ Shprehja “hased” nënkupton pasionin (dëshirën) për zhdukjen e mirësisë, bekimit, pasurisë, gradës dhe pozitës së tjetrit. Zilia karakterizohet nga cilësitë e këqija dhe të shëmtuara të përmendura në shumë ajete dhe hadithe. Arsyeja pse zilia është e ndaluar dhe konsiderohet nga veset e shëmtuara është sepse kundërshtimi i ziliqarit është në të vërtetë kundër caktimit të Zotit të Madhëruar, sepse Allahu i Lartësuar është ai që i jep njeriut të gjitha llojet e mirësive, pozitive, gradave, epërsisë dhe begatisë. Prandaj, të qenit ziliqar dhe smirëzi për bekimet e tjetrit, do të thotë mos pranim i caktimit të Zotit të Madhëruar. Dëmi i kësaj më së shumti kthehet prapë te vetë personi ziliqar. Në lidhje me këtë Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Besimi dhe zilia nuk mund të bashkëjetojnë në zemrën e një robi.”*²⁴ Prandaj, zilia nuk mund të jetë karakteristikë e besimtarëve të vërtetë. Kur zemra sëmuret me një sëmundje dhe ndotje të tillë shpirtërore, vlera dhe shpërblimi i veprave të tjera të mira ulet ose shkatërrohet. Për shkak të lidhmërisë së ngushtë në mes të magjisë dhe zilisë Allahu xh.sh. i ka përmendur njërin pas tjetrit në këtë kaptinë kuranore. Zilia qëllimkeq është mëkati i parë që është bërë në qiell, atëherë kur Iblisi shfaqti zili ndaj Ademit a.s., duke bërë mendjemadhësi dhe mëkati i parë që është bërë në tokë, atëherë kur Kabili xhelozoi vëllain e tij, Habilin. Si rezultat i kësaj smire në rastin e parë ishte mallkimi i Iblisit nga ana e Allahut xh.sh., ndërsa në rastin e dytë ishte mbytja e të vëllait nga ana e Kabilit.

Në anën tjetër, ekziston një zili (lakmi) e lejuar e quajtur “gibtatun”. Në lidhje me këtë i Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Nuk bën të ketë zili (myslimani ndaj myslimanit) përveçse në dy raste: zili (lakmi) ndaj një njeriu të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe ia ka mundësuar që atë pasuri ta shpenzojë në rrugë të Tij e për mirësi, dhe zili (qëllimiri) ndaj një njeriu, të cilit Allahu i ka dhënë urtësi (dije), me të cilën dije ai punon dhe gjykon ndërmjet njerëzve.”*²⁵ Në këtë hadith janë shprehur dy raste kur është e lejuar zilia

ndaj tjetrit, por gjithmonë në kontekstin e veprave të mira dhe për hir të Allahut. E para, zili për pasuri, të cilën e shpenzon në rrugë të mirësisë dhe për hir të Allahut. Kjo është një mënyrë për të inkurajuar për vepra të mira dhe ndarje të pasurisë në bamirësi. E dyta, zili për dije, të cilën e përdor për të ndihmuar njerëzit dhe për të dhënë gjykim të drejtë. Kjo tregon rëndësinë e dijes dhe përdorimit të saj për të ndihmuar të tjerët.

Kërkimi i mbrojtjes dhe i strehimit të Zotit i Madhëruar nga dëmi dhe e liga e çdo krijese njëkohësisht është tregues i një bindjeje të plotë ndaj Fuqiplotit. Të kërkuar ndihmën e Zotit nuk është mangësi dhe dobësi e njeriut, sepse nuk ka krijesë që nuk ka nevojë për Krijuesin, nëse dikush mendon se është i vetëmjaftueshëm, ai veçse është shmangur nga realiteti. Por megjithatë duhet të kuptohet fakti se me kërkimin e mbrojtjes të Zotit njeriu duhet edhe t’i shfrytëzojë të gjitha aftësitë dhe mundësitë e veta, dhe në momentin kur ato shteren është ndihma e Zotit, të cilën nuk mund ta pengojë asgjë.

1 Në mesin e dijetarëve islam ka divergjenca në lidhje me përkatësinë e kësaj kaptine. Përderisa shumica e dijetarëve si Hasen el Basriu, Atau, Ikrimja, Ibën Xherir et Taberiu, Muhamed Abduhu, Muhamed Reshid Rida, Muhamed Ali Sabuni dhe një pjesë e mufesirëve janë të mendimit se kjo kaptinë i takon periudhës mekase, në anën tjetër, Ibën Abbasi, Katadeja dhe një grup po ashtu i konsiderueshëm i dijetarëve, përfshirë dhe Rraziun, Ibën Kethirin, Ebu Bekr el Xhezairiun etj., mendojnë se kjo kaptinë është nga kaptinat medinase. (Vahidi, *El Vasit fi Tefsiri l-Kur’ani l-Mexhid*, IV/573.)

2 Felek, 113/1.

3 Fatiha, 1/4.

4 Vahidi, *El Vasit fi Tefsiri l-Kur’ani l-Mexhid*, IV/574.

5 Ibën Kethir, *Tefsiru l-Kur’ani l-Adhim*, IV/745.

6 Buhari, Sahih, nr. 5018.

7 Felek, 113/1.

8 Urdhër të prerë.

9 Taberi, *Xhamiu l Bejan*, XXIV/742.

10 Enam, 6/96.

11 Taberi, *Xhamiu l Bejan*, XXIV/743.

12 Taberi, *Xhamiu l Bejan*, I/7143.

13 Razi, *Mefatihul Gajb*, XXXII/620.

14 Felek, 113/2.

15 Razi, *Mefatihul Gajb*, XXXII/622.

16 Felek, 113/3.

17 Shenkiti, *Advau l Bejan*, IX/160.

18 Isra’ë, 17/78.

19 Tirmidhi, *Tefsiru Sure*, 113, 114-1; Musned, VI/ 60, 206, 215, 237, 252.

20 Mevdudi, *Tefhimul Kur’an*, VII/327.

21 Felek, 113/4.

22 Buhari, IX/192; Muslim, IV/1719. Sa i përket sihrit dhe realitetit të tij, dijetarët janë ndarë në dy qëndrime: Të gjithë dijetarët që përfaqësojnë Ehli Synetin, janë unikë se sihri si realitet ekziston dhe se ai është një bashkëveprim i forcave të errëta djallëzore dhe ato njerëzore dhe për të ka dhënë shenjë edhe Allahu xh.sh. në Kuran më se 60 vende. Dijetarët e shkollës së muëteziles (racionalistët) janë kategorikë se sihri nuk është një realitet, por vetëm një mashtrim optik. Këtë qëndrim e përkrahin edhe shumica e dijetarëve bashkëkohorë me në krye Muhamed Abduhunë, Reshid Ridanë, Sejjid Kutbin etj.

23 Felek, 113/5.

24 Nesai, Xhihad, 8.

25 Shenkiti, *Advau l Bejan*, IX/162.

Krijimi i Ademit sipas Imam Maturidiut

Dr. Osman Nuri Demir

Ashtu si Zoti i krijoi të gjitha qeniet në mënyrën më të bukur sipas tipit dhe llojit të tyre, po ashtu Ai krijoi njerëzit mbi të gjitha qeniet e tjera dhe në mënyrën më të bukur si qenie njerëzore.

Në i mësojmë mendimet e Maturidiut për krijimin e Ademit, me fjalë të tjera, qenies së parë njerëzore, falë komenteve të tij mbi ajetet përkatëse në Kuran.¹ Në disa prej ajeteve për krijimin e njeriut² përmenden vetëm cilësitë e Ademit, ndërsa në disa të tjera emrat dhe atributet e tij. Sidoqoftë, nuk ka dallim në kuptim dhe natyrë midis këtyre emrave dhe cilësive. Përveç kësaj, është e mundur të gjejmë informacion të plotë për krijimin dhe krijimin e qenies së parë njerëzore në shumë ajete të tjera.³ Kjo na jep mundësinë për t'iu qasur pikëpamjeve të Maturidiut në detaje, bazuar në interpretimet e tij të ajeteve.

Çështja nëse Ademi ishte njeriu i parë është debatuar gjatë historisë. Për këtë temë janë paraqitur ide të ndryshme para dhe pas Islamit.⁴ Megjithatë, sipas Maturidiut, Ademi, i cili është “asli i insanit dhe *ebu'l-beshir*”⁵, është njeriu i parë dhe peygamberi i parë. Me sa mund të konstatojmë, ai nuk shpreh mendim të kundërt dhe as nuk përcjell mendim të ndryshëm për këtë çështje.⁶ Në fakt, kjo situatë mund të jetë dëshmi se Maturidiu e shihte Ademin si njeriun e parë, dhe gjithashtu tregon se të paktën asnjë ide e kundërt nuk ishte e përhapur në atë kohë. Ndoshta, në shekullin në të cilin jetoi Maturidiu, pikëpamjet se Ademi nuk ishte njeriu i parë ose nuk ekzistonte fare, ose të paktën ato nuk ishin të një rëndësie që Maturidiu do t'i merrte në konsideratë. Për këtë arsye, tani e tutje, ne do të përdorim herë pas here termin njeriu i parë ose thjesht njeri (*insan*) në vend të Ademit.



Ashtu si Zoti i krijoi të gjitha qeniet në mënyrën më të bukur sipas tipit dhe llojit të tyre, po ashtu Ai krijoi njerëzit mbi të gjitha qeniet e tjera dhe në mënyrën më të bukur si qenie njerëzore.⁷ Substanca e parë, *asli*, thelbi themelues i njeriut është dheu. Zoti e krijoi origjinën e njeriut, paraardhësit e tij dhe thelbin e tij nga toka, ndërsa njerëzit më pas i krijoi nga sperma.⁸ Nga thëniet e Imam Maturidiut, i cili shqyrtoi shprehjet në ajetet përkatëse⁹, kuptojmë se kjo substancë thelbësore e njeriut të parë nuk ishte një tokë e rastësishme, e zakonshme, e papërpunuar.¹⁰ Fakti që shprehjet të ndryshme si *turab*¹¹, *tin*¹², *tin lazib*¹³, *sulaletin min tin*¹⁴, *salsal*¹⁵, *salsalin kel fehkhar*¹⁶, *hamei mesnun*¹⁷ u zgjodhën për të shprehur dheun e përdorur si substancë thelbësore e njeriut gjithashtu e mbështet këtë pikëpamje dhe tregon se është një

tokë e veçantë.¹⁸ Kjo tokë e veçantë, e cila u zgjodh për të krijuar njerëzit, u bë e përshtatshme për t'u bërë maja për njerëzit pasi kishte kaluar nëpër faza të ndryshme.¹⁹ Sipas Maturidiut, këta emra të ndryshëm që i janë dhënë esencës njerëzore tregojnë se kjo esencë ka kaluar nëpër faza të ndryshme dhe se Allahu i drejtohet asaj në kohë të ndryshme (me emra të ndryshëm përkatës).²⁰



Kjo tokë, e cila është burimi i krijimit të njeriut, është përzgjedhur dhe filtruar (pastruar) dhe është toka më e mirë për nga cilësia e saj. Është një tokë e pastër që përmban të gjitha substancat e nevojshme dhe të dobishme për natyrën njerëzore.²¹ Këtë tokë, karakteristikat e së cilës i vuri në dukje Maturidiu, mund ta quajmë në termat e sotëm “tokë organike”.²² Sipas të dhënave bashkëkohore bujqësore, struktura e tokës është tipari fizik i saj më dallues, i përhershëm dhe i pandryshueshëm.²³ Kjo veçori mund të ndryshojë dhe të përkeqësohet vetëm për një periudhë të gjatë kohore me ekspozimin e tepërt ndaj ndikimeve të jashtme dhe ndërhyrjen e kimikateve të huaja.²⁴ Ekziston një proporcion i drejtpërdrejtë midis rritjes së lëndës organike në tokë dhe rritjes së produktivitetit bujqësor.²⁵ Me fjalë të tjera, për sa kohë që ruhen vetitë thelbësore të tokës, vazhdon të arrihet efikasiteti i lartë i prituri. Në të kundërtën, efikasiteti dhe cilësia ulen.²⁶ Sipas mendimit tonë, Maturidiu vendos një lidhje midis vetive të tokës organike dhe natyrës njerëzore. Në fakt, këtë marrëdhënie do ta diskutojmë në detaje më vonë kur të diskutojmë temën e natyrës njerëzore (*fitrah*). Sido që të jetë, duket qartë se për këtë qenie të veçantë të quajtur “insan” nuk u zgjodh asnjë esencë e zakonshme apo tokë e rastësishme. Kjo esencë, e cila u zgjodh të vinte nga njeriu, u përftua mbi të gjitha nga një tokë e pastër²⁷ dhe pjellore.²⁸ Një veçori tjetër e rëndësishme e këtij dheu, e cila thuhet në disa hadithe se është marrë nga të gjitha pjesët e tokës²⁹, është se ka

cilësinë e pastrimit. Në fakt, Imam Maturidiu thotë se nëse kjo tokë, të cilën ai e përshkruan si “et-tin-i tajjib/dheu i pastër/i mirë”, është e keqe, nuk mund të arrihet rezultati i këtyre cilësive të përsosura të quajtura njeri. Sipas tij, si dheu (*tin*) që buron nga Ademi ashtu edhe sperma (*nutfë*) që buron nga bijtë e Ademit kanë karakter pastërtie. Pretendimet e atyre që pretendojnë se esencat njerëzore të përmendura

janë të pista dhe të neveritshme janë gjithashtu të pabaza.³⁰

Maturidiu pohon gjithashtu se krijimi i njeriut me materie, pra disponueshmëria e materies thelbësore, nuk mund të krijojë domosdoshmërisht njeriun.³¹ Sepse, sipas tij, Zoti mund të krijojë njerëzit ose çdo qenie tjetër me ose pa materie ashtu siç dëshiron. Në fakt, të gjitha këto shprehje në kontekstin e krijimit njerëzor mund të jenë edhe simbolike (*temthili*). Megjithatë, Zoti e përshkruan çështjen në një mënyrë që njerëzit mund ta kuptojnë për të treguar se si Ai krijoi.³²

Pohimi i Maturidiut se shprehjet për krijimin e njeriut mund të jenë simbolike është një qasje shumë origjinale. Madje, me këtë qëndrim ai vë në dukje edhe panevojshmërinë e disa debateve të panevojshme të bëra për problemin e krijimit të njeriut. Sepse pika kryesore që duhet theksuar këtu është se qeniet njerëzore dhe të gjitha qeniet janë krijuar nga hiçi, domethënë nga asgjëja, nga një Zot që është i aftë të krijojë gjëra me ose pa lëndë. Çështjet e tjera përveç kësaj janë detaje dhe mund të dihen vetëm me njoftimin (*khaber*) e Zotit.³³

Në botë, tokat që janë joefikase dhe nuk kanë veçoritë e nevojshme nuk mund të përdoren për qëllime të caktuara. Nëse materiali kryesor i përdorur si tokë nuk ka vetitë e kërkuara, ai nuk mund të përdoret në asnjë mënyrë. Kultura e prituri nuk mund të korret duke mbjellë farat e dëshiruara në të dhe nuk mund të ndërtohen shtëpi dhe ndërtesa të sigurta me të. Po kështu,

**Maturidiu
vendos një
lidhje midis
vetive të tokës
organike dhe
natyrës
njerëzore.**

ajo tokë nuk mund të kultivojë as të mbjella dhe as të bëjë vegla prej saj për nevojat e njerëzve. Situata nuk do të kishte ndryshuar edhe nëse ajo tokë do të lihej të fermentohej për një kohë të gjatë. Për shkak se cilësitë e saj nuk ishin të përshtatshme, ajo nuk mundi të arrinte në këtë fazë dhe nuk mund të arrihej rezultati i dëshiruar.³⁴ Siç e kemi thënë edhe më parë, me këto pohime, Imam Maturidiu nuk i lë asnjë derë të hapur idesë së vetëformimit dhe shfaqjes së ekzistencës domosdoshmërisht me formimin e kushteve.

Siç e përmendëm më lart, Maturidiu shpreh mundësinë që fazat e krijimit të njeriut të përshkruara në Kuran të jenë metafora (*mexhaz*).³⁵ Megjithatë, ai në pjesë të ndryshme të tefsirit të tij *Tëvilat* diskuton në detaje se si këto faza duhet të kuptohen nëse janë të vërteta.³⁶ Tani e tutje, ne do të ndjekim kuptimet e dhëna nga Maturidiu për shprehjet e përmendura për të përshkruar fazat e njeriut duke u bërë njeri, nëpërmjet veprës së tij *Tëvilat*.³⁷

Zoti flet për gjendje të ndryshme në krijimin e njeriut. Për shembull, Ai deklaroi se Ai e krijoi njeriun nga “turab”, që do të thotë tokë e thatë në të cilën nuk është derdhur ujë. Pastaj përmend se e ka krijuar nga “tin”, pra nga dheu që është kthyer në brumë duke derdhur ujë mbi të. Në rastin e “tin lazib”³⁸, që konsiderohet ndër fazat e krijimit të njeriut, ky brumë u bë ngjitës dhe mund të ngjitej me dorë. Sipas një shprehjeje tjetër të Imam Maturidiut, tani ishte bërë një gëlqere e pastër. Më pas ky “tin” u kthye në “sulale min tin”. Me fjalë të tjera, ishte bërë toka më cilësore e filtruar dhe e pastruar nga të gjitha dherat.³⁹ Kjo maja, e cila mund të formohej dhe ngjitej, u errësua si pasojë e pritjes së gjatë⁴⁰ dhe mori një formë tjetër, duke u bërë “hamei mesnun”⁴¹. Më pas u bë “salsal”,⁴² i cili lëshon një tingull kur lëviz dhe i ngjan “fehkharr”⁴³ (që pëlçet kur thahet).⁴⁴ Arsyeja pse quhet “fehkharr” është se është kthyer në këtë gjendje për arsye të tilla si tharja, çarja, ngurtësia në thelb apo pritja e gjatë.⁴⁵

Thelbi që do të përbëjë bazën e strukturës materiale të njeriut është tashmë gati. Por thelbi njerëzor nuk përbëhet vetëm nga materia. Me fjalë të tjera, ajo që i bën njerëzit njerëzor nuk është vetëm substanca e tyre. Në fakt, sipas Imam Maturidiut, asnjë nga këto faza nuk nënkupton një qenie plotësisht njerëzore dhe ato ende nuk janë të përshtatshme për t’u quajtur plotësisht insan. Nuk ka asnjë gjurmë të qenies apo racës njerëzore në to. Në fakt, në këto faza, fuqia e Zotit bëhet më e dukshme.⁴⁶ Sepse Ai kështu deklaroi se Ai është Krijuesi, me ose pa materie, dhe tregon se edhe nëse kushtet materiale janë gati, asgjë nuk mund të vijë në ekzistencë (*vuxhud*) ose të vijë në jetë nga mosekzistenca

Allahu, i cili e rregulloi njeriun dhe e përfundoi krijimin e tij në atë mënyrë që e bëri atë të aftë për të qenë njeri, i fryu shpirtin trupit që e krijoi për t’i dhënë gjallëri.

pa krijimin e Tij. Megjithëse Zoti ia atribuoi njerëzimin dheut ose spermës, Ai nuk na krijoi nga dheu ose sperma, as nga ndryshimet që ndodhin me to.⁴⁷ Atribuimi i qenieve njerëzore atyre vetëm tregon se Zoti i ka zgjedhur këto esenca si origjinën, thelbin ose formën e tyre. Në fakt, paskajorja e krijimit⁴⁸ në etimologji do të thotë: të vlerësosh⁴⁹, që tregon se Zoti i ka vlerësuar këto origjina si një formë, trup fizik⁵⁰ për qeniet njerëzore.⁵¹

Kur përbërja për krijimin e njeriut u bë gati, ishte koha që ato të rregullohen⁵², domethënë të përsosen.⁵³ Nivelimin e njeriut Maturidiu e shpjegon si sigurimin e kërkesave të urtësisë dhe dobive të të qenit njeri. Me fjalë të tjera, shkallëzimi i tij është dizajni i ekzistencës së tij në një mënyrë që tregon njohjen e Krijuesit të tij. Po kështu, formimi i duarve, këmbëve, veshëve, syve dhe gjymtyrëve të tij, të cilat janë dimensionet e dukshme të ekzistencës së tij fizike, është e barabartë me shprehjen e nivelit të dimensionit të dukshëm të qenies njerëzore, domethënë të trupit të tij.⁵⁴ Në këtë dimension

të dukshëm të tij, rëndësi i kushtojë rendit, disiplinës dhe estetikës dhe në këtë kuadër u krye edhe procesi i nivelimit të pamjes së jashtme të tij.⁵⁵ Kështu njeriu më në fund ishte gati të pranonte “jetën/hajat”.

Për atë që mund të përcaktojë, pikëpamjet e Maturidiut për “nivelimin” janë gjithashtu origjinale. Sepse në përgjithësi, koncepti i “nivelimit” kuptohet vetëm në mënyrën e formësimit të trupit material. Për shembull, Taberiu, i cili mund të konsiderohet si bashkëkohës i Maturidiut, dhe Zemahsheri (vd. 538/1144) në veprën *El Keshshaf*, që ishte burimi i komenteve të shkruara pas tij, e shpjegoi “nivelimin” si rregullim të materialit trupor.⁵⁶ Edhe në veprat që trajtojnë këtë temë në kohët moderne, qasja e Maturidiut në shpjegimin e “nivelimit” nuk është dominuese.⁵⁷ Siç mund të kuptohet nga thëniet që kemi cituar më lart, Maturidiu e përkufizoi konceptin e “nivelimit” si përgatitje e një njeriu për të realizuar humanitetin e tij dhe për t’u bërë njeri.⁵⁸ Allahu e ka niveluar, rregulluar dhe kompletuar krijimin e njeriut, materialin e të cilit e ka përgatitur, si trupin e tij, që është dimensionin e dukshëm, ashtu edhe botën e tij të brendshme, në atë mënyrë që ai të mund të njohë veten dhe Krijuesin e tij; të mësojë atë që ai nuk e njeh dhe që e kupton njerëzillëkun dhe qëllimin e krijimit të tij. Njeriu tani ka arritur karakteristikat që i lejojnë të perceptojë ekzistencën dhe krijuesin e tij në botën e tij të brendshme dhe ai ka mjetet për të fituar informacionin që do të jetë burimi i njohjes, mësimi dhe realizimi me organet e tij të niveluara në dimensionin e dukshëm të trupit të tij, gjymtyrët dhe organet

shqisore të trupit të tij. Kështu, ai është gati për frymën e asaj që do ta sjellë në jetë, domethënë shpirtin (*ruh*).

Më në fund, ka filluar faza e fryrjes në këtë qenie madhështore me gjënë (*shej*) me anë të së cilës marrin jetë format dhe trupat, pra shpirti. Allahu, i cili e rregulloi njeriun dhe e përfundoi krijimin e tij në atë mënyrë që e bëri atë të aftë për të qenë njeri, i fryu shpirtin trupit⁵⁹ që e krijoi për t'i dhënë gjallëri, ose thënë me fjalët e Imam Maturidiut: ai u dha jetë njerëzve.⁶⁰ Me krijimin e gjësë në trupin e tij që i jep jetë, njeriu tani ka fituar vitalitet dhe trupi dhe të gjitha organet e tij kanë arritur qëndrueshmëri dhe funksionalitet. Shpirti që përfshihet në trup, siç shpjegon Maturidiu, filloi të përhapet në të po aq shpejt sa era dhe i bëri të gjitha pjesët e tij të gatshëm për veprim dhe të disponueshëm për të kryer funksionet e tyre.⁶¹ Sipas fjalëve të Maturidiut, “me plotësimin e shpirtit, kuptimi i njerëzimit është kompletuar gjithashtu”, pra, qeniet njerëzore, veçanërisht paraardhësit e njerëzimit, janë pajisur me ekzistencë dhe jetë⁶² dhe janë bërë një qenie që ia vlen të kujtohet.

Burimi: Dr. Osman Nuri Demir, *Mâtürîdî'de İnsan Tasavvuru*, Ankara: Diyanet Vakfı Yayınları, 2020.

Përktheu nga gjuha turke: Haki Sahitaj

1) Në fakt, Kurani përmban informacion të gjerë për njerëzit dhe krijimin e tyre. Në këtë kontekst, për shembull, fjala Adem përmendet në 25 vende në Kuran. Shih El Bekare 2/31, 33, 34, 35, 37; Ali Imran 3/33, 59; El Maide 5/27; El A'raf 7/11, 19, 26, 27, 31, 35, 172; El Isra 17/61, 70; El Kehf 18/50; Merjem 19/67; Taha 20/115, 116, 117, 120, 121; Jasin 36/60. 2) Për shembull, ndërsa emrat dhe atributet janë përfshirë në suret Bekare, A'raf, Isra, Kehf dhe Taha; Vetëm atributet e tij përmenden në suret Hixhër dhe Sa'd. Shiko El Hixhër 15/26, 33; Sa'd 38/71, 76. 3) Shih. Ali Imran 36, 59; En Nisa 4/1; El En'am 6/2, 98; El A'raf 7/11, 189; Junus 10/4; El Hixhër 15/26-27; En Nakhl 16/70; El Kehf 18/37, 51; El Enbija 21/37; El Haxh 22/5; Esh Shu'ara 26/75-78; Er Rum 30/20, 40; Lukman 31/28; Jasin 36/20-22, 77-79; Es Saffat 37/11; Ez Zumer 39/6; El Mu'min 40/57, 64; Fussilet 41/21, 47; Esh Shura 42/11; Ez Zukhruf 43/87; El Xhathije 45/3-4; El Huxhurat 49/13; El Alak 96/1-2. 4) Në të kaluarën dhe sot, ka pasur nga ata që kanë mbrojtur pikëpamjen se ka pasur të tjerë Adem para Ademit. Ndoshta, shfaqja e këtyre pikëpamjeve - të cilat janë paraqitur në kundërshtim me pranimin e përgjithshëm - është ndikuar nga përdorimi i zakonshëm i fjalës “Adam” në hebraisht për “Njeriun dhe speciet njerëzore” dhe nga disa transmetime (*rivajete*) me autenticitet të dyshimtë. Kjo fjalë, e cila është përdorur 500 herë në Ahd-i Atik për të nënkuptuar “Llojet e Njeriut”, është përdorur rrallë për të nënkuptuar njeriun ose qenien e parë njerëzore. Përveç kësaj, përdorimi i termit “khalif” për qeniet njerëzore në kontekstin e krijimit në Kuran dhe përmendja e shprehjes “*A do të krijoni dikë në tokë që do të shkaktojë korupsion dhe derdhje gjaku*” në lidhje me engjëjt, dhe kërkimi i pasardhësve që kanë jetuar në tokë para Ademit, bazuar në këto shprehje, mund të konsiderohen si faktorë të tjerë. Për informacion të detajuar, shihni. Erdem, Hz. Adem, f. 118; Süleyman Hayri Bolay, “Adem”, *Türkiye Diyanet Vakfı İslâm Ansiklopedisi*, İstanbul 1988, I, 358. 5) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, V, 8; IX, 70. 6) Po aty, I, 85, 87. 7) Po aty, XI, 270. 8) Po aty, IX, 57. 9) Shih el-A'raf 7/11; el-Hixhër 15/26, 33; Sa'd 38/71, 76. 10) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, IX, 57-58. Në lidhje me këtë temë, İzmirlî İsmail Hakkı - një nga dijetarët e mëdhenj të kelamit të periudhës së fundit - ka pikëpamje të ngjashme me Maturidiun: “Nga ajetet në suret A'raf, Hixhër dhe Sa'd kuptohet se balta, e cila është substanca e parë e njeriut, nuk mori papritur formën njerëzore. Pasi u krijua esenca njerëzore nga balta, ajo u nivelua për një kohë për të marrë formën njerëzore dhe për të arritur nivelin njerëzor, kaloi nëpër shumë faza të vazhdimësisë, ndryshoi nga forma në formë dhe më pas mori formën njerëzore. dhe shpirti njerëzor (*ruh'u insani*) u fry në të. Kjo është arsyeja

pse ajete të ndryshme u referohen shkallëve të ndryshme të krijimit (*meratib-i hilka*).” Shih İzmirlî İsmail Hakkı, *Yeni İlm-i Kelâm*, İstanbul: pa shtëpi botuese. 1341, I, 284 e tutje. 11) Er Rum 30/20; El Kehf 18/37. 12) El Isra 17/61; Es Sexhde 33/7. 13) Es Saffat 37/11. 14) El Mu'minun 23/12. 15) El Hixhër 15/26, 33. 16) Er Rahman 55/14. 17) El Mu'minun 23/12. 18) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, IX, 56-57. 19) Po aty, VIII, 24-25-26; IX, 278-279, 311-312; XII, 270. 20) Po aty, VIII, 24-25-26, 312; X, 11; XIV, 262-263. 21) Po aty, X, 11. 22) Necmettin Çepel, *Toprak İlmi*, İstanbul: İ.Ü. Orman Fak. Yay. 1988, f. 147. 23) Po aty, f. 11. 24) Po aty, f. 11. 25) Po aty, f. 149. 26) Po aty, f. 151. 27) Maturidiu me këmbëngulje thekson se toka dhe sperma nga të cilat janë krijuar njerëzit janë *tajjib*/të pastra. Shih *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 25. 28) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 25. 29) Ebu Davud, *Sunnet*, 16. 30) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 25. 31) Po aty, VIII, 25. 32) Po aty, VIII, 25. 33) Po aty, I, 103-104. 34) Po aty, VIII, 25. 35) Për aq sa mund të përcaktojmë, Imam Maturidiu nuk bën ndonjë zgjedhje nëse transmetimet në fjalë janë të vërteta apo metaforike, dhe ajetet në fjalë i interpreton duke marrë parasysh të dyja mundësitë. Natyrisht, këtu bëhet e nevojshme të theksohen të dyja qëndrimet. Pa dyshim, mungesa e zgjedhjes së Maturidiut nëse ato janë *hakika* apo *mexhaz* mund të shihet si një kontradiktë. Por duhet theksuar gjithashtu se, si kërkesë e sistemit që ndjek, ai përgjithësisht nuk lidhet pas një shprehje të caktuar për çështje që nuk kanë një tekst përfundimtar ose nuk janë racionalisht të qëndrueshme. 36) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 24-25-26; *Te'vilâtü'l-Kur'an*, IX, 278-279, 311-312; Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, X, 11; *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XII, 270; *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262-263. 37) Përzgjedhjes së Maturidiut do t'i kushtojmë vëmendje sipas renditjes së fazave. Sepse, sipas tij, ka mundësi që këta emra të përbëhen nga faza të njëpasnjëshme nëpër të cilat kalon dheu. Shih *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262. 38) Sepse është toka më cilësore dhe më e ngrohtë. Shih *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262. 39) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 27. 40) Gjatë interpretimit të ajetit të parë të sures El Insan, Maturidiu pohon se një nga kuptimet e periudhës së gjatë kohore që thuhet se ka kaluar para qenieve njerëzore mund t'i referohet kësaj periudhe pritjeje para krijimit. Shih *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XVI, 314-315. 41) Tani ishte bërë e zezë dhe – sipas disave – filloi të merre erë. Shiko *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262. Përveç kësaj, Maturidiu thotë se të qenit *mesnun* do të thotë gjithashtu se qeniet njerëzore që do të vijnë pas kësaj origjine do të krijohen në të njëjtin rend dhe karakteristika. Shiko *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 27. 42) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262. 43) Kishte filluar të bënte zhurmë për shkak të zbutjes së tepërt dhe cilësisë së përbërjes. Shiko *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XIV, 262. Në fakt, kjo situatë mund të jetë një pararojë e kësaj karakteristike të njeriut, i cili ka veçorinë e të qenit një krijesë që flet - siç do ta shpjegojmë më vonë. 44) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 24-25-26; IX, 278-279, 311-312; X, 11; XII, 270; XIV, 262-263. 45) Po aty, XIV, 262. 46) Po aty, VIII, 25. 47) Po aty, XI, 168-169. 48) *Et-Tahlik*. 49) *El Takdir*. 50) E kemi thënë më parë se Maturidiu herë pas here e përdorte këtë koncept në kuptimin e substancës thelbësore të ekzistencës. Në kuptimin e substancës thelbësore të njeriut, ai përdor termin “tijnet” së bashku me konceptin “asl”. Për konceptet e *tijnetit* dhe *aslit*, shih. Mâtürîdî, *Kitâbü'l-Tevhîd*, f. 51, 52, 96, 97, 98, 99, 103, 135, 174, 184, 185, 187, 224. 51) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XI, 169. 52) El Hixhër 15/29; El Infitar 82/7. 53) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 28; XVII, 90-91. 54) Po aty, XVII, 91. 55) Po aty, XVII, 91. 56) Taberi, *Xhemi'u'l-Bejan*, IV, 478, V, 102; Zemahsheri, *Tefsiru'l-Keshshaf*, Bejrut: Daru'l-Marife 1430/2009, f. 560, 620. 57) A. Cressy Morrison, *İnsan Evren ve Ötesi* (prkth. Bekir Topaloğlu), İstanbul: Ensar Neşriyat 2010, f. 50; İbrahim Sarı, *Yaratılış*, Antalya: Nokta Kitap 2016, f. 27. Elmalılı Hamdi Yazır, një nga komentuesit e rëndësishëm të periudhës së fundit, e interpreton konceptin e nivelimit me fjalinë e shkurtër vijuese: “Nivelizim, duke e kthyer atë baltë në një krijim të plotë njerëzor, një konsistencë të rregullt njerëzore”. shih. Elmalılı, *Tefsir*, V, 3062. 58) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, XVII, 91. 59) El Hixhër 15/29. 60) Mâtürîdî, *Te'vilâtü'l-Kur'an*, VIII, 28; XVII, 90-91. 61) Po aty, XV, 280. 62) Po aty, VI, 105.

Zekati i kulturave bujqësore

Dr. Muhamed Stublla

Zekati duhet të dhurohet për të gjitha kulturat bujqësore, si p.sh.: grurë, misër, elb, oriz, tërshërë, fasule, spec, lakër, domate, patate, karrot, mollë, kumbull, dardhë, hurme, fiq, aroni, mjedër, dredhëz, shalqinj, pjepër, kungull, portokall, mandarine, pambuk, mjaltë, etj..

Pasi që tani fillon koha e korrije shirjeve apo vjelja e kulturave bujqësore, kërkohet nga bujqit të jenë mirënjohës ndaj Allahut xh.sh., dhe këtë mirënjohje ta dëshmojnë duke dhuruar zekatin prej bereqetit që ju ka dhuruar Allahu xh.sh..

Me dhënien e zekatit, bujkut i shtohet bereqeti dhe e mira, dhe në anën tjetër ndihmohen nevojtarët, forcohen lidhjet shoqërore dhe mbi të gjitha ai fiton kënaqësinë e Allahut xh.sh., meqë Ai është Furnizuesi dhe Poseduesi i vërtetë i pasurisë, kurse ne jemi vetëm shfrytëzues dhe përdorues të saj.

Njeriu duhet të dijë dhe të ketë bindje të qartë, të pa kontestuar se, Furnizuesi i Gjithësisë, Allahu xh.sh., ka garantuar furnizimin e tij. Ky premtim, njeriun duhet ta qetësojë dhe ai të angazhohet me bindjen që Allahu xh.sh., do ta furnizojë atë. Përdërisa kjo është faktike, njeriu duhet të ndjehet i kënaqur me atë që posedon. Të gjithë ne kemi nevojë për Allahun, Zoti xh.sh. thotë: *“O ju njerëz, ju keni nevojë për Allahun e Allahu nuk ka nevojë për ju; Ai është i falënderuari.”* (El Fatir, 15).

Pavarësisht se sa posedojmë pasuri, duhet të jemi modest dhe të mos jemi mendjemëdhenj, sepse para Madhërisë së Allahut xh.sh., të gjithë jemi të varfër. Zoti xh.sh., ua ka garantuar të gjitha krijesave furnizimin e tyre. Ai thotë: *“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj.”* (Hud, 6).

Format e realizimit të premtimit të Zotit xh.sh. janë të ndryshme. Një pjesë të njerëzimit Allahu xh.sh. e ka furnizuar



përmes pasurimit të tyre, nga prodhimet, tregtia, blegtoria, bujqësia, etj.. Ndërsa një pjesë tjetër, furnizimin ia ka siguruar përmes zekatit, obligueshmërisë së dhurimit të një pjesë të pasurisë që duhet të japë besimtari i rritur, i pasur prej pasurisë së vetë për kategoritë me nevojë të shoqërisë islame. Nga kjo kuptojmë se, kontributi i njerëzimit, veçanërisht kontributi i të pasurve për mirëqenien e atyre që kanë nevojë, nuk është çështje e vullnetit të tyre, por është obligim. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: *“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë-zekat, që t'i pastrosh dhe t'i zbukurosh me të.”* (Et Tevbe, 103).

Kurse i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *“Islami është ngritur mbi pesë (shtylla): dëshminë se Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguar i Allahut, faljen e namazit, dhënien e zekatit...”*¹. Niveli i obligueshmërisë së kontributit të secilit, për



mirëqenien e njerëzimit, është konform përqindjes së obligueshmërisë së dhurimit të pasurisë që posedon. Zekati i kulturave bujqësore, është njëri prej tri kanaleve më të rëndësishme të plotësimit të kërkesave të atyre që kanë nevojë. Kjo ishte forma më e lehtë dhe më e fuqishme për të siguruar mirëqenien njerëzore në sipërfaqen e Tokës.

Përderisa Zoti xh.sh. është Ai që na ka krijuar dhe na ka furnizuar, Ai na ka obliguar që përmes një ndihme të këtyre kulturave apo prodhimeve bujqësore t'ju ndihmojmë edhe atyre që kanë nevojë. Njëkohësisht, Zoti xh.sh., porositi për mos përbuzjen e mirësive të Zotit xh.sh., i Cili thotë: *“Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara, hurma dhe bimë, me shije të ndryshme, ullinj e shegë, të ngjashme dhe të ndryshme. Hani frutat e tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre! Por mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprjnë!”* (El Enam, 141).

PËR CILAT KULTURA BUJQËSORE OBLIGOHE ZEKATI?

Allahu xh.sh., urdhëron që zekati të dhurohet për të gjitha kulturat bujqësore. Ai thotë: *“O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës...”* (El Bekare, 167).

Në këtë citat, Zoti xh.sh., po obligon që me një të zekatit të dhurojmë një pjesë të të

**Kulturat
bujqësore, që
janë shumë
sezonale dhe
shpejt prishen,
nuk ka
obliguar që ato
të dorëzohen
në institucion
apo tek
autoriteti
kompetent për
tubimin e
zekatit, por ka
lejuar, që vetë
pronarët ta
dhurojnë
zekatin e tyre.**

gjitha atyre kulturave bujqësore të cilat konsiderohen bereqete të tokës, apo me të cilat konsiderohet se gjallërohet toka. Nga kjo kuptojmë se zekati duhet të dhurohet për të gjitha kulturat bujqësore, si p.sh.: grurë, misër, elb, oriz, tërshërë, fasule, spec, lakër, domate, patate, karrot, mollë, kumbull, dardhë, hurme, fiq, aroni, mjedër, dredhëz, shalqinj, pjepër, kungull, portokall, mandarine, pambuk, mjaltë, etj..

Argument tjetër për llojet e kulturave bujqësore për të cilat duhet të dhurohet zekati, është hadithi i Pejgamberit a.s., në të cilin ka thënë: *“Atë që është ujitur përmes lumenjve apo nga qielli, të dhurohet për zekat një e dhjeta (1/10) pjesë (10%), ndërsa për atë që është ujitur me ujitëse e në mënyrë artificiale, gjysma e saj (1/20) pjesë (5%).”*²

Ky hadith i Pejgamberit a.s., obligon 10% ose 5% zekat për të gjitha kulturat bujqësore, pa përjashtim. Andaj, në hadithin dhe ajetet kuranore, Allahu xh.sh. obligon zekatin e të gjitha kulturave, pa përjashtuar asnjë kulturë bujqësore, pavarësisht llojit të saj.

Mendimi se nuk obligohet zekati në perime, duke u mbështetur në hadithin e Pejgamberi a.s., ku thuhet: *“Nuk ka zekat për perimet”*, nuk është i saktë, pasi që hadithi nuk është i saktë. Asnjë hadith që ndërlidhet me këtë temë nuk është i vërtetë, kështu thotë Imam Tirmidhiu.³ Dobësinë e të gjitha haditheve, të cilat lirojnë nga zekati kulturat bujqësore të perimeve e konfirmon Imam Zejleiu.⁴ Njashtu, pasaktësinë e thënies së këtij hadithi

e shfaqin ajetet dhe hadithi i lartcekur, të cilat citate e obligojnë zekatin e të gjitha kulturave bujqësore, ndër to edhe atë të primeve.

Vlen të potencohet se, e drejta e tubimit dhe mbledhjes së zekatit i takon institucioneve zyrtare apo të autorizuarve të tyre. Pejgamberi a.s., ka organizuar mbledhjen e zekatit të kulturave bujqësore, të cilat nuk prishen shpejt. Ndërsa kulturat bujqësore, që janë shumë sezonale dhe shpejt prishen, nuk ka obliguar që ato të dorëzohen në institucion apo tek autoriteti kompetent për tubimin e zekatit, por ka lejuar, që vetë pronarët ta dhurojnë zekatin e tyre, këtë shpjegim e gjejmë te dijetarët e mirënjohur si p.sh.: El Musiliu, Sadru Sheriah, etj..⁵

Ndërsa hadithet, të cilat obligojnë zekatin vetëm të disa kulturave bujqësore, sikurse që janë: gruri, elbi, hurmat, rrushi i tharë, misri, tekstet e transmetimit të tyre janë të pa harmonizuara, janë në kundërshtim njëra me tjetrën, disa tekste i përmendin katër kultura, nuk e përmendin misrin dhe anasjelltas. Imam Zejleiu thotë:⁶ “Kundërthëniet e teksteve të këtyre haditheve tregojnë për pasaktësinë e tyre. Këto tekste të haditheve kundërshtojnë ajetet e lartcekura dhe hadithin e saktë dhe të qartë, të cilat obligojnë zekatin në të gjitha kulturat bujqësore. Andaj, përderisa tekstet, të cilat obligojnë zekatin e primeve dhe kulturave të tjera të kontestuara, janë pakrahasueshëm më të fuqishme sesa ato tekste të cilat përjashtojnë disa kultura bujqësore, të tillat, nuk mund të përkufizojnë apo të demantojnë ato tekste të pa

Çdo kulturë bujqësore, nëse sasia e prodhimit, arrin 650 kg, është obligim dhënia e zekatit të tyre.

kontestuara, prandaj punohet me ajete dhe hadithe të pa kontestuara.”

Mund të thuhet që, Pejgamberi a.s. ka marr vetëm zekatin e kulturave bujqësore ekzistuese në vendin dhe kohën e tij. Ky interpretim, vije nga dëshira e harmonizimit të teksteve dhe nga parimi i shëndoshë që mundësisht të mos përjashtohen tekstet e hadithit, qoftë edhe përmes një shpjegimi goxha indirekt. Nëse do të ishte parasysh vetëm parimi apo rregulli që vendimi në çështjet dabatuese mes dijetarëve për zekat, rezulton ashtu si është më e dobishme për ata që kanë nevojë, do të mjaftonte të themi se duhet dhënë zekatin për të gjitha kulturat bujqësore. Ndërsa nëse këtë e mbështesim me argumente kuranore dhe

hadithe të sakta, fuqia e të cilave është shumë here më e lartë sesa përkufizimi i zekatit në vetëm disa kultura, atëherë, argumentimi dhe nevoja e të varfërve e determinojnë mendimin se zekati është obligim në të gjitha kulturat bujqësore.

SA DUHET TË JEPET ZEKATI PËR KULTURAT BUJQËSORE?

Deri më tani kuptuam se Zoti xh.sh., ashtu sikurse e ka obliguar zekatin në ari, argjend dhe në kafshë, njashu e ka obliguar zekatin edhe për kulturat bujqësore. Zekati i këtyre pasurive, i cili është obligim, është burim për të garantuar furnizimin e njerëzimit. Në këtë rast, i pasuri është në provim, do ta kalojë apo do ta tradhtojë këtë amanet. Ndërsa i varfëri është në provim që të besojë në furnizimin e Zotit, dhe të durojë e të mos tentojë të pasurohet me haram. Zoti, xh.sh., në Kuran ka obliguar zekatin në kulturat bujqësore, pa përcaktuar sasinë e saj. Ai ka thënë: “...*Hani prej frutave të tyre (kulturave bujqësore) kurdo që të prodhojnë, dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre!*...” Fjala *حَقَّةٌ* d.m.th. ‘të drejtën e tokës’, nuk ka thënë fitimin e saj, e që nënkupton se dhënia e zekatit është obligim për të gjitha kulturat bujqësore, pavarësisht rendimentit.⁷ Vlen të potencohet se ajeti obligon zekatin e asaj që është vjelë, jo të asaj që është ngrënë para vjeljes, e që rezulton se produktet që përdoren për ushqimin ditor, në kopshtet e vogla familjare janë të përjashtuara nga zekati, dhe kjo përmes pjesës së parë të këtij ajeti.⁸

Ajetet e Kuranit janë të qarta se duhet dhënë zekati i të gjitha kulturave bujqësore. Ato, nuk caktojnë se sa duhet të jetë sasia që të fillohet me dhënien e zekatit, që do të thotë, pavarësisht sa është rendimenti, të varfrit gëzojnë të drejtën në prodhimet e tokës. Pra, zekati i kulturave bujqësore nuk ndërlihet me fitimin e prodhimit, por me prodhimin e tokës.



Megjithatë, përderisa për obligushmërinë e arit, argjendit, produktet tregtare, duhet të arrihet nisabi, nivel i caktuar i pasurisë nga e cila fillon llogaritja e obligushmërisë së zekatit; dhe përderisa në kafshë është caktuar numri nga i cili obligohet zekati, edhe për kulturat bujqësore, shumë prej dijetarëve, kanë caktuar sasinë nga e cila fillon obligueshmëria e zekatit. Jo vetëm duke e krahasuar këtë me zekatin e pasurive të tjera, por edhe duke u mbështetur në hadithin e të Dërguarit a.s., i cili ka thënë: “Nuk ka zekat për ato prodhime që janë më pak se 650 kg.” – pesë El Evsuk.⁹

Kështu që, çdo kulturë bujqësore, nëse sasia e prodhimit, arrin 650 kg, është obligim dhënia e zekatit të tyre. Peshimi i kulturave, gjithherë bëhet pasi që të ndahen nga barishtet apo çdo përbërje që nuk është kulturë bujqësore përkatëse. Kjo sasi, nga e cila bëhet obligim zekati i kulturave bujqësore, është lehtësim për bujqit. Këtë mendim e fuqizon, respektivisht me këtë mendim obligohemi të punojmë edhe për faktin se institucioni kompetent fetar, ai administrativ dhe shkencor, thuajse të gjitha, e mbështesin këtë mendim.

Përqindja e zekatit të këtyre kulturave bujqësore mund të jetë e ndryshme. Kjo përqindje ndryshon varësisht nga rruga apo mënyra që është përdorur që ato kultura bujqësore të jenë të gatshme për korrije shirje, vjelje etj.. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Atë që është ujitur përmes lumenjve apo nga qielli, të dhurohet për të, një e dhjeta (1/10) pjesë (10%). Ndërsa për atë që është ujitur me ujitëse, në mënyrë artificiale, gjysma e saj (1/20) pjesë (5%).”¹⁰

Në hadith, tregohet se shkaku i ndryshimit të përqindjes (الصلة), janë shpenzimet, duke përjashtuar mjetet bujqësore, pasi që ato ishin të nevojshme për kryerjen e punëve bujqësore edhe në kohën e Muhamedit a.s., dhe ato nuk ndikuan në zbritjen e përqindjes së zekatit. Në këtë hadith është përmendur ujitja, pra është thënë se, nëse ujitja ishte nga qielli, zekati i kulturave bujqësore është 10%. Ndërsa, nëse investimet zgjerohen jashtë angazhimit fizik dhe teknik të përpunimit të tokës, siç është ujitja, zekati i kulturave bujqësore zbret në 5%. Kësaj natyre, i ngjasojnë edhe shpenzimet jo bazike, siç janë hedhja e plehrave, pesticideve të ndryshme etj.. Andaj, norma juridike duhet të jetë e njëjtë, që do të thotë: zekati i kulturave bujqësore të cilat nuk ujiten, por ju blihen plehra artificiale dhe ju hedhen pesticide të ndryshme, të cilat rritin shpenzimet e prodhimit, përtej farës, përgatitjes së dheut dhe procesit të korrije shirjeve, zekati për kultura është obligim vetëm 5%. Kështu që, nëse ngarkesat financiare rezultojnë me rritje të koston përtej farës, përgatitjes së dheut dhe procesit të korrije shirjeve, ndryshon përqindja e zekatit, vëmendja e dijetarëve të hershëm për situata të tilla është e qartë.¹¹

Në vendin tonë, askush nuk mbjellë kultura bujqësore, nëse nuk mund ta furnizojë tokën me plehra dhe pesticide, rëndësia e të cilave është e ngjashme me rëndësinë e ujit në

vendet e thata. Prandaj, obligohemi të japim zekatin 5%. Çdo kulturë bujqësore trajtohet kështu, sigurisht nëse i ngjason gjendjes së lartë përshkuar. Përfitimi i këtyre plehrave dhe pesticideve rezulton në shumëfishimin e rezultateve të rendimenteve të të mbjellave. Me rritjen e rendimenteve, rritet edhe përfitimi për zekatin, edhe pse përqindja është 5%, kjo sepse si shkak i plehrave dhe pesticideve, rendimentet rriten dukshëm.

Ndërsa nëse nuk furnizohet toka me plehra dhe pesticide, zekati jepet 10%, kështu bujku humb shumë në rendimente, gjithashtu humb edhe përfitimi për zekat, sepse rendimentet zvogëlohen, rrjedhimisht, zvogëlohet edhe përfitimi për zekat. Prandaj, furnizimi i tokës me elemente kimike dhe natyrale i sjellë dobi bujku në rendimente të kënaqshme dhe rritet sasia e zekatit që dedikohet për nevojtarët. E gjithë këtë e themi pas një analize të gjatë të kësaj çështje, dhe konsultave me profesor të fushës, hoxhallarë dhe bujq të shumtë. Nuk mund të kërkojmë përdorimin e përbërjeve kimike për të mbjellat, e të cilat rritin shpenzimet, dhe njëkohësisht të mbajmë përqindjen e njëjtë të zekatit. Është e vërtetë që zekati ndihmon të varfrin, por nuk synon ta dëmtojë bujkun dhe assesi ta ngarkojë me atë që nuk mund ta bartë, apo ta vështirësojë mbijetesën e fermerit. Feja nuk është ngarkesë, nëse e interpretojmë të tillë, gabimi është në interpretim, assesi në fe.¹²

- 1 Muslimi, Ibën Haxhaxh en Nejsaburi, *Sahih Muslim el Musned es Sahih el Muhtasar Binakl el Adël Ani el Adël Ila Resulullahi s.a.v.s.*, recensent: Muhamed Fuad Abdul Baki, (Liban, Bejrut, Dar Ihja et Turath el Arabij), nr.16, 1/45. Ky hadith gjendet te të gjitha koleksionet e njohura të hadithit.
- 2 Hanbel, Ahmed bin, *Musnedi i Ahmed ibën Hanbelit*, recensoi: Shejh Shuajb Arnauti, (Bejrut, Mesesetu er Rrisaleh 2001), nr. 14665, 32/31. Hadith i saktë.
- 3 Imam et Tirmidhiu Ebu Isa, *Sunenin et Tirmidhiu*, recensoi: Dr. Beshar Avad, (Liban, Bejrut, Dar el Garb el Islami, 1998), nr.638, 2/23.
- 4 Ez Zejlaij, Xhemaludin, *Nasb er Rrajeh li Ehadith el Hidajeh mea Hashijetihi Bigajeti el Elmai fi et Tahrir ez Zejlaij*, recensoi: Dr. Muhamed Avameh, (Liban, Bejrut, Muesesetu er Rejan, Litibati ve en Nesher dhe, Arabi Saudite, Xhideh, Dar el Kibleh Lithekafeiti el Islamiyeh 1997) 2/387-388.
- 5 El Musliju, Abdullah Mahmud, *El Ihtijar et Talil el Muhtar*, recensoi: Shejh Shuajb Arnauti (Liban, Bejrut, Mesesetu er Rrisale el Alemije, 2009) 1/364.
- 6 Sadru esh Sheriah, Ubejdullah ibën Mesud, *Sherh el Vikajeh*, recensoi: Prof. dr. Sallah Ebu el Haxh, (Jordan, Amman, Dar el Verrak, 2006), 2/221.
- 7 Ez Zejlaiju, *Nasbu er Rrajeh*, 2/389.
- 8 [] Imam Ibën Xherir et Taberiu, *Tefsir et Taberij*, (Arabia Saudite, Meke, Dar et Terbijetu ve et Turath), 12/161.
- 9 Imam Maturidiu, Muhamed ibën Muhamed, *Tevilat Ehl es Suneh*, recensoi: Mexhdi Baslum, (Liban, Bejrut, Dar el Kutub el Ilmijeh, 2000) 4/284.
- 10 Muslimi, *Sahih Muslim*, nr. 979, 2/673.
- 11 Hanbel, Ahmed bin, *Musnedi i Ahmed ibën Hanbelit*, nr. 14665, 32/31. Hadith i saktë.
- 12 Shih: El Musliu, *El Ihtijar fi et Talil el Muhtar*, 1/364. Imam el Lekneviju, Abdulhaxh, *Umdetu er Rriajeh Ala Sherh el Vikajeh*, recensoi: Prof. dr. Sallah Ebu el Haxh (Liban, Dar el Kutub el Ilmijeh, 2009), 2/463.

Rruga e Zotit është triumfi!

Granit Sadiku

Përkatësia fetare e *Enver Hoxhës* – i cili ishte nip hoxhe, dhe kishte mbiemër që alternonte drejtpërdrejt në përkatësi fetare – ia kishin krijuar atij afilacionin prej një besimtar “fetar mysliman”, i cili do ndikonte që edhe bashkëkombësit e besimit të tij ta ndiqnin rrugën marksiste-leniniste.

Gjëja më e rëndësishme në jetën e njeriut është liria. “Të jesh i lirë” – do të thotë të kesh mundësi të pacenuara për të menduar atë që do, për ta pëlqyer haptas atë që do, e për ta shprehur pa frikë mendimin. Kjo është një ndjenjë fisnike, dhe duhet ta falënderojmë Zotin që na e ka dhënë begatinë e madhe të të qenit të lirë. Por, dikur, diku, nuk kishte liri. Kishte hapësirë tejet të cinguar të shprehjes së mendimit të lirë. Të shprehjes së asaj që njeriu mendon, e beson.

Artikulli të cilin do ta lexoni në vazhdim, ka të bëjë me një periudhë të errët të historisë së Shqipërisë, në të cilën obskurantizmi arriti gradën më të lartë dhe njerëzit nuk arrinin të shikonin me sy të tjerë, pos me sytë e një ideologjie të errët. Tendenca e largimit nga rruga e Zotit ishte ide e çdo komunisti që ka njohur konteksti i kontinentit tonë evropian. Po e theksoj “evropian”, ngase pa e ditur të kaluarën, nuk mund ta ndërtojmë të ardhmen. E proklamimi i paqes dhe lirisë së mendimit sot është gjëja më e bukur dhe më e duhur. Por, nuk duhet të harrohen asnjëherë emrat e nomenklaturave vrastare, të cilat kishin duart e gjakosura me gjakun e njerëzve, që fajin e vetëm të tyre e kishin mendimin ndryshe!

NJË ENVER “MYSLIMAN”

Paraprija e një të keqe njerëzore kurrë nuk duket gjë e madhe. Ajo fillon lehtësisht, si një mospajtim. Pastaj, nga mospajtimi kalohet në qëndrim. Nga qëndrimi në kauzë, e një kauzë mund të krijojë revolucion të tërë. Kush do ta besonte se Shqipëria, vendi më i veçantë në Ballkan për nga përkatësia islame, vend i brumosur kulturalisht për mijëra vite me radhë në religjion, vend i cili edhe në kulturën



tradicionale kanunore e kishte figurën e “Zotit” në qendër, do të kthehej në një vend ateist, duke u bërë kështu vendi i parë ateist në botë!

Ishte viti 1941, kur një djalosh i ri, i cili ishte kthyer nga studimet në Francë – në fakt ishte përjashtuar, ngase kishte marrë bursë pa meritë, dhe si student i “Botanikës” ishte treguar i pasuksesshëm sepse ishte interesuar vazhdimisht për filozofinë e Marksit, Engelsit, Leninit, etj., dhe fahu i botanikës as që i interesonte – do të dilte për herë të parë në publik me idenë që të bëhej anëtar i informbyrosë së formuar nga Miladin Popoviçi dhe Dushan Mugosha – anëtarë të PKJ-së.¹ Ai nuk ishte i thirrur decidivisht me emrin e tij, ndonëse ishte i njohur nga disa pjesëtarë të luftës antifashiste. Por, sipas Todi Lubonjës,² Koço Tashko kishte thënë në

burgun e Burrelit: “Ndër më kryesoret që unë mendova të merrja Enverin me vete në atë mbledhje ishte se ai ishte i besimit mysliman, sepse ne të tjerët ishim të gjithë ortodoksë. Kjo gjë duhej bërë patjetër, sepse duhej një mysliman të përfaqësonte aty gjithë atë popullsi myslimane që kishte Shqipëria.”³

Pra, përkatësia fetare e Enver Hoxhës – i cili ishte nip hoxhe, dhe kishte mbiemër që alternonte drejtpërdrejt në përkatësi fetare – ia kishin krijuar atij afilacionin prej një besimtari “fetar mysliman”, i cili do ndikonte që edhe bashkëkombësit e besimit të tij ta ndiqnin rrugën marksiste-leniniste. Dhe kështu, ai mori pjesë në mbledhjen themeluese të partisë, nga e cila filloi një frymë e re në Shqipëri. Aty Hoxha mirëpritet si luftëtar kundër armikut të përbashkët të të gjitha rrymave që ekzistonin në atë kohë, pra kundër fashistëve e nazistëve, dhe i jepet fjala atij të parit – që ishte përfaqësues i grupit të Korçës,⁴ dhe merr vëmendjen kryesore si nga përfaqësuesit jugosllavë, ashtu edhe nga ata shqiptarë.

Pastaj, dihet rrugëtimi që Hoxha ndoqi drejt pushtetit, por është me rëndësi të theksohet një kuriozitet që është fakt historik. Njëzet vjet pas kësaj ngjarjeje që Koço Tashko e kishte shtyrë drejt pushtetit Enver Hoxhën, ai ishte dënuar me akuza armiqësie me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burg. Familja iu kishte internuar në Laç, dhe ai vetë pas përfundimit të burgimit prej tërë këtyre vitesh, kishte vdekur i izoluar e i harruar po në atë vend.⁵

DISTANCIMI I PUSHTETIT NGA FEJA

Qysh nga viti 1789, periudhë kur ndodhi revolucioni francez, është krijuar pikëpamja laike e sekulare, e cila mëton largimin e fesë nga pushteti. Ky distancim kishte disa arsye, të cilat kishin të bënin me fenë krishtere, në emër të së cilës veçse dihehin të bëmat mesjetare. Ndërsa distancimi nga feja islame, erdhi si pasojë e faktit që përkatësia fetare islame në Evropë krijonte krizë identiteti. Kështu, sistemet politike nuk e luftonin religjionin, por as nuk e përfillnin atë.

Në periudhën Rilindase, kombi Shqiptar pati ngritjen më të lartë të nivelit dituror dhe atdhedashës. Edhe në këtë periudhë veçse kishte filluar ideja e shtetformimit në Shqipëri, dhe ideologët e saj po dëshironin që ta formonin Shqipërinë, e ta formonin shqiptarin. Pashko Vasa, me vargun e tij të famshëm “feja e shqiptarit është shqiptaria” – nxiti në krijimin e një ideje të veçantë kombëtare, në të cilën përzihet nacionalizmi me religjion, dhe këto dy nocione kanë kuptim vetëm atëherë kur përmenden së bashku. Historia njerëzore shembuj të tillë ka parë te hebrenjtë, të cilët fesë së tyre ia kanë bashkangjitur edhe idealet nacionaliste. Pastaj sllavët, të cilët në emër të fesë kanë orientuar shpesh luftërat kombëtare të tyre. Dhe kjo, mendoj unë, nuk ishte ideja e rilindësit Pashko Vasa, ngase ai donte që të krijonte vëllazëri mes feve, e jo ndasi. Por megjithatë, ky postulat i shqiptarëve që njihet e përmendet edhe sot, mori kahje tjetër. Në kohën e mbretit Zog I, në kongresin e vitit 1929, komuniteti mysliman në Shqipëri u detyrua me dhunë që të bënte lëshime të rënda. Sipas dekretit të atij kongresi, gjuha zyrtare e fesë do të ishte



shqipja. Pra, do të ishte e njëjta gjë që kishte vepruar Ataturku në themelimin e Turqisë moderne. Dhe përveç kësaj, shumica e xhamive të cilat ishin trashëgimi kulturore qindravjeçare në Shqipëri, u mbyllën e u defunksionalizuan.⁶

Çështja e fesë ishte e marginalizuar deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore, kur Shqipëria pushtohet nga fashistët italianë dhe nazistët gjermanë. Shqiptarët prapë ishin në fe, dhe e praktikonin fenë të cilën e mbanin për qindra vite me radhë. Kur u krye lufta, sistemi politik në Shqipëri u vendos, Shqipëria socialiste lidhi “krushqi” me Jugosllavinë. Por, miqësia e Hoxhës me Titon nuk zgjati as tri vjet thuajse, dhe i prishën raportet diplomatike mes vete duke i lënë shqiptarët e Kosovës të ndarë me shqiptarët e Shqipërisë për më shumë se 40 vjet. Hoxha kaloi nga miqësia me jugosllavët në miqësi me rusët, me liderin që e kishte shembull – Stalinin. Në arkivat sovjetikë, në prill të vitit 1949, është e regjistruar një bisedë mes Stalinit dhe Hoxhës. Ata po bisedonin ulur përballë njëri-tjetrit. Stalini kishte prapa një histori të lënë në gjysmë si ish-seminarit që nuk kishte arritur dot të bëhej prift. Hoxha mësimet e para të jetës i kishte marrë në mejtep. Dhe kështu, biseda e tyre kishte marrë kahje fetare:

- Ju shoku Enver e hani mishin e derrit? – pyeti Stalini befas, ndërsa ngacmonte me lugë gjellën e ftohtë që kishte përpara në tastin metalik.

- Po, iu përgjigj Enver Hoxha.

- Feja myslimane jua ndalon këtë gjë besimtarëve të saj, - tha ai dhe pastaj shtoi: - zakoni i vjetër, që i ka ikur koha. Sidoqoftë, - vazhdoi, - çështja e besimeve fetare duhet pasur parasysh, duhet vepruar me shumë kujdes, sepse nuk mund të merren nëpër këmbë ndjenjat fetare të popullit. Këto ndjenja janë kultivuar prej shekujsh te njerëzit dhe duhet

vepruar me shumë maturi. Se ky qëndrim ka vlerë për kompaktësinë dhe unitetin e popullit.⁷

Kjo ishte biseda mes dy diktatorëve të egër, të cilët po diskutonin në tavolinën e tyre se si duhet të nënshtrohet një popull i cili është besimtar. Stalini duket këtu më “i butë” sesa Hoxha, ngase ai nuk e këshillon për ndalimin total të fesë, por nuk i rekomandon ta bëjë një gjë të tillë. Ndërsa “nxënësi” këtu doli përtej mësuesit, dhe në vitin 1967 zyrtarisht me dekret të partisë, me fjalimin famëkeq që mbajti kundër ndikimit të klerit në popull, e ndaloi fenë në Shqipëri dhe e shpalli atë vend ateist. Me këtë akt, pothuajse të gjitha pronat e xhamive dhe kishave u shtetëzuan. U rrënuan mijëra xhami e kisha. U dogjën librat fetarë, e librat e shenjtë. Qindra mijëra hoxhallarë e priftërinj u arrestuan, e u dënuan me burgime, e me vrasje. Duke ndjekur revolucionin kulturor kinez, një ndër revolucionet më famëkeqe gjakpirëse të njerëzimit, “gardistët e kuq” i merrnin hoxhallarët dhe ua rruanin mjekrat e tyre publikisht. I hapnin varret ku bektashinjtë kishin ndërtuar tyrbe, dhe eshtrat e të vdekurve i hidhnin në lum, e disa të tjera i flaknin pa kurrfarë konsiderate njerëzore.

Sa herë që të duam ta kuptojmë vlerën e fesë dhe besimit në Zot te njeriu, le të kthehemi te këto kujtime të errëta të historisë shqiptare. Tani parulla “feja e shqiptarit është shqiptaria” kishte kaluar në një ekstremitet të madh: “shqiptari s’ka fe, s’ka Zot, ka vetëm parti!”. Ky parim nuk ishte i rrezikshëm vetëm atëherë, por është i rrezikshëm akoma për ata që kanë lindur e kanë jetuar në atë kohë. Shqipëria ishte në kolaps. Në vitin 1976, Shqipëria, në bazë të sanksionimit të ateizmit në Kushtetutën e re të Republikës Popullore Socialiste, ishte aktualisht vendi i vetëm ateist në gjithë globin.⁸

RËNIA E ATEIZMIT, NGRITJA E FJALËS SË ZOTIT

Vitet 1990-91 në Shqipëri sollën një ndryshim të madh revolucionar. Grup i madh i studentëve, qytetarëve, e njerëzve të cilët kishin më shumë se 40 vjet që vuanin nën thundrën komuniste, e cila i kishte izoluar nga bota, ishin ngritur në një protestë për rrënimin e gjithmonshëm të këtij sistemi. Ashtu si çdo perandori e kësaj bote, ashtu si çdo mbretëri e çdo sistem tjetër, edhe këtij sistemi po i vinte fundi. Kryetari i atëhershëm i shtetit, Ramiz Alia, vendoset para aktit të kryer për reformimet e domosdoshme që duhet të bënte: hapjen e kufijve, heqjen e embargove, ndryshimet e vendimeve për shumë të burgosur politikë, lejimin e praktikimit të fesë, etj.. Në shkurt të vitit 1990, shkrimtari i njohur, Ismail Kadare shkon ta takojë presidentin e atëhershëm Ramiz Alinë. Aty zhvillohet një bisedë, e cila është tani e arkivuar nga shteti, por edhe e botuar në trajtën origjinale në veprat e Kadaresë. Kadare, ndër të tjera jep idenë e lejimit të fesë në Shqipëri. Ndonëse tingëllon si ide liberale, ajo nuk kishte qëllim të tillë!

Kadare propozon që të hapen kishat në Shqipëri, e jo xhamitë, ngase – sipas tij, - këto vite duhet të kenë qenë të mjaftueshme për shqiptarët për t’u kthyer në identitetin e tyre të vërtetë evropian. Ai në një libër të tijin kishte deklaruar se:



Hafëz Sabri Koçi

“Ndërsa në vendet e tjera feja zotëruese e krishterë ndihmonte për ndarjen nga tradita otomane, në Shqipëri, ajo traditë mund të strehohej pikërisht pas fesë zotëruese, myslimanizmit. (Parazitë të shumtë do t’i ngjiteshin kësaj feje, sidomos në shekullin e njëzetë, duke përfshirë edhe të fundit, atë më të rrezikshmin, terrorizmin).”⁹

Ai e kishte dëshmuar këtë ide edhe në një rast tjetër, kur i kishte dërguar letër Papës së Romës, gjatë vitit 1991, me të cilën letër kishte tumirur faktin se rinia shqiptare ishte e gatshme ta pranonte fenë e vërtetë të të parëve të lashtë, ashtu siç kishte bërë Skënderbeu, dhe të shlyente gabimin e paraardhësve të tyre të cilët e kishin pranuar Islamin “me dhunë”. Ndonëse Kadare i ka kërkuar falje publikut të tij shqiptar, i cili ka përqindjen më të madhe të përkatësishë islame, prapë se prapë këto tendenca mbeten në memoaret e myslimanëve shqiptarë. Myslimanët falin, ngase ashtu i ka mësuar Zoti. “Por të falësh, nuk do të thotë të harrosh!”.

Ajo që ndodhi në rrafshin praktik në këto vite, përkundër shtrëngimit të duarve që po bëhej nën tavolinë për të mos e parë askush, ishte krejt mrekulli! Shqiptarët e kishin akoma kërcin e pa ujitur të besimit, i cili kishte gati gjysmë shekulli që po priste për pak dritë. Tani drita Hyjnore kishte depërtuar dhe kishte ngadhënjyer mbi çdo përpjekje që ishte bërë për ta rrënuar atë.

XHUMAJA E PARË PAS 23 VJETËSH ATEIZËM

Nga viti 1944, kur zyrtarisht komunistët e kishin marrë në dorë pushtetin në Shqipëri, kishte ndodhur masakra e Tiranës, ku ishin pushkatuar një numër intelektualësh, hoxhallarësh e veprimtarësh të çështjes kombëtare, të cilët ishin shpallur armiq të sistemit. Drejtuesit e Medresesë së Tiranës, pedagogët e mësimdhënësit ishin arrestuar e ishin

përndjekur dhunshëm nga vendi i tyre i punës. Shumë hoxhallarë e veprimtarë kombëtare që kishin afilacionin islam, ishin burgosur me vite të gjata burg, ndër të cilët njihen: hfz. Ali Korça, hfz. Ibrahim Dalliu, hfz. Ismet Dibra, hfz. Sabri Koçi, Haki Sharofi – kryeredaktor i revistës “Zani i Naltë”, Ismail Muçej, Haxhi Faik Hoxha, H. Mustafa Varoshi, hfz. Sherif Langu, hfz. Esat Myftia, hfz. Musa Dërguti, hfz. Ali Kraja, dhe hafëz Selim Braja – i cili ishte pushkatuar, - e shumë e shumë të tjerë.¹⁰ Zoti i Madhëruar ua pastë shpërblyer mundin dhe sakrificën e këtyre njerëzve, që e kanë bërë vetëm me qëllimin e ngritjes së fjalës së Zotit!

Njëri nga hoxhallarët e sipërpërmendur, hfz. Sabri Koçi, kishte vuajtur 20 vjet e katër muaj burg përgjatë periudhës komuniste. Në vitin 1990, me rrënimin e sistemit dhe fillimin e praktikimit të fesë në Shqipëri, ai ishte bërë kryetari i parë i Komunitetit Mysliman në Shqipëri. Në datën 16 nëntor të vitit 1990, afro 55000 (pesëdhjetë e pesëmijë) njerëz ishin mbledhur te Xhamia e Plumbit në Shkodër, për ta falur namazin e parë të xhumasë pas 23 vjetësh pamundësi të faljes e të besimit në Zot. Në këtë datë akoma nuk ishte definitive liria e faljes dhe e praktikimit të fesë. Por, kjo gjë nuk i ndaloi njerëzit fare nga ajo ndjenjë besimi, e cila u kishte mësuar për vite me radhë. Kur shteti e pa insistimin e madh të njerëzve dhe tubimin masiv të tyre në xhami, u detyrua të lëshonte një dekret për lejimin e faljes së namazit të xhumasë.

Hafëz Sabri Koçi po i printe faljes së namazit të xhumasë. Në momentin e mbajtjes së një tribune para tërë asaj mase të madhe popullore që ishte prezent, hafëz Sabri Koçi, u drejtohet njerëzve me fjalë emocionale, kur ndër të tjera thotë: “Vllazën dhe motra, mysllimanë, katolikë dhe ortodoksë, mbi të gjitha - vëllezën shqiptarë, u hapën portat zemrave që popullin të lënë të lirë, që të gëzon atë që do zemra e tij. Nuk ka imponim në fe, s’duhet t’ia imponojsh (fenë) kur ai ta ketë të kultivume vetvetiu në shpirtin e tij.”¹¹

Vërtet u hapën zemrat e drejtuara nga Zoti i Madhëruar. “Kjo ishte një nga argumentet e Allahut. Atë që e udhëzon Allahu, ai vërtet është udhëzuar, e atë që e humb, ti nuk do të gesh për të ndihmës që do ta udhëzonte.” (El Kehf, 17).

Sa shumë përpjekje janë bërë, e vazhdojnë të bëhen për ndalimin e kësaj rruge! Sa njerëzit kanë thurur traktate, e kanë krijuar sisteme, e kanë nisur luftëra të mëdha për ndalimin e rrugës Hyjnore, por prapë se prapë ka qenë e pamundur të bëhet një gjë e tillë. Ai që tenton t’i dalë përpara rrugës së Zotit që ta ndalë është sikur shembulli i një njeriu që dëshiron ta ndalë një tren duke i dalë para e duke tentuar ta shtyjë me duar. Kjo fe është sikur një “tren” - ata që duan të hipin në të i merr e nuk i lë asnjëherë të vetmuar, ndërsa ata që tentojnë t’i dalin para e ta ndalin, padyshim se do të depërtojnë mes tyre!

Efëkti i kësaj hytbeje të parë ishte i mahnitshëm dhe vazhdon të mbesë akoma te të gjithë popujt e tjerë që e njohin sadopak rrugëtimin e Shqipërisë ndër vite. Kjo ngjarje ishte argument

i gjallë se nuk ka fuqi më të madhe sesa fuqia e Zotit, dhe nuk ka njerëz më të pastër sesa ata që bartin në shpirtin e tyre besimin e çiltër ndaj Krijuesit. Porositë nga kjo hytbe janë të gjithkohëshme, ashtu siç janë parimet e tjera islame të cilat nuk janë të kufizuara për kohë të caktuar, por janë të efektshme për çdo periudhë kohore. Hafëz Sabri Koçi ishte ndër hoxhallarët më të ngritur të Shqipërisë, i cili meriton lavde për punën e tij të palodhshme jo vetëm ndaj komunitetit myslliman, por edhe ndaj të gjithë shqiptarëve në përgjithësi. Ai donte ta ngrite vetëdijen mbarëpopullore të shqiptarëve, të cilët po fillonin një fazë tranzicioni tejet të rëndë. Fjalët e tij do të mbeten kujtesë e pashlyer e këshillës së mirë, të bukur, e të dobishme – ashtu siç ka porositur edhe Zoti në Kuran. Në një nga fjalimet e tij, hoxha i nderuar thoshte: “Allahu xh.sh. na e forcoftë unitetin, dashurinë dhe respektin për njëri-tjetrin! Edhe të ruhem i mos e shesim me pare fenë! Të mos e shesim me pare atdheun! Përndryshe do ta çojmë në greminë këtë atdhe! Është një prej degëve të imanit që ta duash atdheun, e ta duash popullin tënd që jeton në të, dhe të kesh marrëdhënie të mira me të gjithë ata që ta duan të mirën si atdhe, si komb dhe si besim. Allahu na mëshiroftë të gjithëve, dhe ju e gëzofshi këtë rahmet të madhit Zot!”¹²

Kjo periudhë e errët komuniste e cila zgjati gati gjysmë shekulli, pati efekt vërtetësie të besimit në mbarë popullin shqiptar. Ata që e deshën besimin në Zot, Zoti ua mundësoi që të ktheheshin prapë në besimin e pastër. Ndërsa, ata që e deshën ateizmin e rrugën e humbjes, nuk e hapën dot kyçin me të cilin Allahu ua kishte mbyllur zemrat. Ai që e beson Zotin asnjëherë nuk duhet të ketë drojë apo frikë për çështjen e tij, ngase rruga e Zotit është gjithmonë triumfi!

“Thuaj: e vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë le të besojë, e kush të dojë le të mohojë.” (El Kehf, 29).

1 Blendi Fevziu, *Enver Hoxha*, UETPRESS, Tiranë, 2014.

2 Todi Lubonja kishte qenë njëri nga prijësit e grupeve që në vitin 1942 kishin ndjekur “armiqtë” e supozuar të partisë – shumica e të cilëve ishin të pafajshëm, për t’i ekzekutuar. Në sistemin komunist, Lubonja kishte detyra të rëndësishme, si: sekretar partie në rajonin e Elbasanit, më pas sekretar i parë i organizatës “Rinia Komuniste”, ku kishte qëndruar deri në vitin 1964. Në vitin 1972 ishte caktuar drejtor i Radio Televizionit Shqiptar në Tiranë. Për shkak të një shfaqjeje, e cila ishte më “liberale” sesa që duhej, që ishte festivali i 11-të i këngës në RTSh, Lubonja dënohet me 15 vjet burg të rëndë. Në burg ka rastin t’i takojë edhe disa figura të njohura të asaj kohe, të cilët ishin shënjestruar nga Enver Hoxha dhe ishin burgosur, e një nga ta ishte Koço Tashko – një nga njerëzit më të rëndësishëm në rrugën e Hoxhës drejt pushtetit.

3 Todi Lubonja, *Nën peshën e dhunës*, Kujtime, Tiranë, 1994.

4 Blendi Fevziu, *Enver Hoxha*, po aty, f. 62.

5 Po aty, f. 62.

6 Ben Andoni, *Fjalori religjioz në trupin e tekstit artistik*, PEN KOSOVA – Revistë kulturore letrare, Nr. 4., Prishtinë, 2022, f. 68.

7 Blendi Fevziu, *Enver Hoxha*, po aty, f. 193.

8 Po aty, f. 253.

9 Ismail Kadare, *Identiteti evropian i shqiptarëve*, Onufri, Tiranë, 2006.

10 Referencë marrë nga dokumentari: “50 vjet nga ndalimi me ligj i fesë në vendin tonë”, Universiteti Bedër, 2017.

11 Shih linkun: <https://www.youtube.com/watch/>

12 Po aty.

Kush është “Ebu Bekri” yt?!

Blerim Musliu

Para se ta pyesim vetën se a kemi ne një “Ebu Bekër” në jetë, duhet ta shohim vetveten se sa jemi ne në jetësimin e shëmbëlltyrës së të Dërguarit a.s., që ta kemi dikë që na beson e na do, ashtu siç ishte shembulli i Ebu Bekrit.

Në historinë e njerëzimit kanë jetuar numër aq i madh i njerëzve, saqë këtë e di vetëm Ai që i ka krijuar dhe tek Ai i cili janë kthyer. Në këtë numër të jashtëzakonshëm, a kemi menduar ndonjëherë se emrat e atyre që kanë mbetur të skalitur në histori janë pothuajse të papërfillshëm, në krahasim me numrin e atyre që kanë jetuar, të cilët është detyruar historia që t'i përmend e të shkruajë për ta.

E në mesin e tyre s'ka dyshim se në majat e tyre qëndrojnë të përzgjedhurit e Zotit.

Të jesh i përzgjedhuri i Zotit nuk është në dorën tënde, por të shoqërohesh me njerëzit e përzgjedhur nga Zoti, të jesh në shërbimin e tyre, të kujdesesh për ta, t'i ndihmosh e t'i duash ata, e që kjo dashuri të përkthehet në përkrahje të pakursyer, kjo që po është në dorën tënde.

Një rast të tillë të një njeriu madhështor historia e kishte parë nga afër, e të cilit ajo i ka borxh për arsien se i tregoi asaj se çka mund të ofrojë njeriu kur beson dhe e do dikë.

Madje, edhe të jesh i Dërguar i Zotit do të thotë të kesh nevojë për një Ebu Bekër, e kjo është mrekullia e funksionimit të kësaj bote, ku i vetmi që ka pavarësi absolutet është Allahu, Zoti i botëve. Të gjithë nën Arshin e Tij kanë nevojë për dikë, e që ky dikush të jetë i veçantë e të mbetet në histori duhet të jetë një “Ebu Bekër”, edhe nëse është në miniaturë.

Por kush është “Ebu Bekri” yt?! Para se ta pyesim vetën se a kemi ne një “Ebu Bekër”

në jetë, duhet ta shohim vetveten se sa jemi ne në jetësimin e shëmbëlltyrës së të Dërguarit a.s., që ta kemi dikë që na beson e na do, ashtu siç ishte shembulli i Ebu Bekrit.

Ajo çfarë bëri Ebu Bekri është një produkt i pa kopjuar nga dikush tjetër. Të ndalemi pak e ta mendojmë shoqërimin e tij me të Dërguarin para shpalljes! A mund ta imagjinoni kur dy shokë të pandashëm ndajnë të gjitha momentet bashkë dhe për një çast njëri prej tyre deklaroi se është graduar me gradën më të madhe që mund të gradohet dikush, pra deklaroi se është i përzgjedhuri i Zotit dhe se përfundimisht do të mbetet njeriu më i veçantë në historinë e njerëzimit?! Pa dyshim se sfida më e madhe për shokun e tij është që ta pranojë këtë dallim dhe këtë gradim. E sikur të kishte vetëm sa grimca e atomit xheloz, mendjemadhësi, apo sikur edhe vetëm një herë në jetë të ishte mashtruar nga shoku i tij, apo të ishte gënijyer, pa asnjë dilemë se do të kishte shumë arsye të mos i besonte e ta kundërshtonte.

Por ai dha shembullin e papërsëritshëm të asaj se çfarë bën forca e besimit dhe njohja e mirë e shokut. Pa asnjë mëdyshje e pa asnjë hezitim, ai i tha se të pranojë për të Dërguar të Zotit, dhe jo vetëm kaq, por vendosi në shërbim të tij jetën, familjen, pasurinë, pozitën, duke mos ju ndarë asnjëherë e duke u bërë modeli e shembulli më i mirë se si duhet të jetë një “Ebu Bekër” në jetë, madje edhe për të Dërguarin e Zotit.

Nëse i Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s., kishte nevojë për një të dërguar, nuk vihet në

dyshim se ne kemi nevojë shumë më të madhe për një “Ebu Bekër”.

Kush është “Ebu Bekri” yt, që jeta, sfidat, ndryshimi i pozitave e angazhimet në jetë nuk e lënë ta zbehin dashurinë e pozitën tënde në zemrën e tij?!

Kush është “Ebu Bekri” yt, tek i cili pasuria nuk ka ndikuar në largimin e tij, por pasurinë e ka vendosur si mjet të qëndrimit afër dhe afrimit edhe më të madh pranë teje, ashtu siç bëri Ebu Bekri, i cili jo në pak raste, por gjithherë mendjen e kishte tek i Dërguari a.s.. Kjo vërehet qartë edhe në ekspeditën e Tebukut, kur Omeri r.a., kishte marrë gjysmën e pasurisë dhe kishte thënë se sot po ia tejkaloi edhe Ebu Bekrit. Por, kur erdhi, ai gjeti atë, Ebu Bekrin, me tërë pasurinë e tij para të Dërguarit a.s.. Kur e pyeti për këtë, se çfarë u la familjes, Ebu Bekri r.a., tha se ua kam lënë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Këtu Omeri r.a., sikur ngrehi flamurin e dorëzimit se asnjëherë nuk ia kaluar Ebu Bekrit në shpenzim dhe në shërbim të të Dërguarit të Zotit.

Kush është “Ebu Bekri” yt, tek i cili mjafton që dikush t’i thotë atij se ti ke thënë diçka dhe ai, duke të njohur ty, e di se ti nuk flet gënjeshtër, madje edhe nëse nuk të ka takuar, e beson një veprim tëndin, duke qenë i bindur se ti nuk bën asgjë për vetën tënde, por vetëm atë që Zoti është i kënaqur me të?!

Kur i kumtuan lajmin se shoku i tij, i Dërguari a.s., po thoshte se ka shkuar në një pjesë të natës nga Qabeja në Jerusalem, e nga aty në qiellin e shtatë në takim me Allahun, për kurejshit ky ishte një moment i favorshëm që të fusnin dyshime tek Ebu Bekri. Por, ende pa e takuar të Dërguarin a.s., që ta pyeste për një gjë të tillë, Ebu Bekrit i mjaftoi dëshmia se ka thënë ai, dhe e besoi atë. Ngase ai tha se, unë i kam besuar se ai është i Dërguar i Zotit, e kjo më mjafton. Pra, ai e njihnte atë dhe e dinte se ai nuk fliste dhe nuk bënte asgjë veçse të vërtetën, prandaj edhe e mori nofkën “i sinqerti” dhe “i vërteti”. Për një të tillë “Ebu Bekër” kemi nevojë në jetë.

Kush është “Ebu Bekri” yt, i cili për shoqërimin me ty, jo që do të gjej arsye për të mos shoqëruar, por madje do të sakrifikoje gjithçka, e madje do të rrinte i gatshëm, ashtu siç bëri Ebu Bekri në Hixhëret, ku ishte përgatitur me muaj, madje edhe pa e ditur se do ta shoqëronte të Dërguarin a.s., apo jo, por me rëndësi për të ishte që kur t’i vinte momenti mos t’i ikte një gjë e tillë?!

Aisheja, Zoti qoftë i kënaqur me të, tregon se kur i Dërguari a.s., erdhi për ta përzgjedhur Ebu Bekrin r.a., për rrugëtimin e Hixhëretit, ajo nuk ishte një përzgjedhje e rastësishme, ngase Zoti kishte parë se Ebu Bekri r.a., ishte përgatitur me zemër dhe në praktikë për këtë. E kur Pejgamberi a.s. ia dha lajmin e Hixhëretit, Aisheja r.a., thotë se nuk kam parë njeri të qajë ashtu nga gëzimi. Ai ishte i gatshëm për atë udhëtim, madje i përgatitur qysh kohë më parë, ani pse nuk e dinte se a do ta shoqëronte atë apo jo, duke sakrifikuar familjen e rrezikuar jetën. Por, kjo e bëri që ai të mbetet i përmendur në Kuran: **“Mos u mërzit, Allahu është me ne!”** (Et Teube, 40).

Kush është “Ebu Bekri” yt, për të cilin ti, para vdekjes do t’u thuash trashëgimtarëve se është një njeri që s’ke arritur t’ia



**Zgjidh të
bëhesh ti “Ebu
Bekri” i dikujt,
nëse për ty
ende nuk u bë
askush “Ebu
Bekër”!**

kthesh mirësitë në këtë botë, por e pret Ditën e Llogarisë për të dëshmuar para Madhërisë së Zotit për mirësitë e tij, e pastaj të kënaqesh kur Zoti do ta shpërblejë atë me xhenetet mahnitëse?!

A e ke në jetë ndonjë “Ebu Bekër”, që nuk imagjinohet të përmende emri i tij e të mos asociojë me ty, dhe e kundërta, sa herë që përmendsh ti, ai të jetë pjesë e jotja?!

Ebu Bekri ishte i tillë nga njerëzit e parë që pranuan Islamin dhe njeriu që më shumë se gjithçka shpenzoi nga koha. Përmendja me krenari e Pejgamberit a.s., se e donte shumë Ebu Bekrin, shoqërimin me të në Hixhëret, e deri te falja pas tij si imam, sikur bëhen emër i pandarë nga ai i të Dërguarit a.s..

Eh për sa “Ebu Bekrat” kemi nevojë ne në jetë?

E për të pasur një “Ebu Bekër”, ti duhet të jesh me moral, edukatë, sjellje e butësi si i Dërguari i Zotit a.s..

Nuk është e pamundur, mjafton të bashkohen ambiciet në jetë, e rrugëtimi i përbashkët të shihet si mundësi e jo si konkurrencë, ngase Pejgamberi a.s. ishte i përzgjedhur, por Ebu Bekri nuk humbi asgjë kur u rreshtua krah tij me gjithë atë çfarë kishte, për dallim prej Ebu Lehebit, i cili ishte xhaxhai i tij, por mbeti në faqet e errëta të historisë.

Afërsinë dhe largësinë shpesh nuk e përcakton gjaku dhe familja, por besimi dhe mirëbesimi, të cilat kurorëzohen me dashuri e ambicie të përbashkëta.

Ne, një ditë nuk do të jemi, por edhe për ne dhe për shoqëruarit tanë diçka do të thuhet.

Zgjidh të bëhesh ti “Ebu Bekri” i dikujt, nëse për ty ende nuk u bë askush “Ebu Bekër”!

Seuda bint Zumah – e veja që e martoi Pejgamberi a.s.

Samire Bilalli

Sipas Ibën Umerit r.a., Pejgamberi a.s., u martua me Seudën në muajin ramazan, në vitin e dhjetë pas shpalljes. Kjo martesë u bë pas vdekjes së Hatixhes dhe para martesës së Pejgamberit a.s., me Aishen r.a..

“Pejgamberi është më i ndjeshëm ndaj besimtarëve sesa ata ndaj vetvetes së tyre, ndërsa gratë e tij janë në vend të nënave të tyre.” (El Ahzab, 6); “Juve nuk ju takon ta shqetësoni të Dërguarin e Allahut, e as të martoheni kurrë me gratë e tij, pas (vdekjes së) tij. Këto tek Allahu janë mëkat i madh.” (El Ahzab, 53).

KUSH ISHTE SEUDA BINT ZUMAH, PARA SE TË BËHEJ BASHKËSHORTJA E PEJGAMBERIT A.S.

Seuda bint Zumah, Allahu qoftë i kënaqur me të, ishte gruaja e parë, e cila emigroi në Abisini me grupin e dytë, së bashku me bashkëshortin e saj. Ajo ishte e martuar me Sekran bin Amrin, vëllain e Suhejl bin Amrit. Seuda lindi dhe u rrit në Meke, në Arabinë paraislamike. Babai i saj, Zamah ibën Kajsi,

ishite nga fisi Benu Amir i fisit Kurejsh në Meke, ndërsa nëna e saj, Shemsu bint Kajsi, ishte nga fisi Nexhar i fisit Hazraxh në Medine. Gjatë rrugëtimit të saj, kthimit nga Abisinia për në Meke, bashkëshorti i saj, Sekran bin Amri vdiq, duke e lënë Seudën të vejë me gjashtë fëmijë. Pas vdekjes së tij, ajo mbeti të jetonte me babanë e saj të moshuar. Seuda mbeti e ve në moshë të mesme, dhe cilësohej si një grua dashamirëse e madhe.

HEZITIMI PRA PRANIMIT

Pas vdekjes së Hatixhes, Allahu qoftë i kënaqur me të, gruaja e parë me të cilën u martua Pejgamberi a.s., ishte Seuda bint Zumah. Por, para propozimit, ajo hezitoi dhe nguroi që të martohej me Pejgamberin a.s., për shkak të respektit të madh që kishte ndaj tij a.s., si dhe për faktin se pas vetes kishte gjashtë fëmijë. Pejgamberi a.s., e pyeti: “Çfarë





është ajo që të pengon të martohesh me mua?” Ajo u përgjigj: “O i Dërguari i Zotit, asgjë nuk më pengon që të martohem me ty, ngase ti je njeriu më i dashur për mua dhe unë të respektoj shumë. Por si kam për t’i lënë këta fëmijë të vegjël të ulërijnë rreth kokës sate gjatë gjithë kohës.” Pejgamberi a.s. i tha: “A ka ndonjë gjë tjetër që ju pengon të martoheni me mua?” Ajo u përgjigj: “Jo, për Zotin!” Atëherë Pejgamberi a.s., i tha: “Gratë më të mira që kanë rrugëtuar mbi devetë e tyre janë gratë e virtytshme të kurejshëve, të cilat janë më të dashurat ndaj fëmijëve të vegjël dhe më të shkëlqyerat në sjelljen e mirë ndaj burrave të tyre kur ato janë të pasura.”¹

ËNDRRA QË MË VONË DO TË BËHEJ REALITET

Seuda, Allahu qoftë i kënaqur me të, siç e përmendëm edhe më lartë, para se të martohet me Pejgamberin a.s., ishte e martuar me Sekran bin Amrin, vëllain e Suhejlit. Një natë, ajo pa në ëndërr se Pejgamberi a.s. teksa ecte, shkeli në qafën e saj. Kur i tregoi për këtë ëndërr burrit të saj, ai i tha: “Pasha jetën e babit tënd, nëse ëndrra jote është e vërtetë, atëherë unë do të vdes dhe Muhamedi do të martohet me ty.” “Zoti na ruajt!” – tha ajo. Seuda e tha këtë për ta larguar idenë e

komentimit të ëndrrës nga burri i saj. Një natë tjetër, ajo pa në ëndërr një hënë që binte mbi të nga qielli, teksa ajo ishte e shtrirë. Kur edhe këtë ëndërr ia tregoi burrit të saj, ai i tha: “Pasha jetën e babait tënd, nuk do të kaloj shumë kohë që unë të vdes dhe ti do të martohesh me Pejgamberin.” Që nga ajo ditë, Sekrani vuajti nga disa ankesa dhe nuk kaloj shumë kohë e ai vdiq.²

PROPOZIMI PËR MARTESË

Transmetohet se pas vdekjes së burrit të Seudas, ajo që ia propozoi Seudan Pejgamberit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ishte Havla bint Hakim bin el Evkas es Sulemijeh, gruaja e Othman bin Mazunit. Ajo erdhi tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, dhe i tha: “O i Dërguari i Zotit, ju shoh të pikëlluar për humbjen e Hatixhes?” Ai tha: “Po, ajo ishte nëna e fëmijëve dhe e zonja e shtëpisë.” Ajo i tha: “A të të propozoj (dikë)?” Ai tha: “Po, ju femrat jeni më të ndjeshme ndaj kësaj.” Havla ia propozoi Seudan dhe kur Seuda e përfundoi periudhën e idetit, i Dërguari i Allahut, lavdia dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, i propozoi për martesë. Ajo pranoi, duke e ndjerë se ishte një nder i madh. Seuda shkoi menjëherë të jetonte në shtëpinë

Seuda jetoi deri në fund të kohës së udhëheqjes së kalifatit nga Omer ibën el Hatabi. Pas vdekjes së Muhamedit a.s., Seuda, së bashku me gratë e tjera, morën çdo vit një dhuratë parash nga Kalifati, të cilat ajo i shpenzonte për bamirësi. Ajo jetoi një jetë të gjatë dhe vdiq në vitin 54 Hixhëri në Medine, ku u varros në Xhenetul Baki.

Seuda jetoi deri në fund të kohës së udhëheqjes së kalifatit nga Omer ibën el Hatabi. Pas vdekjes së Muhamedit a.s., Seuda, së bashku me gratë e tjera, morën çdo vit një dhuratë parash nga Kalifati, të cilat ajo i shpenzonte për bamirësi.

e Muhamedit a.s., dhe mori përsipër kujdesin për vajzat dhe shtëpinë e tij.³

Sipas Ibën Umerit r.a., Pejgamberi a.s., u martua me Seudën në muajin ramazan, në vitin e dhjetë pas shpalljes. Kjo martesë u bë pas vdekjes së Hatixhes dhe para martesës së Pejgamberit a.s., me Aishen r.a..⁴

Ishte një habi e madhe në Meke, që Pejgamberi a.s., zgjodhi të martohej me një të ve, që nuk ishte as e re e as nuk shquhej për bukuri. Megjithatë, Pejgamberi a.s., ia kujtoi sprovat që kishte kaluar kur ajo kishte emigruar në Abisini, duke lënë shtëpinë dhe pronën e saj, duke kaluar kështu shkretëtirën e më pas edhe detin, për të shkuar në një tokë të panjohur, me të vetmen arsye, për ta ruajtur fenë e saj.⁵



PRANIM DHE FALJE

Pas përfundimit të betejës së Bedrit dhe fitores së myslimanëve kundër idhujtarëve, nëna e besimtarëve, Seuda bint Zumah r.a., kishte dalë nga shtëpia për të kryer detyrimin e saj për ngushëllime në familjen e Ali Afraes. Në këtë kohë ajetet për mbulesën nuk kishin zbritur ende.

Kur mori vesh për ardhjen e myslimanëve dhe robërve të luftës, ajo u kthye në shtëpinë e vet. Derisa po kthehej, u habit shumë kur në mesin e robërve pa djalin e axhës së saj, Suhejl bin Amrin. E pa të lidhur me litar në të dy duart që i vareshin mbi qafe. Ishte kjo një pamje përçmuese dhe përbuzëse për Suhejin, dhe ajo nuk mundi ta frenonte veten e tha: “A

edhe ndaj Ebi Jezidit veprohet kështu”, - dhe iu drejtua atij me fjalët: “O Ebu Jezid, pse u vetëdorëzuat, më mirë të vdisnit me nder!?”

Kur i dëgjoi fjalët e saj, i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, u hidhërua shumë në të dhe tha: “Oj Seuda, a po nxit armiqësi edhe kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij?” Seuda e pa që gaboi dhe menjëherë kërkoi falje për ato që tha, e iu drejtua Resulullahut a.s. me fjalët: “O i Dërguar i Allahut, pasha Atë që të ka dërguar me të vërtetën, nuk munda ta përmbaja veten kur e pashë Ebu Jezidin me duar të lidhura dhe thashë ato që të thashë.”

Pejgamberi a.s. e kuptoi se ajo nuk kishte qëllim të keq dhe se fjala doli prej saj pa e menduar, prandaj e pranoi pendimin e saj dhe e fali. Nuk i vuri veshin më shumë gabimin të saj, veçse i tha: “Allahu të faltë!”⁶

NË PLEQËRI ME SEUDËN

Kur Seuda ishte më e vjetër, ajo i tha Pejgamberi a.s., se natën e saj do t'ia dhuronte Aishes r.a., ngase atë e kishte shumë për zemër. Kështu që ajo dhe Aisheja r.a., qëndruan shumë së bashku dhe ishin shumë të afërta me njëra-tjetrën. Seuda jetoi deri në fund të kohës së udhëheqjes së kalifatit nga Omer ibën el Hatabi. Pas vdekjes së Muhamedit a.s., Seuda, së bashku me gratë e tjera, morën çdo vit një dhuratë parash nga Kalifati, të cilat ajo i shpenzonte për bamirësi. Ajo jetoi një jetë të gjatë dhe vdiq në vitin 54 Hixhëri në Medinë, ku u varros në Xhenetul Baki. Ajo vdiq në muajin sheval, gjatë udhëheqjes së Muavije ibën Sufjanit. Ibën Sadi e vendos datën e vdekjes së saj në vitin 674. Pas vdekjes së saj, Muavije I, kalifi i parë në pushtet i dinastisë Umajjad, bleu shtëpinë e saj në Medinë për 180.000 dirhemë.

1 <https://archive.org/details/tabarivolume39/page/n201/mode/2up?view=theater>

2 <https://archive.org/details/tabarivolume39/page/n199/mode/2up?view=theater>

3 https://web.archive.org/web/20130806103851/http://www.islamawareness.net/Muhammed/ibn_kathir_wives.html

4 <https://archive.org/details/tabarivolume39/page/n199/mode/2up?view=theater>

5 https://web.archive.org/web/20130806103851/http://www.islamawareness.net/Muhammed/ibn_kathir_wives.html

6 Amër Halid, “I Dërguari s.a.v.s.”, Shtëpia Botuese “Dituria Islame”, Prishtinë.

Fllade mëshironjëse nga vendet e shenjta

Mimoza Sinani

Të gjithë myslimanët ëndërrojnë të shkojnë në gjirin mikpritës të Mekës. Ndonjëherë ky udhëtim pritet me padurim për dekada. Pas shumë vitesh pritjeje, në një formë apo në një tjetër, të krijohet mundësia dhe të vjen thirrja për të vizituar qytetin e dashur. Menjëherë e ndien që pushtohesh nga emocionet dhe e kupton se përkushtimi i përjetshëm ndaj Zotit dhe më të dashurit të Tij të ka mundësuar të vizitosh qytetin e shenjtë të Mekës dhe vetë Qabenë. Ndien se Allahu të ka privilegjuar që të zgjodhi dhe të thirri pikërisht ty në këtë kohë dhe ti iu përgjigje zërit qiellor që daton mijëra vjet më herët, që iu drejtua babait të pejgamberëve, Ibrahimit a.s., një kumt që vazhdon të kumbojë nëpër qiell vazhdimisht dhe që të takoi ty, dhe ti iu përgjigje me kodin që e dëshmon besimin tënd: “Të përgjigjem, O Zot, Të përgjigjem!”

Shkuarja në Qabe dëshmon pranimin që shpirtrat tanë ia kanë bërë Allahut për Zot

dhe i mundëson shpirtit tonë që ta rikujtojë premtimin e dhënë. Përjetimet janë jashtëzakonisht prekëse dhe mallëngjyese sepse do shkelësh në vendin e shtëpisë së parë të adhurimit të ndërtuar ndonjëherë në tokë, në vendin ku u artikulua fjala e parë hyjnore, në vendin ku u pranua pendimi i njeriut të parë, në vendin ku lindi dhe u rrit Pejgamberi ynë i dashur Muhamed.

Hyrja në qytetin e Mekës është një përvojë që nuk harrohet kurrë. Shkelja në dyshtemenë prej mermeri të bardhë të Xhamisë është një përvojë krejtësisht unike. Për myslimanët që jetojnë në tokat larg Hixhazit, Qabeja me mbulesën e saj mahnitëse të zbukuruar në mënyrë madhështore është një pamje, imazhi i së cilës është ngulitur në mendje vetëm nëpërmjet fotografive. Por shikimi real i Qabesë e kapërcen përtej çdo kufiri imagjinatën e dikurshme për të. Të gjithë pelegrinët që e shohin për herë të parë Qabenë shkrihen në lot.

Shkuarja në Qabe dëshmon pranimin që shpirtrat tanë ia kanë bërë Allahut për Zot dhe i mundëson shpirtit tonë që ta rikujtojë premtimin e dhënë.



Për
myslimanët që
jetojnë në
tokat larg
Hixhazit,
Qabeja me
mbulesën e saj
mahnitëse të
zbukuruar në
mënyrë
madhështore
është një
pamje, imazhi
i së cilës është
ngulitur në
mendje vetëm
nëpërmjet
fotografive.

Gjuha njerëzore është e paaftë ta përshkruajë ndjenjën që të kaplon kur e shikon Qabenë për herë të parë. Në atë vend vërshojnë nga sytë lotët e miliona myslimanëve nga të gjitha anët e të botës dhe gjithçka që del nga zemra është e tyre është 'Allahu Ekber'! Njerëzit qajnë dhe bëjnë dua me zë të lartë. Thjesht nuk u intereson se çfarë mendojnë të tjerët për ta. Të gjithë ecin si një njësi unike sikur të jenë të lidhur me njëritjetrin.

Pamja madhështore e Qabesë të mahnit dhe ndien se je mpirë krejt papritur. Turmat e njerëzve të tundin dhe të përplasnin, por në ato momente ekziston vetëm Qabeja dhe ti. Rrethohesh nga qindra mijëra njerëz që thërrasin Zotin në të njëjtën kohë. Në kohën që po i thërrasësh Atij, askush tjetër nuk ka rëndësi dhe askush tjetër nuk ekziston. Bota, që rrotullohet rreth teje, ndalon. Je vetëm ti dhe Allahu. Një lidhje shpirtërore është krijuar mes teje dhe Zotit tënd, duke e lënë zemrën dhe mendjen tënde të qetë.

Thellohesh në lutjet e përzemërta mes mijëra adhuruesve që ndajnë të njëjtën dëshirë dhe pasion për t'u zhytur në meditimin e njëshmërisë së Zotit, duke u shkëputur nga kjo botë tokësore dhe kalimtare për t'u kredhur në një botë ku zemra e njeriut mund të gjejë prehje dhe qetësi të plotë.

E humbasësh ndjenjën e kohës, duke i harruar orët dhe ditët. Këto njësi matëse janë të parëndësishme. Edhe pse qëndron në një pjesë tjetër të botës, larg vendlindjes tënde, ndihesh shumë më rehat sesa në shtëpi. Harron gjithçka për jetën tënde, për shqetësimet dhe përgjegjësitë tua të mëparshme dhe zhytesh në adhurim dhe lutje. Ke lënë mënjanë përditshmërinë tënde dhe je kthyer drejt *El Evelu vel Ahiru*, drejt Atij Që është i Pafillim dhe i Pambarim. Edhe pse lutesh dhe bisedon heshturazi, ti je e sigurt se Ai i dëgjon pëshpëritjet e zemrës tënde.

Të pushton dëshira që të arrish shkallën më të lartë të devotshmërisë që myslimani mund të arrijë dhe dëshiron të jesh myslimani më i mirë që mund të ekzistojë. Secili përjeton rilindjen shpirtërore të shpirtit dhe besimit. Ndien se nuk të shqetëson më asgjë. Vdekja nuk të frikëson dhe ndien se Allahu është dhe do të jetë gjithmonë me ty. Dashuria për gjërat materiale zëvendësohet me mirënjohje për të gjitha gjërat që në të vërtetë je i bekuar që i ke.

Njerëzit e zakonshëm nga e gjithë bota i ndien si të jenë familja jote e madhe dhe e kupton se çfarë do të thotë të jesh vërtet në shtëpi. Filli i përbashkët që i lidh të gjithë është dëshira për të qenë në afërsi të shtëpisë së tyre shpirtërore. "*Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër...*" (Huxhurat, 10.)

Ambiciet dhe synimet zëvendësohen me bindjen se të jesh një mysliman i mirë është suksesi më i mirë. Zhgënjimet, frustrimet, streset dhe shqetësimet tua treten si shkuma e bardhë. E kupton se sa e pavlerë është bota materiale dhe se sa të përkohshme dhe iluzore janë dëshirat që ndjek.

QABEJA - EPIQENDRA SHPIRTËRORE

Qyteti i Mekës, veçanërisht Haremi, është vendi që nuk fle kurrë. Kur nata ngre velin e saj dhe hëna e plotë hedh rrezet e saj mbi tokë, zërat e pelegrinëve ushtojnë nga të gjitha anët me thirrjet: "Ja ku jam o Zot, ja ku jam." Pas rënies së temperaturave, në orët e vona të natës, ndien kënaqësinë e të shkuarit në Qabe, duke shijuar zërin e myezinëve që thërrasin për namaz, një thirrje melodioze që depërton thellë në shpirt. Nuk ka tone njerëzore më harmonike, më të ngrohta dhe më të freskëta se ezani.

Pas thirrjes së ezanit, të gjithë e dinë saktësisht se çfarë duhet të bëjnë. Miliona njerëz i koordinojnë veprimet e tyre në një sinkronizim të përsosur. Ekziston një ndjenjë e fuqishme uniteti dhe të gjithë e dinë se çfarë duhet të bëjnë. Pas përfundimit të namazit të gjithë i dërgojnë salavate Pejgamberit tonë të dashur: "*O Zot, bekoje Muhamedin dhe pasuesit e Muhamedit, ashtu siç bekoje Ibrahimin dhe pasuesit e Ibrahimit.*" Ky është një moment shumë i veçantë dhe ndërsa shqipton salavatet mendon se gjendesh në vetë tokën e Muhamedit dhe të Ibrahimit, dhe rrethohesh anëmbanë nga ndjekësit e tyre.

Qabeja është qendër tërheqëse, ku graviton e gjithë forca shpirtërore e besimtarëve, dhe më pas ajo e shpërndan atë energji në formë të valëve magnetike në të gjitha anët, fuqia e së cilës ndihet deri në skajet më të largëta të botës myslimane. Energjia që lëshon ky objekt magnetik tërheq zemrat e miliarda njerëzve, dhe shpirtrat e tyre ndriçohen nga drita që lirohet nga ai kub energjik. Qabeja është epiqendra shpirtërore dhe atdheu shpirtëror i çdo myslimani. Ajo është faltorja e parë e monoteizmit në tokë dhe simbol i njëshmërisë



së Zotit. Të gjitha mihrabet e xhamive të botës janë të drejtuara në drejtim të saj. Në drejtim të saj kthehen jo vetëm fytyrat, por edhe zemrat dhe shpirtat e të gjithë besimtarëve anëmbanë botës.

Qabeja në tokë gjendet nën Qabenë (*Bejtul Mamur*) që gjendet në qiell. Ajo qëndron në boshtin që bashkon qiellin dhe Tokën. Ndërsa myslimanët bëjnë tavaf rreth faltores së Tokës, engjëjt bëjnë tavaf rreth faltores së qiellit. Nga fillimi i kohës deri në fund të kohës, njerëzit kanë vazhduar dhe do të vazhdojnë të qarkullojnë rreth kësaj epiqendre shpirtërore dhe hyjnore. Kënaqësia e thellë dhe e brendshme shpirtërore që përjetohet gjatë këtij udhëtimi tërheq miliona pelegrinë çdo vit. Kjo është me të vërtetë një nga mrekullitë më të mëdha të Zotit.

VIZITA NË MEDINË

Vizita në Xhaminë e Pejgamberit në Medinë është një përvojë thellësisht emocionuese. Ajo i ngjall qetësi në shpirt çdokujt që hyn në ambientet e saj dhe ofron mundësinë për të ndierë praninë dhe dashurinë e Pejgamberit të dashur a.s.. Pelegrinët bëjnë nderimet e tyre dhe kërkojnë ndërmjetësimin e tij. Aty ndien dëshirën e thellë shpirtërore për t'u zhytur plotësisht në një botë lutjeje dhe përkushtimi. Duke falur dy rekate namaz pranë varrit të Pejgamberit a.s., ndien se thith forcën e pamasë të shpirtërores që është një atmosferë unike dhe e fuqishme e rezervuar ekskluzivisht për qytetin e Medinës. Udhëzimi dhe drita hyjnore që ai solli, vazhdon të ndriçojë zemrat e pastra dhe fisnike të miliona, madje miliarda njerëzve, përgjatë gjithë këtyre shekujve.

Qetësia dhe shpirtërorja e vendeve të shenjta, së bashku me përkushtimin dhe përgjërimin intensiv, krijojnë mjedisin e favorshëm për vetëreflektim dhe introspeksion. Është koha për të kërkuar falje dhe për të kërkuar transformim dhe lartësim shpirtëror personal. Është një mundësi unike për të forcuar besimin dhe për të kërkuar ndriçim shpirtëror. Nuk është thjesht një udhëtim fizik, por një përvojë e pashembullt e vetëzbulimit personal, një përvojë transformuese që ndikon në zemrën, mendjen dhe shpirtin e pelegrinit, është një udhëtim i shpirtit të brendshëm që kërkon pastrim dhe afrim me Zotin.

Vizitimi i vendeve historike, të lidhura me periudhën e hershme islame, si Xhamia Kuba dhe kodra e Uhudit, ofron një mundësi të jashtëzakonshme për t'u thelluar në historinë e pasur të Islamit dhe një lidhje të thellë me trashëgiminë e Islamit dhe momentet e tij kryesore. Udhëtimi fizik dhe shpirtëror i të gjithë pelegrinëve që vizitojnë: Mekën, Qabenë e bekuar, Safanë, Merven, Arafatin, Muzdelifen dhe Minanë, është një përvojë ndriçuese që ushqen shpirtin dhe sjell paqe të pamasë në zemrën e tyre. Të gjithë i bashkon vetëm një moto: *Lebbejk Allahumme lebbejk!* "I përgjigjemi thirrjes tënde O Allah, i përgjigjemi!"

KTHIMI NGA HAXHI

Kur largohesh dhe e hedhësh vështrimin drejt Qabesë për herë të fundit, pamja madhështore e saj ngulit në sytë e tu të lotuar një imazh që nuk mund të zëvendësohet kurrë, dhe ky imazh do të gdhendet gjithmonë pas qepallave të tua të mbyllura. Kur largohesh ke një ndjenjë sigurie, force dhe plotësie që është shenjë e shpirttrave të ngritur. Kur vjen momenti i largimit prej aty, jo vetëm që lë një pjesë të zemrës tënde, por edhe merr një copëz nga aty, sepse ai vend lë gjurmë të thella në shpirtin e çdo njeriu që e viziton. Kryerja e haxhit, ashtu si edhe vdekja, është një moment përcaktues i shpirtit në jetën e një njeriu. Pas përfundimit të haxhit, ndjenja e të qenit i falur plotësisht është vërtet e pa përshkruar. Ndieni një lehtësi të shpirtit dhe ndiheni shumë më afër Krijuesit tuaj. Të është dhënë mundësia e dytë për të filluar përsëri jetën tënde, nga 'gjendja e pastërtisë'. Me këtë ndjenjë, bëhesh më i ndjeshëm ndaj çdo gabimi dhe ndien nevojën për t'u penduar menjëherë, sepse tani që je i pastër, dëshiron të qëndrosh i tillë dhe të mos lejosh më kurrë ndonjë papastërti shpirtërore ta ndotë zemrën tënde.

Largohesh nga qytetet e shenjta i lodhur fizikisht, por i ngritur shpirtërisht. Në rrugën drejt ngritjes shpirtërore, të duhet të luftosh egon dhe të përballësh me sfidat. Pa u përballur me sfida, nuk mund ta arrish asnjëherë përsosmërinë shpirtërore dhe nivelet e pakufishme të lartësimit të shpirtit. Haxhi i vërtetë fillon kur kthehesh në shtëpi, në mjedisin dhe përgjegjësitë tua të zakonshme. Sfida kryesore është misioni i jetës tënde pas haxhit: ta jetosh atë duke u bërë njeriu më i mirë që u frymëzove të jesh.

E drejta e grave për punë

Dr. Violeta Smajlaj

Historia e hershme islame e ka çmuar kontributin e grave të asaj kohe. Zonja Hatixhe, Allahu qoftë i kënaqur me të, e drejtoi biznesin e saj me të Dërguarin e Zotit, a.s., ku ai e kaloi pjesën më të mirë të rinisë së tij duke punuar për të me paratë e saj.

Islami e fton njerëzimin në një kornizë etikologjore, të ndërtuar mbi urtësinë dhe drejtësinë e Zotit, i Cili si Krijues i universit dhe njeriut është i Gjithëdijsëm për çdo hollësi: *“A nuk e di Ai më së miri, Ai që krijoi? Dhe Ai është i Gjithëdijsëm për çdo hollësi.”* (Mulk, 14).

Ky koncept mbështetet në dy parime kryesore:

1. Nevoja e njerëzimit për drejtëudhëzim sa herë që njeriu ka alternativën të zgjedhë. Pa këtë udhëzim individët dhe shoqëritë mund të humbasin në paqartsi dhe të përballen me pasoja të dëmshme të veprimeve të tyre;

2. Udhëzimet e Islamit realizojnë më të mirën për njeriun nëse kuptohen dhe zbatohen sipas kontekstit dhe rrethanave në çdo situatë, duke balancuar drejtësinë me mëshirën.

Marrë parasysh interesin që sjellë puna për njeriun, Islami inkurajon punën dhe e vlerëson atë si një mjet për të shërbyer dhe fituar. Allahu i madhëruar në Kuranin fisnik thotë: *“Dhe thuaj: ‘Punoni, Allahu do ta shohë punën tuaj, edhe i Dërguari i Tij e besimtarët.’* (Et Tevbe, 105).

Pjesëmarrja e grave në punë dhe profesione tashmë është bërë një aspekt i rëndësishëm i dinamikës së shoqërisë. Kjo qasje bashkëkohore është ndërtuar mbi parimin e barabarësisë mes gjinive në të drejta njerëzore dhe mosdiskriminim, që i jep mundësinë grave të shfrytëzojnë potencialet e tyre në fusha të ndryshme.

Edhe historia e hershme islame e ka çmuar kontributin e grave të asaj kohe. Zonja Hatixhe, Allahu qoftë i kënaqur me të, e drejtoi biznesin e saj me të Dërguarin e Zotit, a.s., ku ai e kaloi pjesën më të mirë të rinisë së tij duke punuar për të me paratë e saj. Në fushën e industrisë dhe zejtarisë ishte zonja Zejneb, Zoti qoftë i kënaqur me të, e cila punonte punë dore dhe me pasurinë që e fitonte i ndihmonte nevojtarët dhe skamnorët. I Dërguari, a.s., e lavdëroi veprimin e saj duke thënë: *“Ai që e ka dorën më të gjatë (jep sadakë më shumë), do të më ndjekë mua.”*¹ Këto dhe shumë raste tjera të ngjashme, shpalosin konsideratën e brezit të parë të grave muslimane që kishin për punën, si dhe theksojnë rëndësinë e rolit të grave në zhvillimin ekonomik dhe social të kohës së tyre.

E drejta islame nuk e ka penguar gruan të punojë, ashtu sikurse nuk e ka obliguar, por një vendim i tillë i është lënë ekskluzivisht dëshirës dhe potencialit të saj. Madje i është lejuar edhe gjatë periudhës së pritjes, në rast divorci, të punojë nëse ka nevojë për këtë; me gjithë pa pëlqyeshmërinë e daljes nga shtëpia pa nevojë gjatë asaj kohe. Është përmendur në hadithin autentik të transmetuar nga Ebu Zubejri, se ai e ka dëgjuar Xhabir bin Abdullahun duke thënë: *“Në kohën e pritjes (idetit) pas divorcit, tezja ime doli për të krasitur palmat e saj, por një burrë e qortoi që të mos dilte, andaj ajo erdhi te Pejgamberi a.s. dhe i tregoi rastin, kurse ai i tha: ‘Po, krasit palmat tua, se ndoshta do të japësh lëmoshë dhe do të bësh një vepër të mirë.’”*² Pra, i Dërguari i Zotit, a.s., nuk e pengoi të punonte

edhe kur ishte në pritje obligative pas divorcit, që e quajmë idet, përderisa kjo punë ishte e nevojshme, sepse s'kishte kush ia kryente, ishte legjitime dhe e dobishme.

Në epokën e Profetit a.s., gratë merrnin pjesë pothuajse në të gjitha luftërat,³ sipas nevojës, më shumë në shërbimet e prapavijës, kurse, disa herë, në rast të rrethanave dinamike edhe drejtpërsëdrejti në betejë. Transmeton Enes bin Maliku se Ummu Atijjes që dëshironte të merrte pjesë në luftë, i Dërguari i Allahut iu përgjigj se xhihadi nuk ishte bërë obligim për gratë. Megjithatë Pejgamberi a.s., e lejoi të marrë pjesë në luftë kur pa vendosmërinë e Ummu Atijjes në dëshirën e saj dhe sqaroi se ajo mund të mjekonte të plagosurit, të përgatiste ilaçe për dhimbjet e syve, të bartte ujë për luftëtarët⁴ dhe shërbime të tjera.

Disa gra sahabe, duke u mbështetur në këtë leje të Dërguarit të Allahut, a.s., morën pjesë në beteja duke mjekuar plagët, duke qepur e arnuar, duke bartur ujë, duke përgatitur ushqim, madje, duke marrë pjesë drejtpërsëdrejti në përleshje nganjëherë. Ummu Umare është njëra prej grave që morën pjesë në betejën e Uhudit duke luftuar si harkëtare. Pasi u kthyen në Medinë pas betejë, Profeti tha: "Gjatë betejës, sa herë që ktheja kokën djathtas e majtas, shihja Ummu Umaren që luftonte krah meje..."⁵

Pra, puna e gruas është një element produktiv dhe me efekt në zhvillimin e familjes dhe shoqërisë. Të shtyrë nga ky fakt, shumë legjislacione kanë marrë në konsideratë kontributin e saj në shtëpi si pjesëmarrëse financiare e asaj që fiton bashkëshorti pas martese.⁶

KRITERET E PUNËS

Dijetarët myslimanë përmendin dy lloje kufizimesh mbi të drejtën e gruas për punë në të drejtën islame:

a) Kufizimet e përgjithshme për të gjitha daljet publike, që është respektimi i rendit dhe etikës publike të Sheriatit në veshje, komunikim dhe në mosvetmim me gjininë e kundërt të nënkuptuar në ajetet vijuese kuranore: "Mos tërhiqni vëmendjen me të folur, e të lakmojë ai, zemra e të cilit është e sëmurë, por flisni fjalë të denja serioze. Të rrini në shtëpitë tuaja dhe mos ekspozoni bukurinë tuaj si dikur në kohën e injorancës." (El Ahzabë, 33); "Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. Allahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata. Thuaju edhe besimtarëve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre. të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vejnë shamitë mbi kraharorin e tyre." (En Nur, 30-31).

b) Kufizimet e veçanta për marrëveshje, së paku të nënkuptuar, me kreun e shtëpisë ku jeton për të punuar dhe rregulluar marrëdhëniet pasurore për të ardhurat nga puna.



Mirëpo, meqenëse kriteri i parë vlen për të dy gjinitë në çfarëdo kohe dhe ambienti, e nuk lidhen drejtpërsëdrejti me punën, ajo që vlen me të vërtetë të sqarohet dhe shqyrtohet është vetëm kriteri i dytë me dy nënpikat e tij, të cilat janë:

- Marrëveshja për të punuar me kryefamiljarin, nëse gruaja ka familjarë dhe jeton me ta, siç është babai për beqaret, ose bashkëshorti për të martuarat.

- Si rrjedhojë, marrëveshja rregulluese e marrëdhënieve pasurore për të ardhurat që rrjedhin nga puna.

MARRËVESHJA ME KRYEFAMILJARIN

Kjo çështje ndërlidhet me mirëkuptimin ose keqkuptimin e kavames, përgjegjshmërisë së burrit në familje, se mbi çfarë arsye bazohet ajeti i 34-të i sures En Nisa kur thotë: "*Burrat janë përgjegjës (kavvam) për gratë me aq sa u ka dhënë Allahu përparësi (faddale) njëres palë ndaj tjetrës dhe për shkak se ata shpenzojnë pasurinë e vet.*"

Kuptimi i dukshëm i fjalës "faddale", i përkthyer nga akademik Feti Mehdiu si përparësi, nënkupton edhe preferencë, favorizim e të ngjashme dhe mund të ngrejë dyshime për diskriminim midis burrave dhe grave. Megjithatë, me një shqyrtim pak të kujdesshëm të kuptimit të fjalës "faddale" te komentatorët e Kuranit, e përmendur në këtë ajet dhe në ajetin 32 të së njëjtës sure, zbulojmë lehtësisht se "përparësia" lidhet me të dy palët, me burrat dhe gratë, në arritjen e pozitave të vlefshmërisë dhe gradave të mirësisë që fitohen me punë dhe zell, siç dëshmohet nga fraza "njëres palë ndaj tjetrës", e cila përfshinë të gjithë, pa bërë më të voglin dallim në bazë të gjinisë.⁷ Dallimi në favorizimin e njëres palë ndaj tjetrës ndodhë vetëm mbi bazën e kontributit për familjen, si në mbrojtje, ashtu edhe në zhvillim, e asnjëherë mbi gjininë. Ajeti i 32-të i sures En Nisa e dëshmon

edhe më qartë këtë bazë të kontributit në dhënie të përparësisë, kur urdhëron të kërkojmë shtimin e fadlit prej Zotit. Sepse, sikur fadli - vlefshmëria ose përparësia - të ishte ndarë prej Zotit mbi bazë gjinore, atëherë nuk do të jepte kurrfarë kuptimi urdhri për kërkim të shtimit, por do të kërkohej të kënaqeshim me çfarë jemi.⁸

Pra, sipas interpretimit të kreut të mufesirëve, Imam Taberit, ky ajet jep të kuptojmë se burrat kanë një shkallë të përgjegjshmërisë mbi gratë për shkak se gratë lirohen nga disa detyrime ndaj burrave, ndërkaq burrat kanë më shumë detyrime ndaj grave në mbrojtje dhe mbajtje.

Ky ajet i përgjegjshmërisë (kavames),⁹ së bashku me dy ajetet simotër, ajetin mbi vlefshmërinë (fadlin)¹⁰ dhe ajetin mbi gradën (derexhen)¹¹, vendosin familjen në këndvështrimin islam mbi parimin e kompletimit ndërmjet përgjegjshmërisë së burrit (kavames) dhe kujdestarisë së gruas (hifdhit), që ata të trajtojnë njëri-tjetrin në mënyrë të arsyeshme brenda fushës së konsultimit.¹²

Pasi që ata janë përgjegjës për sigurimin e alimentacionit (ushqyerje, veshmbathje e strehim) ndaj grave të tyre, dhe kjo është dëshmi se gruaja nuk është e detyruar të sigurojë të njëjtën për burrin e saj. Sepse ajeti, edhe pse ka ardhur në mënyrën kallëzuesore, e urdhëron burrin që të mbrojë dhe kujdeset financiarisht për gruan. Sistemi legjislativ i Sheriatit në vetvete është përgjegjësi (teklif) dhe nuk jep kompetenca thjesht për shkak të gjinisë, pa e ngarkuar atë kompetencë me koston përkatëse të përgjegjësisë. Mufesiri i njohur Ibën Ashuri thotë: “Kavvam është ai që kujdeset për diçka, i rri gati dhe e mirëmban... Prandaj, të qenët e burrave kavvamun mbi gratë është përgjegjshmëri e ruajtjes dhe mbrojtjes si dhe përgjegjshmëri e fitimit dhe financimit.”¹³ Lidhur me barazinë gjinore, aktivistja e njohur e të drejtave të njeriut, Anne Bayefsky bën këtë sqarim: Jo të gjitha dallimet në trajtim janë diskriminuese, ose thënë ndryshe barazia jo gjithmonë do të thotë trajtim identik i njëjtë; dhe se një dallim është diskriminues nëse nuk ka objektiv dhe justifikim të arsyeshëm, ose nuk ndjekë asnjë qëllim legjitim, apo nëse nuk është i arsyeshëm

Nuk gjejmë pengesë fetare që e pengon gruan të punojë për të fituar, të ushtrojë profesion, të angazhohet për humanitet apo të ndërmarr biznes, përderisa puna që bën është përbrenda normave dhe etikes islame, standardit hallall të punës, në ambient pune në përputhshmëri me natyrën e gruas dhe pa ndikim negativ të rëndë në jetën e saj familjare.

proporcionaliteti ndërmjet qëllimit dhe mjetit për ta arritur atë.¹⁴

Bazuar pikërisht në këtë kuptim të barazisë apo diskriminimit që përmbushë një objektiv të arsyeshëm ose mbanë proporcionalitet, gjejmë tualete të ndara sipas gjinisë, palestra sporti, madje edhe performancë fizike në testet për ushtrinë, të cilat të gjitha konsiderohen të justifikuara sipas preferencës personale dhe dallimet fizike midis gjinive.

RREGULLIMI I MARRËDHËNIEVE PASURORE

Në të drejtën islame, lidhja e martesës nuk shkakton efekte pronësore, prandaj secili nga bashkëshortët vazhdon të mbetet titullar i vetëm në pasurinë e tij edhe pas lidhjes së martesës. Çdonjëri nga bashkëshortët ka autonomi të pavarur nga tjetri në tërë pasurinë e vet.¹⁵

Kurani famëlartë thotë: “Burrave ju takon hise nga ajo që fituan ata dhe grave gjithashtu ju takon hise nga ajo që fituan ato.” (En Nisa, 32)

Ky ajet, ndër shumë të tjerë, ka lënë të kuptohet se bashkëshortja është po sikur bashkëshorti dhe secili prej tyre gëzon autoritet të plotë në pasurinë e vet brenda kufijve ligjorë. Në lidhje me këtë “Akademia Ndërkombëtare e të Drejtës Islame” ka miratuar një vendim, ku thuhet: “Gruaja është plotësisht e kualifikuar në aspektin pasuror dhe ka autoritet të plotë financiar (sikurse burri). Ajo ka të drejtën absolute sipas dispozitave të Sheriatit në gjithçka që e fiton me punën e saj. Ka pasurinë e vet të veçantë, të drejtën e pronësisë dhe të drejtën për të disponuar me pronë. Burri nuk ka autoritet mbi pasurinë e gruas dhe ajo nuk ka nevojë për lejen e burrit për të pasur pronë apo për të disponuar me atë.”¹⁶

Mirëpo, sipas të të njëjtës Akademi, bashkëshortët mund të bien dakord në lidhje me pasuritë e tyre të fituara gjatë martesës. Në vendimin e saj thuhet: “Secili prej bashkëshortëve ka pavarësinë e vet pasurore dhe bazuar në këtë fakt secilit i takon e drejta e disponimit me pasurinë dhe të drejtat e veta, me kompensim apo pa të. Nëse bashkëshortët me pëlqimin e tyre vendosin të bashkojnë pasuritë, nuk ka kurrfarë pengese fetare për

këtë, por nuk lejohet t'iu imponohet me përcaktim të detyrueshëm.”¹⁷

Me gjithë faktin se gruaja punon dhe posedon të ardhura, burrit nuk i zhbëhet detyrimi për mbajtjen e gruas dhe familjes, përveç nëse janë marrë vesh ndryshe me vullnetin e tyre. Në lidhje me detyrën e burrit për të mbajtur gruan “Akademia Ndërkombëtare e të Drejtës Islame” ka miratuar një vendim, ku thuhet: “Gruaja gëzon të drejtën për mbajtje të plotë (vendbanim, ushqim, veshmbathje, etj.) dhe të dinjitetshme, sipas mundësive të bashkëshortit, në përputhje me zakonet e mira dhe traditat shoqërore të pranuar sipas Sheriatit.”¹⁸

PËRFUNDIM

Misioni i vazhdimësisë së jetës, kultivimi i tokës, nxjerrja e të mirave të natyrës dhe shijimi i tyre është një për të gjithë njerëzit, mashkull qoftë njeriu apo femër. Zoti i Madhëruar i është drejtuar në Kuranin famëlartë njeriut, mashkullit dhe femrës, duke i thënë: “A nuk e ke parë se Zoti të ka nënshtuar çdo gjë që gjendet në tokë.” (El Haxhah, 65); “A nuk e ke parë se Zoti të nënshtroi gjithçka në qiej dhe në tokë dhe të dhuroi të mirat e Tij, të dukshme dhe të fshehta...” (Lukman, 20).

Së këndejmi, nuk gjejmë pengesë fetare që e pengon gruan të punojë për të fituar, të ushtrojë profesion, të angazhohet për humanitet apo të ndërmarr biznes, përderisa puna që bën është përbrenda normave dhe etikes islame, standardit hallall të punës, në ambient pune në përputhshmëri me natyrën e gruas dhe pa ndikim negativ të rëndë në jetën e saj familjare. Puna është një nga të drejtat e individëve dhe çdokush ka të drejtë të ushtrojë çfarëdo lloj pune legjitime që dëshiron për të fituar jetesën e tij, për të kontribuar për komunitetin dhe për të qenë në gjendje të jetojë me dinjitet. E drejta islame nuk bën dallim midis grave dhe burrave në këtë të drejtë, siç tha Zoti i Madhëruar: “Nuk është mëkat për ju të kërkonit begati nga Zoti i juaj.” (El Bekare, 198); “Asnjë punëtori nga ju nuk do t'ia humb mundin e punës, qoftë mashkull apo femër – ju jeni njëri nga tjetri.” (Ali Imran, 195).

Nëse dalja e gruas në punë i paraprinë martesës ose është një nga kushtet e saj, bashkëshorti nuk ka të drejtë ta pengojë të dalë në punë pas martesës. Sepse, kontrata e punës e lidhur mes saj dhe vendit ku ajo punon u bë si një kusht i paracaktuar, për çfarë ka dhënë pëlqim të nënkuptuar, sikurse nuk i lejohet të shkelë kushtin e pranuar. Ndërsa, nëse para martesës nuk ka pasur kusht as të nënkuptuar që ajo të punojë, si për shembull nuk ka qenë gruaja në marrëdhënie pune, as duke kryer shkollim që i garanton punë, as nuk është traditë puna e grave në atë familje ose në atë vendbanim, atëherë nuk i lejohet të dalë në punë pa marrëveshje paraprake me bashkëshortin, për të shmangur konfliktin mes çiftit.

Megjithatë, në rastin kur karriera e gruas dhe ruajtja e familjes nuk përputhen dot pa u dëmtuar rëndë njëra prej tyre,

vendimi më i arsyeshëm i një gruaje ose i një burri në këtë rast delikat është të shmangë dëmin më të madh, pasi të ketë matur me kujdes të shtuar humbjen dhe fitimin si në anën materiale ashtu edhe në përmbushjen shpirtërore.¹⁹

- 1 Ez Zuhri, Muhamed bin Sad, Et Tabakatul Kubra, (red. dr. Ali Muhm. Umer), bot. 1, Kajro: Mektebetul Hanxhij, 2001, 10/105.
- 2 Sahih Muslim, Muslim ibnu Haxhaxhaxh, red. Muhamed Fuad Abdul Bakij, Dar Ihjaut Turath, Bejrut, pa bot, (2/1211), nr. 1483
- 3 Muhamed Ez Zerkeshij, El Bahrul Muhit fi Usulil Fikh, red. Abdul Kadir el Anij, Ministria e Vakëfeve të Kuvajtit, bot. ١٩٩٢, ٢.
- 4 Sahih Muslim, (4/1447), 1812
- 5 Ez Zuhri, Muhamed bin Sad, Et Tabakatul Kubra, 10/386.
- 6 Për më gjerë shih: dr. Violeta Smajlaj, Regjimi pasuror martesor në Legjislacionin e Kosovës dhe të drejtën Islame, Edukata Islame, nr. 127-128.
- 7 Taberiu, Muhamed bin Xherir, Xhamiul bejani fi te'vili ajil Kurani, (red. Ahmed Shakir), bot. 1, Beirut: Muessesetu err Risale, 2000, 8/265. Shih gjithashtu, El Hazin, Ali bin Muhamed, Lubabut te'vili fi meanit-tenzili, (red. Muhamed ali Shahin), bot. 1, Beirut: Darul-kutubil-ilmiye, 1415 hixhri, 1/368;
- 8 Xhum'atu, El Musavatul insanijjeti fil islami bejnen nadhariijeti uet tatbik, f. 30.
- 9 En Nisa, 34.
- 10 En Nisa, 32.
- 11 El Bekare, 228.
- 12 Smajlaj, dr. Violeta, Barazia gjinore në marrëdhëniet pasurore bashkëshortore, revista Kalendar, Prishtinë: BIRK, 2021.
- 13 Ibën Ashuri, Muhamedettahir bin Muhamed, Et Tahriru uet-tenviru, Tunis: Ed Dar et Tunisijje linneshr, 1984, 5/38.
- 14 Bayefsky, A.F., “The Principle of Equality and Non-Discrimination in International Law”, Human Rights Law Journal 1990 (11), nr. 1-2, f. 34.
- 15 El Abbadi, Abdusselam, El mulkijetu fish-sheriatil-islamijje: tabiatuha, uedhifetuha, ue kujuduha, dirasetun mukarenun bil-kavanini uen-nudhumil-vad'ijje (Pronësia në Sheriat: natyra, funksioni dhe kufizimet e saj, studim krahasimor me të drejtën dhe ligjet pozitive), bot. 1, Beirut: Muessettur-rrisale ue dhe Darul-Beshirë, 2000, 2/184; El Kurreddagi, Ali, Mebbeurr-rrida fil-ukud: dirasetun mukarene (Parimi i autonomisë në kontrata: studim krahasimor), Beirut: Darul-beshairil-islamijje, 1/12. Vetëm sipas shkollës juridike malikite, autonomia e gruas në bamirësi është e kufizuar të jetë deri në një të tretën e vlerës së përgjithshme të pasurisë së saj, e mbi këtë vlerë burri ka drejtë ta ndalojë. Mirëpo, kjo ka të bëjë vetëm me kufizimin e disponimit me pasurinë e saj në bamirësi, e jo në tregti. Shih, Ibni Abdulberr, Jusuf, El Kafi fi fikhi ehilil-medine (I mjaftueshmi në të drejtën e banorëve të Medinës), Muhamed el Muritani (rec.), bot. 2, Riad: Mektebeturr Rrijadul-hadiethe, 1980, 2/731.
- 16 Akademia Ndërkombëtare e të Drejtës Islame, Vendime dhe rekomandime të Akademisë Ndërkombëtare të së Drejtës Islame, vendimi nr. 144 (2/16) lidhur me mospajtimet e bashkëshortit dhe bashkëshortes punonjës, seanca e gjashtëmbëdhjetë, Dubai, periudha prej 9-14 prill 2005. URL: <http://www.iifa-aifi.org/2174.html>.
- 17 Akademia Ndërkombëtare e të Drejtës Islame, Vendime dhe rekomandime të Akademisë Ndërkombëtare të së Drejtës Islame, vendimi nr. 227 (11/23) lidhur me ndikimin e aktit martesor mbi pronën e bashkëshortëve, seanca e njëzet e tretë, Medine, periudha prej 28 tetor deri 1 nëntor 2018. URL: <http://www.iifa-aifi.org/4899.html>.
- 18 Akademia Ndërkombëtare e të Drejtës Islame, Vendime dhe rekomandime të Akademisë Ndërkombëtare të së Drejtës Islame, vendimi nr. 144 (2/16) lidhur me mospajtimet e bashkëshortit dhe bashkëshortes punonjës, seanca e gjashtëmbëdhjetë, Dubai, periudha prej 9-14 prill 2005. URL: <http://www.iifa-aifi.org/2174.html>.

Ruajtja e distancës në raportet tona

Mr. Arton Musliu

Me distancë nënkuptojmë që të ruajmë hapësirën dhe distancën e nevojshme, qoftë mes njerëzve apo gjësendeve, në mënyrë që të minimizojmë pasojat në rast se vije deri te ndryshimi i këtyre raporteve apo lidhjeve.

“Çdo gjë lëviz në orbitën e tij.”

(El Enbija, 33).

Allahu xh.sh. ka krijuar çdo gjë dhe për çdo gjë ka bërë orbitën apo hapësirën e tij lëvizëse. Prandaj, edhe në jetën tonë të përditshme shohim se për çdo gjë duhet që të ketë një distancë, e cila duhet të ruhet, sepse në rast të kundërt, do të shkaktojë probleme dhe çrregullime të shumta.

Nëse marrim si shembull ndërtimin e shtëpive, ne jemi të obliguar që të kemi një distancë, e cila është e obliguar me ligj, qoftë kjo distancë prej shtëpisë së fqiu, qoftë prej rrugës, etj.. Kjo, duhet të bëhet për shumë arsye, si për të ruajtur privatësinë e tjetrit, qetësinë, etj., por, arsyeja kryesore është që në rast se vije deri te rrënim i shtëpisë, për çfarëdo arsye apo forme, të mos i shkaktojë dëme tjetrit, apo, që të jetë si masë preventive që ato dëme të jenë sa më minimale.

Po ashtu, edhe gjatë qarkullimit tonë në komunikacion, jemi të obliguar që të mbajmë distancën në mes të automjeteve. Kjo pasi që në rast se vije deri te ndonjë aksident i papritur, të ketë hapësirë dhe mundësi që të parandalohet, të shmangemi apo të minimizojmë pasojat e atij aksidenti. Në rast se këto distanca nuk respektohen, atëherë çfarëdo që do të ndodh do të ketë pasojat shumë më të mëdha.

Kështu, ky është një rend dhe një ligj i Allahut xh.sh., që e ka bërë në këtë botë, e i cili te krijesat e tjera të Allahut xh.sh. respektohet padyshim. Pra, imagjino sikur Dielli apo Hëna të afrohen apo të largohen prej Tokës! Çfarë do të ndodhte...? Padyshim që do të përballemi me katastrofa të ndryshme natyrore.

Kështu pra, edhe në jetën tonë të përditshme, në raportet tona mes njerëzve duhet që të ruajmë distancën. Kjo distancë duhet që të ruhet në të gjitha aspektet. Pra, në mes anëtarëve të familjes, në mes të shoqërisë, në mes të kolegëve të punës, në mes të fqinjëve, në mes të bashkëshortëve, etj.. Thjesht, çdo raport dhe çdo lidhje ndërnjerëzore duhet që të ketë distancën e saj dhe ajo distancë duhet që të ruhet dhe të respektohet. Në të kundërt, do të kemi pasojat dhe do të ballafaqohemi me probleme.

Shembull, nëse marrim dy shokë, të gjinisë së njëjtë apo të kundërt, dhe shohim se ata janë tepër të afërt dhe prej atyre që kanë shkelur këto distanca dhe nuk kanë respektuar ato, njerëzit do të fillojnë të flasin dhe të dyshojnë për këtë lidhje dhe për këtë raport. Por, edhe në rast se vije deri te ndarja në mes të tyre, për çfarëdo arsye, atëherë, pasojat e ndarjes janë shumë më të rënda sesa në kushte normale kur do të jetë e respektuar kjo distancë. Edhe në jetën bashkëshortore, duhet që të respektohet distanca në mes të partnerëve, ngase jeta mund të na befasojë me çfarëdo të papritura dhe sfida. Mund të vije edhe deri te ndarja e çiftit, qoftë me divorc apo me vdekjen e njërit prej tyre. E në raste të tilla kur distanca mes tyre nuk është respektuar, atëherë, pasojat do të jenë shumë më të mëdha. Po ashtu, edhe te raportet më të ndjeshme. Në raportet në mes të prindërve me fëmijët e tyre duhet që të ruhet kjo distancë dhe duhet që çdoherë të jetë në mendjen dhe kujtesën tonë se çdo gjë, përjetësisht, i takon vetëm Zotit. Pra, çdo gjë që ne kemi apo posedojmë janë përkohësisht, ngase përjetësisht i takojnë vetëm Allahut xh.sh..

Pra, edhe familja, fëmijët, shoqëria, puna, pasura, dija, pozita, etj., janë gjëra që ne i

posedojmë vetëm përkohësisht, sepse ato përjetësisht i takojnë vetëm Allahut xh.sh.. Kështu që, duhet të kemi parasysh dhe të ruajmë këtë distancë ndërnjerëzore.

POR, ÇFARË NËNKUPTON RUAJTJA E DISTANCËS?

Me ruajtjen e distancës ndërnjerëzore assesi nuk nënkuptojmë që të shkëpusim marrëdhëniet me të tjerët, e as nuk nënkuptojmë që të jemi të ftohtë emocionalisht, që të mos ndjejmë asgjë karshi të tjerëve. Por, me distancë nënkuptojmë që të ruajmë hapësirën dhe distancën e nevojshme, qoftë mes njerëzve apo gjësendeve, në mënyrë që të minimizojmë pasojat në rast se vije deri te ndryshimi i këtyre raporteve apo këtyre lidhjeve.

Njeriu duhet që të ketë parasysh se çdo lidhje mund të pësojë ndryshime. Kështu, sot mund ta duam dikë, ndërsa ai nesër mund të bëhet armiku ynë, e edhe e kundërta. Do të thotë, mund të urrejmë dikë dhe ai nesër të jetë miku ynë. Po ashtu, sot mund të duam dikë, por nesër të mos e kemi në jetën tonë, ngase, rrjedhat e jetës mund të na largojnë prej tyre, qoftë me ndarje fizike apo edhe me atë shpirtërore.

Andaj, në lidhje me këtë kemi edhe një thënie të Profetit a.s., i cili thotë: “Më ka ardhur Xhibrili a.s. dhe më ka thënë: “O Muhamed! Jeto sa të duash, por me të vërtetë, ti ke për të vdekur! Duaje kë të duash, por me të vërtetë, ti ke për t’u ndarë prej tij! Puno çfarë të duash, por me të vërtetë, ti do të shpaguehesh për të!” Pastaj, më tha: “O Muhamed! Fisnikëria e besimtarit është në namazin e tij të natës dhe lartësimi i tij (krenaria e tij) është në jo vartësinë e tij ndaj njerëzve!”¹ Pra, besimtari duhet që edhe të dojë edhe të urrejë me masë të caktuar. Duhet që të jetë i lidhur qoftë me njerëzit apo edhe me gjësendet me masë të caktuar. Vetëm kështu, mund të minimizojmë pasojat në rast të çfarëdo ndryshimi që mund të ndodh në këto raporte.

Po ashtu, Allahu xh.sh. në një citat tjetër kuranor thotë: “*Por mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është dëm për ju. Allahu e di (fundin e çdo sendi) e ju nuk dini.*” (El Bekare, 217).

Pikërisht për këtë arsye duhet që të ruajmë këtë distancë në mes të raporteve dhe të lidhjeve, sepse nuk e dimë se çfarë është më e dobishme dhe çfarë është më e dëmshme për ne. Po ashtu, nuk mund të dimë se cilat gjëra janë të mira e cilat gjëra janë të dëmshme për ne. E tërë kjo është prej urtësive dhe dijes absolute të Allahut xh.sh.. E ne mund të përfitojmë vetëm nëse jemi të matur dhe çdo gjë e vlerësojmë me masë të caktuar. Pa mos e tepruar as në mbivlerësim e as në nënvlerësim, pa mos e tepruar as në përafrim e as në distancim, qoftë me njerëzit apo edhe me gjësendet.

Po ashtu, Allahu xh.sh. në një tjetër citat kuranor thotë: “*Ne çdo send kemi krijuar me masë të caktuar.*” (El Kamer, 49).

Ky pra është ligji i Allahut xh.sh. në krijimtarinë e Tij. E nëse Allahu xh.sh. ka krijuar çdo gjë me masë, atëherë çdo tejkallim i këtyre masave do të thotë dalje jashtë rregullave dhe ligjeve të Allahut xh.sh.. E çdo dalje jashtë këtyre rregullave do të thotë çrregullim në jetën tonë dhe të tjerëve. E ky çrregullim padyshim se do të sjell pasojat.

Prandaj, këtë më së miri na e mëson vetë Profeti a.s., kur thotë: “*Çdo kujt jepja atë që e meriton.*”²

Pra, çdo mangësi apo edhe çdo e tepruar do të bartë edhe pasojat e saj. E më e mira është ajo që njihet si “mesi i artë”. Prandaj, edhe Pejgamberi a.s., ka thënë: “*Gjërat më të mira janë mesatarët.*”³

Andaj, le të mundohemi që të jemi mesatarë qoftë në dashuri, në urrejtje, në afërsi, në largësi, në shoqëri, në ndarje, në çdo gjë. E kjo pasi që nëse këto raporte kanë qenë pozitive

dhe ne karshi tyre kemi qenë mesatarë, atëherë nëse do të bëhen negative do ta kemi më të lehtë që t’i pranojmë dhe t’i përballojmë këto ndryshime. Po ashtu, edhe nëse kanë qenë negative dhe për një moment janë ndryshuar dhe janë bërë pozitive, atëherë do ta kemi më të lehtë që t’i pranojmë, nëse kemi qenë mesatarë në vlerësimin e tyre.

1 Këtë hadith e shënon Imam Taberaniu, në *El Mu’xhem el Evsat*, transmetimi nr. 4278.

2 Këtë hadith e shënon Imam Buhariu në *Sahihun e tij*, transmetimi nr. 1968.

3 Këtë hadith e shënon Ibën Ebu Shejbe në *Musanah*, transmetimi nr. 36137.



Prindërit dhe fëmija që ti ke, jo fëmija që ti doje...

Entela Hidri

SFIDA E BREZAVE

*“Çdo zemër rrahje, e ka një krijim,
jo nga zemër rrahje nëne,
po nga i pari Krijim...”*

QERSHORI I FËMIJËVE, QERSHORI I ËNDRRAVE TONA...

Çdonjëri nga ne ka ndërtuar një fole ku do të donte të jetonte i lumtur. Erërat ikin dhe ne kuptojnë që foleja nuk mbushet dot pa cicërima, me pas ne rritemi, maturohemi dhe bëhemi prindër. Por sa nga ne e kanë kuptuar se prindërimi është sfidë dhe detyrë me shumë përgjegjësi?!

Në këtë artikull dua të theksoj se ajo që do të ndaja me një tërësi është fakti se secili nga ne, në prindërim, duhet të ndaj bukur fort dy sfida, fëmija yt nuk është fëmija që ti ke qenë dekada më parë, por as nuk është ai fëmijë që ti do të dëshiroje të kishe, dhe ky është një gabim sa parimor aq edhe vizionar i të gjithë prindërve.

Ne pranojmë dhe duam të bëhemi prindër, dhe duhet të pranojmë, përqafojmë dhe të jemi të gatshëm t'i duam ata pa kushte, sepse të metat dhe gabimet, nuk i bëjnë ata më pak të dashur për ne. Si rrjedhojë, ne duhet t'i mbështesim ata duke bërë përpjekje maksimale për t'u siguruar qetësi dhe lumturi emocionale. Një fëmijë duhet të jetë i aftë të lundrojë në sfida dhe të jetë i gatshëm ta përballojë jetën me dhe pa ne. Të pranosh fëmijën tënd është t'i nxisësh atij besim dhe përkujdesje, sukses dhe arritje. Pra duaji, mbështeti dhe pranoi dështimet dhe sukseset në çdo rrethanë, duke i ndihmuar të rritet, të mësojë dhe t'ia dalin me sukses!

Ne shpesh bëjmë krahasime të tipit: “se në kohën time ne,...” dhe ne harrojmë që edhe në kohën tonë kishe pakënaqësi prindërore dhe pafund gabime, por ne humbasim detajin që koha lë gjurmët vetëm të asaj që ne duam të kujtojmë ose rrëfejme.

Andaj nuk është aspak e lehtë të kuptohet edhe krahasimi që ne i bëjmë fëmijës me motrat ose vëllezërit, ose me të tjerë fëmijë, në lidhje me aftësi, paaftësi ose gjëra që ai bën ose nuk bën dot.

Secili nga ne në momentet e para që ka dashur të ketë fëmijë ose që ka mësuar faktin se do të bëhet me fëmijë ka nisur të ëndërrojë, si do të jetë, si do të duket, çfarë do bëhet, edhe pse duken qesharake, prindërit nuk ëndërrojnë për raketa kozmike, pikërisht këto janë ëndrrat e tyre.

E shpesh, ajo që ne arrimë të projektojmë keq është fakti se duhet patjetër të kemi fëmijë të suksesshëm dhe s'jemi gati për asgjë tjetër.

A ka mundësi një lutje për tërë ata lexues të këtij artikulli, që të kuptojmë se fëmija është një dhuratë e çmuar që duhet trajtuar me dinjitet e dashuri, duhet kuptuar, mbështetur dhe as më pak gjykuar, bullizuar dhe formatuar si një shpirt i nënshtruar, kur ai në këtë botë erdhi si një shpirt i lirë. Fëmija do të rrëzohet në vegjëli, do të marri notë të keqe, do të bëjë gabime, mbi të do të ngrihen gishtërinj, si në secilin nga ne në vegjëli dhe prindi duhet të jetë aty për ta këshilluar, ndihmuar të ngrihet, orientuar dhe mbrojtur vogëlushin që është ende i ri dhe s'i di si funksionon bota.

Por i dashur prind, duaj fëmijën që ke, jo atë që do të doje që të kishe! Stop stereotipave në

Flisni me fëmijën tuaj si shokë, pasi kur ata zbërthehen është i vetmi moment për t'u njohur thellësisht dhe pa gjykime me ta, madje shpjegojuni atyre edhe ngjarje nga jeta juaj, gabimet dhe rebelimet që keni bërë dhe se as ju s'keni qene fëmijë më të mirë se ata.

prindërim pasi, as ata s'na zgjodhën ne, por për çdo fëmijë, modeli është prindi.

Shpesh ne kujdesemi të mbajmë fort autoritetin prind dhe harrojmë të kuptojmë se ata rriten shpejt dhe ka shumë pak kohë të ndërveprojmë dhe të komunikojmë me ata. Shpesh duhet të jemi ne ata që duhet të gjejmë gjuhën e komunikimit me ta. Pra, duhet të kuptojmë përgjegjësinë që ne kemi që të gjejmë me ta gjuhën e duhur dhe jo gjuhën e autoritetit prindëror, sepse shumë shpejt do të lihem të refuzuar, të pa kuptuar dhe dëmi s'rëndon më mbi ne, por mbi të shtrenjtë tanë.

Ne duhet të përpiqemi së paku të jemi të qartë me ata. Pra ne s'po ndërhyjmë tek ata për t'i tjetërsuar, por për t'i ndihmuar dhe ata së dinë, por dashuria jonë është e thellë, e pafundme dhe e pakushtëzuar, sido që ata t'i marrin urdhrat tona. Edhe pse ne shpesh jemi evaziv në zë dhe në fjalë, kjo se ndryshon faktin se të vetmet qenie që ne do të donim t'i shikonim më mirë se veten, janë pikërisht ata.

Lënia pas dore e pritshmërisë së rreme, është e vetmja mënyrë që ne të jemi realist, të mbështesim dhe të kuptojmë në mënyrën e duhur fëmijën tonë.

Faza më e vështirë e një prindi dihet që është faza "Prano fëmijën tënd!", vetëm pas kësaj faze ne do t'i ndihmojmë vërtet ata që të rriten.

Flisni me fëmijën tuaj si shokë, pasi kur ata zbërthehen është i vetmi moment për t'u njohur thellësisht dhe pa gjykime me ta, madje shpjegojuni atyre edhe ngjarje nga jeta juaj, gabimet dhe rebelimet që keni bërë dhe se as ju s'keni qene fëmijë më të mirë se ata. Këto momente sinqeriteti dhe komunikimi me fëmijët psikologjia i njeh si momentet "aha" prind-fëmijë.

Ta duash fort fëmijën tënd nga ana tjetër s'do të thotë se ne do t'i përqafojmë dhe për më pak mbështesim gabimet e tyre në mënyrë kategorike. Ne do i këshillojmë dhe orientojmë, por kurrësi nuk do t'i mbështesim kur ata gabojnë.

Të qenët të ndjeshëm ndaj asaj që fëmija jonë është, pikërisht kjo është detyra e vërtetë e një prindi. Ti mund të jesh një prind trim që kë një fëmijë frikacak, ose një prind

Fëmija ka nevojë të domosdoshme t'i ofrohen këshilla dhe mbështetje, që jeta e tij të përparojë në mënyrë pozitive.

Dashuria e pamatshme për natyrën e tij unike, është mbështetja dhe shpërthimi i zhvillimit të tij pozitiv.

leximtar që ke një fëmijë që nuk lexon, jo patjetër duhet të jemi të njëjtë ose të ngjashëm për t'u dashur, pasi fëmija të shikon si hero dhe kur ai vjen në jetën tënde mbështete, sepse ai të do ty pa kushte.

Sigurisht që natyra e një fëmije përbën një pjesë të rëndësishme të karakterit të tij, aftësive, qëllimeve që ai ka, apo performancës që shfaq. Dhe ne duhet të zbulojmë talente që ai ka në mënyrë që t'i zhvillojmë me kujdes talentet e tij. Fëmija ka nevojë të domosdoshme t'i ofrohen këshilla dhe mbështetje, që jeta e tij të përparojë në mënyrë pozitive.

Dashuria e pamatshme për natyrën e tij unike, është mbështetja dhe shpërthimi i zhvillimit të tij pozitiv.

T'u nxisësh besimin dhe t'i përkrahësh janë dy elemente shumë të rëndësishme në jetën e fëmijëve tanë.

Ne s'mund të kemi fëmijë tërësisht të qetë, dhe që nuk bëjnë gabime dhe pastaj të kemi njerëz të zotët në jetë që ia dalin dhe janë të suksesshëm, andaj mendoje dy herë, kur krahason me fëmijët e tjerë që ke, ose me fëmijët e shoqeve, pasi edhe ata mund të donin një nënë – baba tjetër, por të kanë pranuar dhe mitizuar vetëm ty..., si prindi ideal dhe më i miri i mundshëm. Nëse nuk mund të kemi fëmijën ideal, kemi një detyrë, të jemi ne prindi ideal që ne vetë kemi pasur ose do të donim të kishim...



Ndikimi i pavarësisë së Kosovës në përmirësimin e statusit të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut

Murtezan Idrizi

Pavarësia e Kosovës për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut ishte një shtyllë shtesë për vetëbesim dhe për sigurinë e tyre. Me këtë akt shqiptarët e kësaj ane i forcuan pozicionet politike dhe sociale.

HYRJE

Në fillim ia vlen të theksohet se Kosova dhe pjesa Veriperëndimore e Maqedonisë, në harkun kohor historik, gjithmonë kanë qenë një tërësi e pandashme. Nëse e shikojmë kronologjinë historike, Kosova dhe Maqedonia e sotme, që para erës sonë, ishin pjesë e mbretërisë Ilire, e më pas asaj Dardane, po edhe e Maqedonisë antike. Kështu do të vazhdojë edhe gjatë Perandorisë Romake dhe Bizantine, që do të thotë se mbretëritë janë ndryshuar, por harta e këtyre dy vendeve brenda kufijve ka ngelur njëjtë. Ashtu do të jetë edhe gjatë Perandorisë Osmane, kur këto dy vende ishin nën ombrellën e njëjtë – asaj kohe ky territor njihej si Vilajeti i Kosovës me kryeqendër Shkupin.

Pas Perandorisë Osmane, këto dy vende do të pushtohen nga forcat jugosllave dhe kjo do të vazhdojë deri në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, kur do të nisë shpartallimi i Jugosllavisë. Nga të gjitha republikat e tjera jugosllave, disa prej tyre u ndanë pa luftë, e disa me pak përleshje arritën pavarësinë, kurse Kosova me shumë gjak të derdhur, për disa vite radhazi dhe me dy vjet luftëra mes forcave jugosllave dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mezi arriti një marrëveshje, nga e cila doli kushtetuta e Ahtisarit.

PAVARËSIA E KOSOVËS

Para kësaj marrëveshjeje (të njohur si Kushtetuta e Ahtisarit), konflikti i Kosovës kulmoi më 28 shkurt 1998, kur forcat paramilitare serbe i sulmuan fshatrat Likoshan dhe Qirez në Drenicë. Së shpejti në këtë do të përfshihet e gjithë Kosova. Kjo luftë do të vazhdojë deri më 11 qershor 1999. Në këtë luftë u dëbuan 800.000 shqiptarë nga

territoret e tyre, u vranë 15.000 njerëz, prej tyre 2.400 luftëtarë të UÇK-së, kurse të tjerët ishin popullatë civile. Gjatë luftës janë zhdukur rreth 5.000 njerëz, ndërkohë që shumica e tyre kanë ngelur të pa gjetur.

Kosova, prej vitit 1999 e deri në vitin 2008, është udhëhequr nga EULEX-i, kjo në bazë të Kushtetutës së Ahtisarit.¹ Pas kësaj do të vijojë shpallja e pavarësisë, e cila për Kosovën, si një shtet i ri, solli shumë përgjegjësi të reja. Gjithë kjo periudhë kohore e shtet ndërtimit të Kosovës i ngjan ndërtimit të një kulle të madhe, për ndërtimin e së cilës duhet punë, përpjekje dhe mund. Njëjtë është edhe pavarësia e shtetit – duket sikur ndërtimi i shtëpisë: më lehtë bëhet e më vështirë mbahet.

Pavarësia e Kosovës është një përpjekje njëshekullore me shumë vuajtje dhe gjak. Për këtë arsye lirisht mund të bëhet krahasimi i kësaj përpjekjeje me ngjarjet identike në historinë tonë. Nëse në fillim të shekullit të kaluar pavarësia e Shqipërisë ka qenë ngjarja më e madhe në historinë shqiptare, në fillim të këtij shekulli pavarësia e Kosovës është ngjarje historike po me aq rëndësi sa edhe e para. Si pavarësia e parë (Shqipëria), ashtu edhe e dyta (Kosova), janë rezultat i përpjekjeve shekullore të shqiptarëve për liri dhe dinjitet. Normalisht, vlen të theksohet se rrethanat e njëres pavarësi dallojnë nga pavarësia tjetër nga shumë pikëpamje kohore e historike, që hëpërhe nuk janë synimi i këtij hulumtimi, por që mund të mendohet për të ardhmen një studim i tillë.

Punët dhe përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës filluan pikërisht më 17 shkurt 2008. Problemet dhe sfidat e Kosovës mbesin në radhë të parë te përpjekja për mbrojtjen nga parcelizimi i mundshëm territorial (asocia-

cioni), te mbrojtja nga grabitja e pasurisë kombëtare, te sundimi i ligjit, te lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, te angazhimi për jetë dinjitoze të qytetarit të Kosovës. Megjithatë kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, nuk e kishte konfirmuar ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, mirëpo mediat vendase, por edhe ato të huaja, patën njoftuar se më 17 shkurt në orën 17:00 do të bëhet shpallja zyrtare.²

Vlen të theksohet se disa ditë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kryeministri Thaçi ishte në Maqedoni, ku kishte takime me homologun e tij Nikolla Gruevskin. Takimi kishte qenë shumë korrekt dhe i qetë, ndërsa në takim ishte biseduar gjithçka që i tangonte këto dy vende, me theks të veçantë demarkacioni i kufirit me Kosovën pasi të shpallej pavarësia. Njëkohësisht në këtë takim ishte biseduar edhe për njohjen e Kosovës nga ana e Maqedonisë. Në këtë takim kryeministri i Maqedonisë, Gruevski, pati theksuar se Maqedonia do ta njohë pavarësinë e Kosovës, por nuk do të jetë nga vendet e para e as nga ato të fundit. Në këtë takim u tejkaloan të gjitha paragjykimet dhe u pranua realiteti i ri në Ballkan.³ Të gjitha këto paragjykime te pala maqedonase rrjedhin nga kontesti identitar për Maqedoninë që nacionalistët bullgarë, serbë dhe grekë e paraqesin si pengesë të kohëpaskohshme.

NDIKIMI I PAVARËSISË SË KOSOVËS TE SHQIPTARËT E MAQEDONISË

Faktori politik shqiptar në Maqedoni, qoftë ai në pushtet ose ai në opozitë, ishin njëzëri pro pavarësisë së Kosovës. Si ata në pushtet, ashtu edhe opozita, besonin fuqishëm se mes dy shteteve shqiptare do të forcohet zëri i tyre në parlamentin e Maqedonisë. Kështu shqiptarët e kësaj ane pritnin të bëhen me dy shtete shqiptare.

Pavarësia e Kosovës për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut ishte një shtyllë shtesë për vetëbesim dhe për sigurinë e tyre. Me këtë akt shqiptarët e kësaj ane i forcuan pozicionet politike dhe sociale. Kjo ngjarje historike për shqiptarët anekënd botës, e në veçanti për ata të Maqedonisë, hapi një kapitull për barazi të plotë me palën maqedonase. Kosova, në kohën e përlëshjeve gjashtëmujorësh të vitit 2001 mes forcave ushtarake maqedonase (ARM) dhe atyre të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), ishte përfshirë në formë indirekte, madje që mund të thuhet se ishte protagonist kryesor për rezistencën dhe arritjet e shqiptarëve të Maqedonisë. Kur dihet se shqiptarët e Maqedonisë pas vitit 2001, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, i avancuan dukshëm të drejtat e tyre, duke u rritur punësimi i shqiptarëve në administratën shtetërore, në ushtri dhe në polici. Pjesa tjetër e të drejtave ngeli të avancohet në tryezën politike. Përkaj këtyre arritjeve shqiptare, propëseprapë vendi mbeti pa u integruar në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu pjesa tjetër e avancimit të të drejtave të shqiptarëve ngeli të zgjidhet në tryezën politike, gjë që nuk ka dhënë rezultat të duhur brenda 22 viteve. Të drejtat që



duhet të zgjidhen në tryezën politike ecin me hapa të ngadalhtë.

Vlen të përmendet se me pavarësinë e Kosovës u rrit ndjeshëm vetëdija kombëtare te shqiptarët e Maqedonisë në të gjitha portet e jetës, e sidomos në kampin politik. Tanimë pjesa opozitare shqiptare kërkonte rrugë të reja alternative për avancimin e të drejtave të shqiptarëve, duke filluar nga ridefinimi i shtetit, e deri te parlamenti dydhomësh, bile edhe federalizim të vendit në rast se nuk përfillen kërkesat e shqiptarëve, e që për momentin ende ka ngelur enigmë politike.

T'i rikthehem asaj që e përmendëm në fillim, se shqiptarët e Maqedonisë me ata të Kosovës janë një tërësi e pandashme mes vete. Përtej gjuhës, gjakut, traditës dhe historisë, ata i lidh farefisnia, afërsia dhe miqësia, e cila është shumë e theksuar mes tyre. Por, meqë Shkupi ishte kryeqendra e Vilajetit të Kosovës, shumë shqiptarë nga Kosova u vendosën në Shkup. Më pas vijuan presionet e Mbretërisë SKS⁴ ndaj shqiptarëve të Kosovës pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, gjë që bëri që shqiptarët edhe më shumë të shpërngulen nga Kosova për në Maqedoni, sepse atje i kishin të afërmit e tyre. Sot lirisht mund të themi se gjyma e popullatës shqiptare në Shkup, janë shqiptarë të ardhur nga Kosova në kryeqytetin e tyre të mëhershëm.

Për në fund, mund të themi se Pavarësia e Kosovës për shqiptarët e Maqedonisë ishte lindja e mëmëdheut të dytë pas Shqipërisë. Me këtë akt Kosova e fitoi pavarësinë, kurse shqiptarët në Maqedoni automatikisht e fituan lirinë e shprehjes për të gjitha çështjet e ndjeshme. Kuptohet, pavarësia e Kosovës e ndryshoi klimën shoqërore në Maqedoninë multietnike, por për fat të keq nuk arriti të ndryshojë politikën regresive të partive në pushtet, qofshin ato parti maqedone ose ata shqiptare.

Pavarësia e Kosovës, asaj kohe, u festua në të gjitha qytetet e Maqedonisë që janë me shumicë shqiptare, duke filluar nga qyteti i Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Strugës, Dibërës e deri në Kumanovë. Ndërkaq manifestimi qendror është mbajtur në kryeqytetin e Maqedonisë, në Shkup.

1 KOHA, viti II, numri 370, 16/17 shkurt 2008, f.3

2 KOHA, viti II, numri 370, 16/17 shkurt 2008, f.3.

3 KOHA, viti II, numri 370, 16/17 shkurt 2008, f.2.

4 Mbretëria Serbe Kroate dhe Sllovene.

Jeta dhe personaliteti shkencor i mufesirit bashkëkohor, Muhamed Ali Sabunit

Blerton Bahtiri

Muhamed Ali es Sabuni, më 19 tetor të vitit 2007, u zgjodh “Personaliteti Islam i Vitit” nga Komisioni Ndërkombëtar i Kuranit të Shenjtë me seli në Dubai, në shenjë mirënjohje për kontributin e tij në shërbim të fesë përmes botimeve të tij, veçmas në fushën e tefsirit.

1. JETA

1.1. Emri, lindja dhe prejardhja

Shejh Muhamed Ali es Sabuni, emri i të cilit është Muhamed Ali, lindi në vitin 1930 (1348 h.) në qytetin Halep të Sirisë. Siç tha ai, mbiemrin Sabuni e kanë marrë për shkak të biznesit të babait të tij me sapun.¹

Babai i Muhamed Ali es Sabunit ishte Shejh Xhemili, njëri nga dijetarët e mëdhenj të qytetit të Halepit. Shejh Xhemili shquhej me devotshmërinë dhe diturinë e tij. Ai kishte arritur një pozitë të lartë në Xhaminë “Umajad” për shkak të njohurive të tij rreth Kuranit të shenjtë dhe shkencave islame. Edhe pse ishte në vështirësi financiare, ai i kushtoi rëndësi shumë të madhe edukimit të fëmijëve të tij. Nëna e tij ishte një zonjë e njohur për devotshmërinë dhe sinqeritetin e saj, ajo shquhej edhe për mirësinë e saj në raport me njerëzit.²

2. PERSONALITETI SHKENCOR

• 2.1. Jeta arsimore dhe arritjet shkencore

Muhamed Ali es Sabuni filloi të studionte shkencat fetare që në fëmijëri dhe mori pjesë në tubimet shkencore të mbajtura rreth Kuranit të shenjtë, Hadithit dhe jurisprudencës islame, duke u pajisur kështu me secilën nga shkencat fetare ekzistuese. Marrja e diplomës me nota të larta, arritja e vendit të parë në qytetin e Halepit dhe vendit të dytë në Siri, mjafton për të treguar zellin dhe mundin e Sabunit. Falë këtyre sukseseve, familja i dha



edhe më shumë rëndësi shkollimit të tij, ndërsa disa nga të afërmit e tij dëshironin që ai të bëhej inxhinier ose doktor, mirëpo ai preferoi të vazhdonte studimet e shkencave fetare. Sabuni, i cili filloi t'i drejtohej komunitetit kur ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç, u martua një vit më vonë, kur ishte shtatëmbëdhjetë vjeç.³

Pas mbarimit të shkollës së mesme në Halep, Ministria për Çështje të Vakëfeve të Sirisë, e dërgoi atë për të studiuar në Universitetin Al Az har të Egjiptit, duke ja mbuluar shpenzimet e studimit. Në Az har ai përfundoi Fakultetin e Shariatit në vitin 1952,

ndërsa në vitin 1954, përfundoi studimet e magjistraturës në fushën e gjyqësisë islame.

Pas përfundimit të studimeve dhe rikthimit të tij në Siri ai u angazhua në mësimdhënie në shkollat e mesme të Halepit, ku ligjëroi lëndën e Kulturës Islame ndërmjet viteve 1955-62. Me kërkesë të Fakultetit të Sheriatit dhe Studimeve Islame si dhe Fakultetit të Edukimit në Mekë, ai u dërgua në Arabinë Saudite nga Ministria e Arsimit dhe Edukimit të Sirisë si profesor vizitor.⁴ Ai qëndroi afërsisht 30 vjet në këto institucione.

Muhamed Ali es Sabuni, më 19 tetor të vitit 2007, u zgjodh “Personaliteti Islam i Vitit” nga Komisioni Ndërkombëtar i Kuranit të Shenjtë me seli në Dubai, në shenjë mirënjohje për kontributin e tij në shërbim të fesë përmes botimeve të tij, veçmas në fushën e tefsirit. Me këtë rast atij iu dha një çmim nga komisioni në fjalë. Ibrahim Bu Milha, i cili mbajti një konferencë për shtyp në emër të komisionit, bëri deklaratën e mëposhtme: “Muhamed Ali es Sabuni u zgjodh nga komisioni, sepse ai i plotësoi të gjitha kushtet e nevojshme për personalitetin islam që kërkonte komisioni.”⁵

Një deklaratë e tillë është vërtet e jashtëzakonshme për të njohur personalitetin e Sabunit. Në vitin në të cilin Sabuni u vlerësua i denjë për këtë çmimin, ai ishte personi i njëmbëdhjetë që komisioni u takua dhe i dha një çmim. Ky çmim më parë iu dha dijetarëve të njohur të botës islame, siç ishin: Shejh Muhamed Muteveli el Sha’ravi, dr. Zaghlul en Naxhar, dr. Jusuf el Karadavi dhe dr. Alija Izetbegoviqit.⁶


• 2.2. Mësuesit e tij

Mësuesit e tij ishin: Muhamed Said Idlibi, Muhamed Nexhib Serraxh (hoxhë i shkencës së tefsirit dhe hadithit), Ahmed Shemma (hoxhë i shkencës së Jurisprudencës), Ragib et Tabbah (hoxhë i historisë), Shejhu’l-Kurra Muhamed Nexhib Hajjat; pra te ky hoxhë, Sabuni ka përfunduar edhe memorizimin e Kuranit, hifzin.⁷

• 2.3. Librat e tij

Të gjitha veprat e tij janë në arabisht. Më vonë disa nga veprat e tij janë përkthyer në gjuhë të ndryshme.

Stili i tij është komod, i kuptueshëm dhe shmang zgjatimet e panevojshme, duke i dhënë atij një mënyrë unike të të shprehurit.



Stili i tij është komod, i kuptueshëm dhe shmang zgjatimet e panevojshme, duke i dhënë atij një mënyrë unike të të shprehurit. Disa nga veprat e tij janë autoriale, ndërsa disa prej tyre përbëhen nga hulumtimet e tij dhe krahasimet e veprave të studiuesve të mëparshëm. Veprat e Muhamed Ali es Sabunit mund t'i rendisim si më poshtë:

• 2.3.1. Veprat e tij mbi shkencat e Kuranit dhe shkencën e Tefsirit

a - Revaiu'l Bejan Tefsiru Ajati'l Ahkam

Kjo vepër, në të cilën ai interpretoi Kuranin e shenjtë përmes vargjeve të tij, u botua në dy vëllime. Është thënë se kjo vepër, e cila mësohet si tekst mësimor në Fakultetin e Shkencave Islame të Mekës,⁸ u përgatit duke marrë parasysh rendin e Kuranit të shenjtë. Ajetet e dispozitave u përpunuan në mënyrë të njëpasnjëshme, dhe meqenëse ajetet për të njëjtën temë nuk ishin të kombinuara, një temë që ishte diskutuar më parë u përpunua përsëri kur një ajet tjetër përmendte të njëjtën temë. Prandaj, disa çështje u rishqyrtuan. Duke qenë se temat në përmbajtjen e tij janë të rregulluara për mësim, ajo ka zënë vend në literaturë si një vepër e preferuar sidomos nga teologët.

b - Safvetu't Tefasir (3 vëllime)

Në këtë vepër, e cila u shkrua në tre vëllime, Muhamed Ali es Sabuni, mori për bazë metodën e transmetimit dhe e shkroi atë duke përdorur shumë tefsire.

Muhamed Ali es Sabuni nuk ka neglizhuar të përfuturuarit nga komentet klasike, por gjithashtu duke e shpjeguar këtë vepër në stilin e tij të kuptueshëm dhe të rrjedhshëm.⁹ Në fillim të secilës sure të kësaj vepre, pasi të thuhet se ku është zbritur dhe çfarë tema mbulon, përmendet përmbajtja e sures. Duke shpjeguar marrëdhëniet ndërmjet vargjeve, aty ku ai e konsideroi të nevojshme, Sabuni shpjegoi fjalët që ishin të mbyllura për interpretim. Sabuni, i cili ndonjëherë përdor poezi arabe, kalon në interpretimin e vargjeve pasi shpjegon arsyet e shpalljes së tyre. Vepër, e cila filloi të shkruhej në

Mekë, u shkrua në pesë vite dhe prapë është kompletuar në Mekë.¹⁰

c - Et Tibjan fi Ulumi'l Kur'an

Kjo vepër e Sabunit, e cila është shkruar mbi shkencat e Kuranit dhe prek tema të tilla si burimet e shpalljes, përmbledhja e Kuranit, Ixhazu'l Kuran, Kurani që përbëhet nga shtatë shkronja dhe pjesët e komentet, është dyqind e tridhjetë e pesë faqe.

Sabuni deklaroi se ai e përgatiti këtë vepër në vitin (1390 h.) për të kontribuar në kurset e studentëve të tij që studionin në Universitetin e Shkencave Islame në Mekë.¹¹

d - Muhtasar Ibën Kethir

Kjo vepër, e cila është një version i përmbledhur dhe i shkurtuar i veprës së Hafiz Ibën Kethirit të quajtur Tefsiru'l Kur'ani'l Adhim, është përmbledhur në tre vëllime. Punimi, i përgatitur në një gjuhë të thjeshtë, pa cenuar integritetin e temës, u përgatit duke zgjedhur mes mendimeve dhe duke eliminuar klauzolat e panevojshme.¹²

Ka shkruar edhe vepra të tjera si: Muh-tasaru Tefsiri Taberi, Ixhazu'l Bejan fi Suveri'l Kur'an, Et Tefsiru'l Vadih el Mujesser etj..

• 2.3.2. Veprat e tij mbi shkencën e Fikhut

a - El Mevarithu fi Sheriati'l Islamijje

Kjo vepër e shkruar nga Muhamed Ali es Sabuni për të drejtën trashëgimore është e ndarë në dhjetë kapituj dhe në këtë mënyrë trajtohet e drejta trashëgimore. Në pjesën e parë trajtohen ajetet e trashëgimisë dhe përpunohen dispozitat e marra nga ajetet. Përveç kësaj, pyetjet rreth trashëgimisë përfshihen në kuadrin e vargjeve. Përveç arsyeve pse pjesa e meshkujve është më e lartë se ajo e femrave, diskutohet edhe gjendja e grave në lidhje me trashëgiminë para Islamit. Gjithashtu nën këtë titull jepet informacion për aksionet e prindërve, bashkëshortit dhe fëmijëve. Në kapitujt e tjerë, përkufizimi i çështjeve të trashëgimisë, braktisjes dhe asabes është shpjeguar në mënyrë të kuptueshme. U diskutua për situatën e gjyshit, së bashku me vëllezërit dhe motrat e tij dhe u diskutua edhe për pjesën e tij të trashëgimisë. Sabuni e shkroi këtë vepër, e cila përbëhet nga dyqind e njëzet faqe, gjatë kohës që ai jepte mësim në Universitetin Umm al Kura. Sabuni ka deklaruar se ai e përgatiti këtë libër për ta paraqitur në të mirë të studentëve të tij në një gjuhë të thjeshtë dhe të rrjedhshme, duke shmangur zgjatimet e panevojshme.¹³

Para se të
vdiste librarinë
e tij të pasur ia
dhuroi si
dhuratë
hoxhës İhsan
Şenocak dhe
nxënësve të tij.

b - El Hedju'n Nebevijju's Sahih fi Salati't Taravih

Muhamed Ali es Sabuni e shkroi këtë vepër për namazin e taravisë, i cili falet pas namazit të jaciesë në Ramazan. Në vepër trajtohet ligjshmëria e namazit të teravive dhe praktikimi i tij të myslimanët në rrjedhën e tij historike. Autori iu përgjigj disa pretendimeve për faljen e namazit të teravive me xhemat në njëzet rekate, që është mënyra e zakonshme e faljes së tij të myslimanët. Përveç kësaj, ajo u praktikua si në kohën e Pejgamberit a.s., dhe të kalifëve të drejtë, e veçanërisht gjatë periudhës së Hz. Omerit r.a., i cili e urdhëroi Ubej b. Kabin r.a., që t'i falte njëzet rekate. Sabuni, i cili diskutoi për emërimin e tij, e shkroi këtë vepër në dritën e këtij informacioni për t'iu përgjigjur kritikave rreth namazit të taravisë. Në përmbajtjen e veprës trajtohen tema si rregulli dhe virtyti i namazit të teravive, emërtimi i tij, numri i rekateve, mendimet e dijetarëve dhe dëshmia se është sunet falja e këtij namazi në njëzet rekate. Kjo vepër është e përbërë prej 149 faqeve.¹⁴ Ka shkruar edhe libra tjerë si: Risaletun fi Hukmi et Tesvir, Risaletu's Salat etj..

3. VDEKJA

Ka vdekur në vitin 2021 në qytetin Yalova të Turqisë. Vlen të theksohet fakti se para se të vdiste librarinë e tij të pasur ia dhuroi si dhuratë hoxhës İhsan Şenocak dhe nxënësve të tij. Allahu e mëshiroftë dhe e gradoftë me Xhenet Shejh Sabunin!

- 1 İbrahim, Demir, *Muhammed Ali es-Sâbûnî ve Tefsir Metodu* (Ankara Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Yüksek Lisans Tezi, 2000), 13.
- 2 İbrahim, Demir, *Sabuni ve Tefsir Metodu*, f.13.
- 3 İbrahim, Demir, *Sabuni ve Tefsir Metodu*, f.13-14.
- 4 Mehmet, Yolcu, *Muhammed Ali es-Sâbûnî; Eserler, Fikirler, Tenkitler*, (İstanbul: Erguvan Yayınevi, 2019), f. 21.
- 5 <https://www.biyografi.net/kisiayrinti.asp?kisiid=5740>. Erişim Tarihi: 08.07.2020.
- 6 <https://www.biyografi.net/kisiayrinti.asp?kisiid=5740>. Erişim Tarihi: 08.07.2020.
- 7 İbrahim, Demir, *Safvetu'l-Tefsir 'de Belağat*, f. 3.
- 8 İbrahim, Demir, *Safvetu'l-Tefsir 'de Belağat*, f. 20.
- 9 Maşallah, Turan, *Gayb İlminin Yorumlamasındaki Tutarsızlıklar; Muhamed Ali Sâbûnî Örneği*, Şarkiyat İlmî Araştırmalar Dergisi 8/15 (Nisan 2016), f. 132.
- 10 İbrahim, Demir, *Safvetu'l-Tefsir 'de Belağat*, f. 6.
- 11 Sabuni, *et-Tibjan*, f. 5.
- 12 İbrahim, Demir, *Sâbûnî ve Tefsir Metodu*, f. 22.
- 13 Muhamed Ali, es-Sabuni, *el-Mevarithu fi Sheriati'l-Islamijje*, (Mekke-i Mükerrreme Ümm al-Kura Üniversitesi: Daru'l-Hadith).
- 14 Muhamed Ali, es-Sabuni, *el-Hedju 'n-Nebevijju's-Sahih fi Salati't-Taravih*, (Mekke-i Mükerrreme Ümm al-Kura Üniversitesi: Daru'l-Hadith).

Kontributi i Ibën Mexhidit (1430 – 1500) në zhvillimin e shkencave të gjeografisë

M.sc Artan Mehmeti

Shihabuddin Ahmed ibën Mexhid b. Muhamed lindi në ytetin e Omanit Ras el Haimah. Në kohët moderne ky qytet sot i takon Emirateve të Bashkuara Arabe. Familja e tij kishte një traditë të gjatë në lundrim. Babai dhe gjyshi i tij ishin të njohur si kapitenë të anijeve. Ai ishte një marinar i njohur, që me punën e tij dha kontribut të madh në zhvillimin e gjeografisë, hartografisë, meteorologjisë dhe astronomisë.

Në moshën 17 vjeçare, Ibën Mexhidi ishte në gjendje për të drejtuar një anije gjatë lundrimit në det të hapur. U bë i famshëm për arsye se ishte i njohur si marinar i parë arab. Në përfundim është i njohur si marinar i cili e ndihmoi Vasco de Gamen, që të gjejë rrugën nga Afrika për në Indi.

Ibën Mexhidi gjatë jetës së tij bëri shumë kërkime në fushën e oqeanologjisë, duke shkruar shumë libra rreth kësaj shkence. Ai shkroi edhe për mënyrën e orientimit të anijeve gjatë lëvizjes së tyre në det të hapur. Këto libra iu ndihmuan popullit të Gjirit Persik për të arritur në brigjet e Indisë, Afrikës Lindore si dhe në destinacionet e tjera.

Nga librat e Ibën Mexhidit që kanë mbërritur deri në ditët tona ne mësojmë në një mënyrë shumë të



Ibën Mexhidi

Në moshën 17 vjeçare, Ibën Mexhidi ishte në gjendje për të drejtuar një anije gjatë lundrimit në det të hapur. U bë i famshëm për arsye se ishte i njohur si marinar i parë arab. Në përfundim është i njohur si marinar i cili e ndihmoi Vasco de Gamen, që të gjejë rrugën nga Afrika për në Indi.

qartë se ai nuk ishte vetëm një teoricien, por në të njëjtën kohë me vite të tëra Ibën Mexhidi ka punuar në mënyrë aktive si detar midis Arabisë, Indisë dhe Azisë Juglindore. Librat e tij mbase nuk janë aq sistematik sa pritej të japin këtë përshtypje. Ai përfaqëson shkencën e detarisë që bazohet në orientimin e Yllit Polar dhe të një serie yjesh të pa lëvizshëm që lindin dhe perëndojnë në horizont me distanca të një vlere prej 11°15' të gjerësisë gjeografike, si dhe në të njëjtën kohë në parimin e përdorimit të busullës. Gjithashtu Ibën Mexhidi në librat e tij regjistron shkallën e gjerësisë gjeografike të shumë vendeve në Oqeanin Indian, por bashkë me këtë gjë, ne mësojmë shumë pak të dhëna konkrete në lidhje me matjet e distancave. Shkrimet e tij, ashtu si në disa situata të tjerat të tij, të japin përshtypjen se ai presupozon se lexuesi zotëron disa njohuri të para në këtë fushë. Në librat e tij, Ibën Mexhidi, po ashtu shfaqet edhe si një detar shumë i ditur, i cili e zotëron me një vetëbesim të madh fushën e tij, duke zotëruar gjithashtu njohurit bazë të astronomisë. Materialet që ai ka përdorur tregojnë një nivel të zhvilluar të shkencës së detarisë.

Në mesin e shumë librave të botuara nga shkenca e oqeanografisë, libri i

Ibën Mexhidit me titull “*Kitab el Fevaïd fi usul ilm el Bahr va el Kavaid*” ka të bëjë me parimet dhe rregullat e lundrimit. Ky libër ndoshta është puna më e madhe shkencore e shkruar ndonjëherë tek arabët. Në këtë libër jepen detaje të pakrahasueshme për Oqeanin Indian, rrugët që përdoren për ta kaluar këtë oqean, portet kryesore të rajonit, informacione mbi disa ishujt si Madagaskari, Komoret, etj., informacione më të detajuara për Detin Arabik dhe Detin e Kuq, të cilin ai e quan si detin më të rrezikshëm nga të gjitha detet në botë. Gjithashtu Ibën Mexhidi në këtë libër trajton tema si: problemet teorike gjatë lundrimit, aplikimi i astronomisë gjatë lundrimit, përcaktimi dhe përshkrimi i rrugëve detare, matjet e gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike, shenjat dhe monumentet që duhet ndjekur gjatë lundrimit në dete të hapura etj.. Për disa nga zbulimet në fushën e detarisë që ndodhën në këtë libër ai thotë se i përkasin punimeve të tij të suksesshme, ku njëra nga këto suksese është edhe suksesi në zhvillimin e busullës.

Në këtë libër ai pasqyron një histori të kërkimeve në fushën e lundrimit nga hulumtuesit arabë para kohës së tij.

Sipas Ibën Maxhidit, shkenca e detarisë (*Ilmu-I-Bahri*), të cilën ai e cilëson si shkenca e detit, është teorike dhe empirike. Ai i ndan detarët në tre grupe:

a) Grupi i parë përfshin shoqëruesit e thjeshtë detarë, udhëtimi i të cilëve ndonjëherë shkon mirë dhe ndonjëherë shkon keq; po ashtu përgjigjet që ata japin ndonjëherë janë të sakta dhe ndonjëherë janë të gabuara. Këta detarë nuk meritojnë të quhen mësues.

b) Anëtarët e kategorisë së dytë që janë dhe mësues të nivelit të mesëm, njihen për kapacitetin e madh të njohurive të tyre. Ata kanë aftësi në këtë fushë dhe i njohin rrugët e vendeve ku ata shkojnë, por mbasi ndërrojnë jetë ata harrohen nga shoqëria, të tillët mund të quhen mësues.



Busulla detare me 32 seksione e punuar nga Ibën Mexhidi

Në librat e tij, Ibën Mexhidi, po ashtu shfaqet edhe si një detar shumë i ditur, i cili e zotëron me një vetëbesim të madh fushën e tij, duke zotëruar gjithashtu njohurit bazë të astronomisë. Materialet që ai ka përdorur tregojnë një nivel të zhvilluar të shkencës së detarisë.

c) Grupi i tretë i detarëve përbën shkallën më të lartë të kësaj fushe. Detari i këtij grupi është shumë i famshëm dhe i zotëron shumë mirë të gjitha operacionet detare; ai është një njeri i ditur që ka shkruar vepra prej të cilave njerëzit kanë përfituar si në kohën e tij ashtu edhe më pas.

Përveç kësaj, Ibën Maxhidi përmend edhe rregullat që duhet të ketë parasysh një kapiten anijeje gjatë udhëtimit si dhe parimet e një morali që duhet të ketë ai.

Libri “*Kitab el Fevaïd fi usul ilm el Bahr va el Kavaid*” është konsideruar si një nga librat më të mirë të shkruar prej tij. Ky libër gjithashtu është konsideruar si një enciklopedi që përshkruan bazat dhe historinë e parimeve të kërkimit, segmentin që paraqet vendqëndrimin e Hënës (është një segment ekliptikë që tregon lëvizjen e Hënës në orbitën e saj rreth Tokës, e që është përdorur nga popujt e lashtë), loksodromin, dallimin në mes lundrimit bregdetar dhe atij në det të hapur, lokacionet e porteve të Afrikës Lindore gjatë udhëtimeve për në Indonezi, pozicionin e yjeve, llogaritjen e kohës së monsuneve

dhe erërave të tjera sezonale, tornadove, si dhe tema të tjera për drejtuesit profesionalë të anijeve. Ai gjithashtu shkroi edhe për përvojën e tij dhe të babait të tij, si dhe mësimet e gjeneratave më të vjetra që lundruan në Oqeanin Indian. Në shumë mënyra, Ibën Mexhidi ishte faktor nxitës për zhvillimin e shkencës në Islam. Ai ishte frymëzim i shkencëtarëve, gjatë hulumtimeve empirike, përfshirë edhe kërkimet në fushat humane.

Nga aplikimi i metodave matematikore dhe astronomike të Ibën Mexhidit gjatë udhëtimeve detare, myslimanët e hershëm kanë arritur të japin një kontribut të madh në zhvillimin e shkencës së oqeanografisë. Përmes këtyre metodave, ata ndërtuan harta, formuluan lista që tregojnë rrugët detare, si dhe krijuan shumë instrumente që shërbenin gjatë udhëtimeve detare. Përveç kësaj, ata nxitën në ndërtimin e anijeve, si dhe shkrimin e librave që shërbenin në fushën e oqeanologjisë. Si pasojë e kësaj, nga shekulli X, detaria arabe



Rruga nëpër të cilën Ibën Mexhidi e udhëhoqi Vasko de Gamën për në Indi

kishte fituar statusin e një shkence të rregullt, kurse arabët mbajtën një monopol mbi Detin e Kuq dhe Oqeanin Indian.

Që nga shkrimtarët e hershëm e deri tek ata modernë, të cilët u morën me përshkrimin e rrugëve detare, Ibën Mexhidi përfaqëson majën e arritjeve islame në shkencën detare. Ai i dinte pothuajse të gjitha rrugët detare të Detit të Kuq, Detit Arabik dhe Oqeanit Indian, duke filluar nga brigjet arabe deri në Afrikën Lindore, si dhe në Indi e Kinë. Ai i përshkroi rrugët e detajuara gjatë lundrimit për në Detin e Kuq, Gjirin Arabik, Oqeanin Indian, në gjirin perëndimor të Kinës, si dhe deteve në Azinë Juglindore.

Një tjetër faktor që ka ndikuar në masë të madhe në rritjen e famës së Ibën Mexhidit, ishte zbulimi i busullës për marinar. Edhe pse kjo busull ishte një shpikje islame, që ishte përdorur shumë shekuj më parë nga myslimanët, në librin e tij **“Kitab el Fevaid fi usul ilm elBahr va el Kavaid”**, ai e kishte përmirësuar shumë atë. Ibën Mexhidi ishte krenar për faktin se busulla arabe ishte shumë më superiore ndaj të tjerave, sepse ajo kishte 32 seksione, kundër 16 seksioneve të busullave të tjera, si dhe gjilpëra magnetike, e cila nuk është e vendosur poshtë, por sipër busullës duke punuar në mënyrë të pa varur.

Vasko de Gama, me ndihmën e Ibën Mexhidit, ka arritur në brigjet perëndimore të Indisë më 14 maj 1498, pa vështirësi të madhe. Vasko de Gama me atë rast ka qenë i habitur me shkathtësinë e udhëheqësit mysliman dhe me diturinë e tij për orientim me ndihmën e yjeve. Deri në atë kohë portugezët për orientim kanë shfrytëzuar Diellin, çka do të thotë se udhëtimi i tyre gjatë natës ka qenë shumë i rrezikshëm. Historiani Joao de Barros, i cili ka udhëtuar me Vasko de Gamën thekson, duke mos përmendur emrin e Ibën Mexhidit, se Vasko de Gama e njohu këtë udhëheqës me

astrollabin e madh të drurit, me diametër 60cm dhe të pajisur me busull. Mirëpo, e gjithë kjo nuk e befasoj Ibën Maxhidin, por u befasua Vasko de Gama, kur Ibën Mexhidi ia tregoi hartat detare me sisteme koordinativ dhe astrollabin e metalit si dhe instrumente të tjera, me të cilat janë shërbyer lundruesit myslimanë. Shumë historianë, duke shkruar për udhëtimin e Vasko de Gamës, pajtohen se udhëheqësi i ekspeditës portugeze ka qenë arab, por nuk pajtohen rreth emrit të tij. Mirëpo, a është ai Ibën Maxhidi apo ndonjë arab tjetër, me ndihmën e tij, Vasko de Gama, ka arritur në brigjet

perëndimore të Indisë. Është e njohur në qarqet shkencore se termini oqeanografi i pari e ka përdor Ibën Mexhidi.

Shumë udhëtime të rëndësishme nëpër oqeanë, siç ishte udhëtimi i suksesshëm i Ferdinand Magelanit në Oqeanin Indian, i atribuohen udhëzimeve dhe studimeve të Ibën Mexhidit. Kaq e madhe ishte fama e tij si një ekspert detar sa që, Sir Richard Burton, pas më shumë se 350 vjetëve pas vdekjes së Ibën Mexhidit, gjatë lundrimit me një anija nga Adeni në vitin 1854, në prezencë të bashkudhëtareve të tij është lutur për nder të Ibën Mexhidit. Një pionier në fushën e lundrimit, emri i tij është dhe do të mbetet krenaria e të gjithë lundruesve të oqeanit. Kur ai ishte larguar, aftësitë arabe të lundrimit kaluan te portugezët dhe të tjerët.

Nga kontributi i dhënë në zhvillimin e shkencës së oqeanografisë, ai bëhet shumë i njohur duke arritur të merr titullin “Luani i Detit”.

Burimet

- Prof. dr. Fuat Sezgin, Epoka e madhe e panjohur. Nga historia e shkencës dhe e teknologjisë islame, përktheu nga turqishtja: Altin Qefaliu, LOGOS-A, Shkup 2015,
- Prof. dr. Muhamed Mahmud es Sefjad, Ndikimi i Islamit në gjeografi, (<http://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=1498>),
- <http://www.alrahalah.com/2011/05/ahmad-ibn-majid-15th-century-ce-%E2%80%939th-century-ah-the-lion-of-the-seas/>,
- <https://www.slideshare.net/AliUsman10/muslim-contributions-in-geography>,
- https://en.wikipedia.org/wiki/Ahmad_ibn_M%C4%81jid,
- <http://www.omanobserver.om/ahmad-ibn-majid-shahabuddin-lion-sea/>,
- <http://archive.aramcoworld.com/issue/200504/the.navigator.ahmad.ibn.majid.htm>,
- <http://ambassadors.net/archives/issue19/profile.htm>.

Medreseja “Alauddin” në Prishtinë dhe rrugëtimet e saj

Azmir Jusufi

FILLET E MEDRESESE GJATË HISTORISË

Medrese është fjalë arabe me kuptimin: vendmësim, vendudhëzim, vendkëshillim. Institucioni ku mësohen shkencat fetare islame, për brezat e rinj dhe më të vjetër. Në fillim medresetë ishin rezultat i bamirësive të myslimanëve të caktuar dhe ndërtoheshin brenda xhamive, por me rritjen e nevojave të myslimanëve, medresetë filluan të ndërtohen si institucione të veçanta. Medresenë e parë e kemi qysh në Xhaminë e Muhamedit a.s., të quajtur *Suffa*.¹

Medreseja e parë në botën islame u ndërtua në vitin 457 (1064) në Nishabur (Irak) nga ana e vezirit Nizamulmulk, nga ku edhe kjo medrese e mori emrin dhe u bë e njohur, i cili e emëroi imam Gazaliun si myderriz (profesor) i parë i saj. Kurse, medreseja e parë osmane u ndërtua në Iznik (Nikea) nga Orhan Gaziu, i cili këtë medrese e ndërtoi posa e pushtoi këtë qytet më 1330-1331 dhe për myderriz të saj e emëroi dijetarin e shquar të kohës, Davud Kajseriun (vd. 1350-1351), i cili kishte mbaruar studimet në Egjipt.

Si institucione klasike të arsimit islam, medresetë, që prej themelimit të Perandorisë Osmane e deri në fund të saj, kanë ofruar arsimimin dhe përgatitjen e një lloji dhe niveli të caktuar të dijetarëve, i cili përputhej me nevojat e shtetit dhe të shoqërisë në çështjet fetare, juridike e shkencore. Në botën osmane burimi kryesor dhe më i rëndësishëm i aktiviteteve shkencore fetare ishin, pa dyshim, medresetë.²

Shumë nga myderrizët dhe nxënësit e medreseve kanë marrë pjesë dhe kanë luajtur rol konstruktiv në të gjitha lëvizjet politike shqiptare, si në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në Lidhjen e Pejës “Besa Besë” etj..

MEDRESETË NË TROJET SHQIPTARE

Trojet shqiptare patën shumë medrese, të niveleve të ndryshme, nga fillestare e deri tek ato të specializuara, për Kuran, hadith, etj.. Edhe sot në trojet shqiptare shkollat fetare islame njihen me këtë emër dhe funksionon një numër i tyre.³

Në bazë të vakëfnameve dhe burimeve të tjera të publikuara deri sot, mund të konstatohet se medresetë e para në trojet shqiptare janë ngritur në fillim të shekullit XV. Medreseja më e vjetër e ngritur në këto troje është Medreseja e Ishak Beut në Shkup, e hapur para vitit 1411. Kurse Medreseja më e vjetër në Kosovë është ajo e themelua në Vushtrri brenda viteve 1444-1455 nga Gazi Aliu beu, pastaj para vitit 1516 në Pejë nga Mehmet Beu, pastaj e Gazi Mehmet Pashës në Prizren e vitit 1537, Medreseja e Besharet Begut në Prishtinë, e ngritur para vitit 1566 etj..⁴

Të përmendim edhe disa nga medresetë e tjera të njohura në trojet shqiptare: Medreseja “Alauddin” në Prishtinë, “Medreseja e Madhe” e Shkupit, “Medreseja e Naltë” në Tiranë, Medreseja “Isa Beu” në Shkup, Medreseja “Medah” në Shkup, Medreseja e “Myderris Ali Efendiut” në Prizren, Medreseja e “Mahmud Pashë Rrotullës” në Prizren, Medreseja e “Emin Pashë Rrotullës” në Prizren, Medreseja e “Javus Mehmed Efendiut” në Prizren, Medreseja e “Sofi Sinan Pashës” në Prizren, etj..

Shumë nga myderrizët dhe nxënësit e medreseve kanë marrë pjesë dhe kanë luajtur rol konstruktiv në të gjitha lëvizjet politike shqiptare, si në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në Lidhjen e Pejës “Besa Besë” etj.. Mirëpo, kontributi i Medresesë për popullin, për Kosovën dhe për shqiptarët ishte edhe më i madh gjatë viteve të 90-ta e këndejmë.⁵

Krijimi i rrethanave të reja shoqërore politike në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore dhe vendosja e sistemit socialist – komunist, si dhe mbetja e Kosovës dhunshëm në kuadër të ashtuquajturës Jugosllavia Federative, imponoi domosdoshmërinë që prijësit fetarë shqiptarë dhe ulemaja në përgjithësi të organizoheshin për mbarëvajtjen e jetës dhe të institucioneve fetare islame në kuadër të hapësirës dhe mundësive të lejuara në kuadër të sistemit që ishte vendosur.⁶

Nga të dhënat e dokumenteve, raporteve dhe kronikave të kohës, shihet se paria e BIK-ut, pas konsolidimit të BIK-ut, çështjen e medresesë, përkatësisht arsimimin e kishte një ndër objektivat më parësore. Për këtë ndërmarrje i gjejmë të angazhuar prijësit e BIK-ut, duke filluar prej hfz. Bajram ef. Aganit - kryetar i Kryesisë së BI-së, pastaj hfz. Mustafa Canhasit (anëtar i Kryesisë së BI-së),⁷ i cili ka qenë i angazhuar dhe i autorizuar nga Kryesia për përgatitjen e dokumentacionit dhe ndjekjen e procedurave tek organet kompetente të shtetit, si në nivelin krahinor, ashtu edhe në nivelet më të larta, për hapjen e medresesë në fjalë.⁸

MEDRESEJA E ULËT NË PRISHTINË

Pas mbylljes së medreseve në Jugosllavi dhe në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore, Këshilli ekzekutiv i Këshillit Krahinor për Kosovën e Metohinë, sipas kërkesës së Bashkësisë Islame të Kosovës, me Vendimin nr. 29503, të datës 26.06.1949, dha pëlqimin e hapjes së Medresesë së Ulët në Prishtinë. Megjithatë, për shkaqe teknike (për shkak të mungesës së lokalit), medreseja nuk ia filloi punës deri në vitin shkollor 1951-1953 (më saktësisht më datë 01.11.1951).⁹

Medreseja e Ulët e Prishtinës “Alauddin” filloi punën në lokalet e një ish-mejtepi në oborrin e Xhamisë Alaudin në Prishtinë¹⁰, mbi bazën e plan-programi të miratuar nga

Medreseja e Prishtinës gjatë dekadave të punës dhe veprimtarisë së saj, ka dhënë dhe vazhdon të japë kontribut të jashtëzakonshëm në përgatitjen e ulemave të rinj, të kuadrit fetar e të drejtuesve shpirtëror të popullit tonë, në formimin e përgjithshëm kulturor të popullit, në edukimin moral, qytetar e atdhetar të brezave të rinj dhe në rrënjosjen e dashurisë për dije e përparim.

Kryesia e Bashkësisë Islame. Pranë medresesë ishte ndërtuar edhe konvikti. Kohëzgjatja e shkollës ishte tre vjet.¹¹

Medreseja e Prishtinës gjatë dekadave të punës dhe veprimtarisë së saj, ka dhënë dhe vazhdon të japë kontribut të jashtëzakonshëm në përgatitjen e ulemave të rinj, të kuadrit fetar e të drejtuesve shpirtëror të popullit tonë, në formimin e përgjithshëm kulturor të popullit, në edukimin moral, qytetar e atdhetar të brezave të rinj dhe në rrënjosjen e dashurisë për dije e përparim. Po ashtu, dihet fakti se medresenë e Prishtinës nuk e kanë kryer vetëm nxënësit nga Kosova, por aty kanë mësuar edhe nxënësit nga Maqedonia, Mali i Zi, Sanxhaku, Kosova Lindore, e më vonë edhe nga Shqipëria.¹²

Pas kryerjes së Medresesë së Ulët, nxënësit e kësaj shkolle vazhdonin mësimet e shkollës së mesme, ose inkuadroheshin në punë në organizatat e fesë islame apo gjetiu. Ata që dëshironin të vazhdonin shkollimin, duhej të shkonin në Sarajevë, në Medresenë e GHB (Gazi Husrev Beut). Një numër tjetër vazhdonin nëpër shkolla të tjera të mesme, si në gjimnaz, shkollë normale, shkollë ekonomike etj..¹³

Në fillimet e saj, u mësuan këto lëndë: *Kuran, gjuhë shqipe, matematikë, akaid, fikh, ahlak, histori islame, gjeografi, botanikë, vizatim, bukurshkrim, gramatikë arabe, edukatë fizike, gjuhë serbe, imammat, fizike, kurse me kalimin e kohës u bënë ndryshime dhe reforma në plan-programin e medresesë, sidomos pasi që ajo u bë nga e ulët në të mesme. Kështu që u shtuan edhe lëndët: tefsir, hadith, pedagogji, husnihat, retorikë etj..¹⁴*

MEDRESEJA E MESME “ALAUDDIN” NË PRISHTINË

Në vitin shkollor 1962-63, medreseja e mesme “Alauddin” në Prishtinë hapi dyert e saj në kohëzgjatje prej pesë vitesh. Ajo u hap në bazë të Aktit nr. 759-65 të Kryesisë Supreme Islame për RSF të Jugosllavisë në Sarajevë. Me qëllim reforme, e për të ndjekur dinamikën e zhvillimeve shoqërore, Kryesia e Bashkësisë Islame në Prishtinë, më 1983 mori vendim që medreseja të bëhet shkollë e mesme katërvjeçare.¹⁵ Nga viti 1961 e deri më 1983, mësimi në Medrese ka zgjatur pesë vjet, kurse nga viti 1983 do të ulet në katër vjet shkollor.¹⁶



Pas një angazhimi të vazhdueshëm dhe një punë intensive afro gjashtëvjeçare të Bashkësisë Islame të Kosovës ndërtohet objekti i ri i Medresesë, përrurimi solemni i të cilit u bë me 14 shtator 1985.

Në vitin 1993, sipas kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame në Prizren, Kryesia e Bashkësisë Islame vendosi që kjo medrese të hapte paralelen e saj në Prizren dhe një vit më vonë edhe në Gjilan. Kurse, në vitin shkollor 1997-1998 në kuadër të Medresesë “Alauddin” u hapën edhe dy paralele për femra, njëra në Prishtinë, ku u pranuan 38 nxënës, dhe tjetra në Prizren, ku u pranuan 25 nxënës. Në vitin shkollor -2018 2019 hapet paralelja e vajzave edhe në Gjilan ku regjistrohen 27 nxënës.¹⁷

Ministria e Arsimit, në vitin shkollor 2013-2014, merr vendimin që shkollave të mesme në Republikën e Kosovës t’iu ndërrohet statuti nga 4 vjeçare në 3 vjeçare. Ajo që vlen të theksohet është se medreseja, që nga paslufta, në kuadër të Ministrisë llogaritej si Gjinnaz i Përgjithshëm.

Kurrikula e shkollës sa vjen dhe bëhet më tërheqëse, cilësore dhe bashkëkohore, pasi që në këtë shkollë mësohen, veç lëndëve fetare, edhe shkencat ekzakte dhe shkencat e tjera. Mësimi i gjuhëve të huaja ka një rëndësi të veçantë në Medresenë “Alauddin”, andaj mësohen tri gjuhë të huaja, angleze, arabe dhe turke.¹⁸

Disa nga drejtorët e medresesë “Alauddin” ishin: Ahmet Mustafa, Bajram Agani, Muharrem Adili, Shemsi Salihu, Rashit Osmani, Sherif Ahmeti, Resul Rexhepi, Naim Tërnavë, Ekrem Simnica, Bahri Simnica, Jakup Çunaku, Fadil Hasani (drejtori aktual).

- 1 Nexhat Ibrahim, *Fjalor enciklopedik islam*, Logos-A, Boto: Fjala, Shkup, 2017, f. 532.
- 2 Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë 1830-1912*, Instituti albanologjik, Prishtinë, 2019, f. 231-233.
- 3 Nexhat Ibrahim, *op. cit.*, f. 532.
- 4 Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, *Medreseja “Alauddin” e Prishtinës (Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor)*, Prishtinë, 2018, f. 5.
- 5 Ibid., f. 14-15.
- 6 Ramadan Shkodra, “Zhvillimi i institucioneve edukative-arsimore islame në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore”, *Edukata Islame*, Nr. 127-128, Prishtinë, 2022, f. 117.
- 7 Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Kutia nr. 22. Raport për punën e Kryesisë supreme për RPS në Prishtinë për periudhën nga themelimi i saj, 16 korrik deri më 23 maj 1951.
- 8 Ramadan Shkodra, *op. cit.*, f. 117.
- 9 Nexhat Ibrahim, *op. cit.*, f. 532-533.
- 10 Xhamia “Alaudin” (Emir Alaedin) u ndërtua në gjysmën e parë të shekullit XVI. Kjo xhami gjendet pranë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës në një nga lagjet më të vjetra të Prishtinës, lagjen ‘Vellusha’. Kjo lagje dikur emërtohej në bazë të emrit të xhamisë, si lagja “Alaudin”. Për shkak të vjetërsisë së ndërtimit të saj, xhamia “Alaudin” ndër vite është restauruar disa herë. Për herë të parë u rinovua në vitin 1987, e më pas në vitin 1997. Ndërsa pas luftës së fundit është restauruar dhe ngjyrosur nga jashtë si dhe është ngjyrosur ambienti brenda xhamisë. Pas restaurimit katër vjeçar të nisur në vitin 2020, kjo xhami u rifunksionalizua për besimtarët e saj para muajit Ramazan të këtij viti (1444). Informacionet e marra nga fb., profili i BIK-ut me datë 07.03.2024.
- 11 Nexhat Ibrahim, *op. cit.*, f. 532-533.
- 12 Ramadan Shkodra, “Zhvillimi i institucioneve edukative-arsimore islame në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore”, *Edukata Islame*, Nr. 127-128, Prishtinë, 2022, f. 122-125.
- 13 Nexhat Ibrahim, *op. cit.*, 2017, f. 532-533.
- 14 Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, *op. cit.*, f. 188.
- 15 Nexhat Ibrahim, *op. cit.*, f. 532-533.
- 16 Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, *op. cit.*, f. 188-189.
- 17 Nexhat Ibrahim, *op. cit.*, f. 532-533.
- 18 Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, *op. cit.*, f. 29.

Dokumentet arabe në arkivat shqiptare

Mr. Vehbi Shatri

Dokumentet janë shkresa zyrtare, burim i mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe provë e identitetit të tyre. Asnjë popull nuk mund të konsiderohet zotërues i territorit të vet derisa dokumentet e tij publike së pari të mos grumbullohen, mbrohen dhe të jenë të qasshme për hulumtuesit, të studiohen në mënyrë sistematike, dhe më pas, të vlerësohet vlera e përmbajtjes së tyre.¹ Ndërsa dorëshkrimi është çdo vepër e pa publikuar – e pa botuar.

Prej detyrave parësore të arkivit është mbrojtja e këtyre dokumenteve – dorëshkrimeve dhe përpunimi i tyre duke i përgatitur dhe duke i bërë sa më të lehtë për hulumtuesit dhe shkencëtarët që merren me këtë lëmi.

DOKUMENTET ARABE NË ARKIVAT SHQIPTARE

Me ardhjen e osmanlinjve në trojet shqiptare, ndodhën ndryshime rrënjësore në jetën politike, ekonomike dhe kulturore për popullatën tonë. Në fillim të depërtimit të tyre, osmanët u vendosen në vende të ndryshme e në mënyrë të veçantë në disa qendra të mëdha ku ishin vendosur kazermat e ushtrisë dhe administrata osmane. Rreth këtyre qendrave u formua një jetë e re, në veçanti në aspektin fetar dhe kulturor. Kjo kishte ndikuar në themelimin e institucioneve

fetare, kulturore dhe sociale si të xhamive, teqeve, shkollave fillore, të cilat në atë kohë i quanin “Mektebe” (Mejtepe),² po ashtu disa prej tyre i quanin “Medrese”, në të cilat kujdes i madh i kushtohej gjuhës arabe.³

Nga dokumentet e ndryshme, sidomos nga vakëfnamet,⁴ shohim që themelimi i medreseve kishte filluar qysh herët. Mund të themi që pjesa më e madhe e bamirësve, përveç xhamive, ndërtonin edhe medrese dhe shkolla fillore të ndryshme së bashku me dhomat e fjetjes për nxënës. Padyshim, medreseja e Is'hak Begut në Shkup, vakëfi i të cilit u legalizua në vitin 1444, është një ndër të parët, ndërsa më vonë, në vitin 1468, u legalizua vakëfi i Isa Begut dhe u themelua medreseja e madhe – njëra ndër më të mëdhatë në trevat tona.⁵

Pranë këtyre institucioneve fetare dhe sociale u themeluan po ashtu edhe biblioteka ku pjesa më e madhe e të cilave përbëhej prej dorëshkrimeve arabe. Bibliotekat e kësaj periudhe ishin të tri llojeve:

BIBLIOTEKAT PRIVATE (PERSONALE);

Bibliotekat e xhamive, mesxhideve dhe teqeve, gjë që është traditë edhe sot që këto institucione të kenë biblioteka, pa marrë parasysh kushtet dhe hapësirën;



Bibliotekat e shkollave, në realitet ky ishte lloji më i rëndësishëm i bibliotekave, sepse në njëfarë mënyre ato ishin biblioteka publike, se qytetarët kishin mundësi t'i huazonin librat, t'i lexonin apo t'i përshkruanin ato.

Bibliotekat private i themeluan disa dijetarë, personalitete të rëndësishme si dhe dashamirët e librit, të cilët kishin mundësi për blerjen e librave. Është e njohur se librat ishin shumë të shtrenjta, sepse ato shkruheshin me dorë dhe jo në shtypshkronjat moderne siç kemi ne sot, po ashtu edhe ilustrheshin me ilustrime të ndryshme. Nuk ishin të rralla rastet kur librat liheshin vakëf-testament para vdekjes së pronarëve të tyre, apo ata ua linin trashëgimtarëve të tyre pas vdekjes, të cilët më pas i linin në shkolla (medrese), bibliotekat e të cilëve ishin rritur në këtë mënyrë dhe ishte rritur numri i librave në to.⁶

Duke pasur parasysh se në këto medrese dhe mektebe, që ishin të themeluara sipas shembullit turk dhe arab, mësoheshin disa lëndë dhe ato kryesisht me përmbajtje fetare, si: Tefsir, komentimi i Kuranit, ilmu-l-hadith, shkenca e hadithit, akaid, parimet bazë të fesë, fikh, jurisprudencë islame, usulu-l-fikh, burimet e së drejtës së sheriatit, faraiz, e drejta e trashëgimisë sipas të drejtës islame, Sarf dhe Nahv, gramatika dhe sintaksa e gjuhës arabe etj.. Përveç gramatikës dhe sintaksës janë mësuar edhe ilmu-l-luga, leksikografia, ilmu-l-belaga, retorika, dhe ilmu-l-arūd, metrika.

Kanë ekzistuar edhe aso shkolla ku mësohej vetëm një disiplinë, si për shembull: tradita dhe të lexuarit e drejtë të Kuranit dhe mësimi i tij përmendësh i cili quhej Ilmu-l-kira'a, shkenca e të lexuarit. Këto shkolla janë quajtur "Dāru-l-hadīth" dhe "Dāru-l-kurra"⁷.

Arabishtja si gjuhë e kulturës dhe qytetërimit islam, te ne ka ardhur me ardhjen e fesë islame, apo thënë më konkretisht, në kohën kur filloi përhapja e Islamit në trojet tona.

Nga dokumentet e ndryshme, e sidomos nga vakëfnamet, vërejmë se hapja e shkollave kishte filluar herët. Një pjesë e madhe e bamirësve të asaj kohe, kontribut japin në ndërtimin e xhamive, medreseve, si dhe bujtinave për mësues dhe talebe.

Medreseja e Is'hak Begut në Shkup, vakëfi i së cilës u legalizua në vitin 1444, është një ndër të parat, ndërsa më vonë legalizohet edhe vakëfi i Isa Begut ku themelohet

Dorëshkrimet e gjuhës përfaqësohen kryesisht nga këto materiale, punime për mësimin e të shkruarit, fjalor persisht, shtypur me shtypshkronjë guri dhe zbukuruar me vijëzime dhe korniza në Stamboll, sintaksa e gjuhës arabe, libra për mësimin e gjuhës, rregulla gramatike persisht, fjalor frëngjisht-osmanisht, metoda për të mësuar persishten, teknika mbi të shkruarit të poezisë në osmanisht

Medreseja e Madhe në vitin 1468.⁸ Nga vakaflënësit mund të përmendim Isa Begu në Shkup, Ishak Çelebiu nga Manastiri lë vakëf në vitin 1508. Mehmed Pash Kaçaniku, i cili kishte ndërtuar medrese. Suzi Çelebiu nga Prizreni e la vakëfin e vet në vitin 1513, përveç shumë vakëfeve kishte lënë vakëf edhe Medresenë, Koxha Sinan Pasha, etj..

Pranë të gjitha medreseve që ekzistonin kishte edhe mektebe, libra të lëna vakëf, dhe kjo na tregon se sa kujdes i është kushtuar gjuhës arabe dhe lëndëve në këtë gjuhë. Librat bazë ishin në gjuhën arabe.

Pakëz nga letërsia e asaj periudhe na tregojnë dorëshkrimet e një poezie me titull "Bostan" në gjuhën osmane, pastaj historia e Lejlës dhe Mexhnunit (1272), një histori dashurie e cila ka bujën në Lindje si Romeo dhe Zhuljeta në Perëndim. Një fletore me vjersha në osmanishte, një poezi e cila flet mbi gjendjen e njerëzve nga koha e Kanni Sulltanit në gjuhën arabe dhe osmane, shpjegime tregimesh në osmanishte, prozë në arabisht plotësojnë mozaikun e letërsisë të shkruar në gjuhët lindore. Në një periudhë më të vonë kemi dorëshkrime të bejtexhinjve, si më i famshmi përmendet Nezim Frakulla, në një vepër me përmbledhje vjershash e divan, shkruar në gjuhët turke e perse dhe të zbukuruar me ar.

Dorëshkrimet e gjuhës përfaqësohen kryesisht nga këto materiale, punime për mësimin e të shkruarit, fjalor persisht, shtypur me shtypshkronjë guri dhe zbukuruar me vijëzime dhe korniza në Stamboll, sintaksa e gjuhës arabe, libra për mësimin e gjuhës, rregulla gramatike persisht, fjalor frëngjisht-osmanisht, metoda për të mësuar persishten, teknika mbi të shkruarit të poezisë në osmanishte.⁹

Për sa i përket mënyrës sesi konceptohej fati, flasin dorëshkrimet e horoskopit arab, njohuritë mbi astrologjinë apo libra mbi shpjegimin e ëndrrave në osmanishte.

Dorëshkrimet mbi shëndetin pasqyrojnë njohuritë e dijeve mbi mjekësinë dhe përgatitjen e ilaçeve, të dhëna mbi shëndetin e njeriut, fletore me receta ilaçesh, dije mbi gjenetikën në gjuhën arabe etj.. Veprat dorëshkrime me përmbajtje fetare i gjejmë si: Kuran, komentim i Kuranit, etikë islame, jurisprudencë islame, si dhe vepra të ndryshme

Dorëshkrimet mbi shëndetin pasqyrojnë njohuritë e dijeve mbi mjekësinë dhe përgatitjen e ilaçeve, të dhëna mbi shëndetin e njeriut, fletore me receta ilaçesh, dije mbi gjenetikën në gjuhën arabe etj..

me karakter fetar, të cilat janë punuar me përkushtim të veçantë.¹⁰ Dorëshkrim të kohës gjejmë edhe në komunën e Istogut. Dorëshkrim nga fletorja e hytbeve të myderrizit Ramadan ef. Shatri.¹¹ Dorëshkrim në gjuhën arabe, e në disa vende, gjejmë komentim të shkurtër në gjuhën osmane.

ROLI DHE RËNDËSIA E TYRE PËR SHQIPTARËT

Sot këto vepra kryesisht kanë rëndësi të madhe në pikëpamjen historike sesa në atë fetare. Studimi i periudhave gjatë administrimit të Perandorisë Osmane në trojet tona, në përgjithësi i është kushtuar një studim i historikut politik, por kështu janë lënë anash

dokumentet dhe dorëshkrimet e rëndësishme që ndriçojnë çështje të ndryshme kulturore, historike, fetare, letrare e filologjike, të cilat janë më rëndësi të madhe për kombin tonë.

Në arkivat tona, gjejmë dokumente të shumta që kanë të bëjnë për çështje dhe fusha të ndryshme, ndoshta më e dashura për neve do të ishte të përmendim dokumentet me shkrim arab, kuptimi në pjesën dërmuese në gjuhën osmane, të cilat, në Kosovë i gjejmë të hulumtuara nga profesori Iljaz Rexha.¹² Dokumente të shqipëruara dhe komentuar nga Iljaz Rexha, janë të rëndësishme për historinë e kombit tonë lidhur me ngjarjen e Lidhjes së Prizrenit. Siç e cek dhe hulumtuesi profesor Rexha: “Pasi materialet burimore osmane, që kanë të bëjnë me periudhën e Lidhjes së Prizrenit janë të shumta, ato dokumente këtu u radhitën vetëm disa prej tyre që janë më të rëndësishme për këtë ngjarje, të hartuara prej organeve të pushtetit osman si dhe nga organet dhe udhëheqësit e Lidhjes së Prizrenit.”¹³

Periudha osmane në trojet tona ka trashëguar një sërë dorëshkrimesh në gjuhën perse, arabe dhe osmane. Këto dorëshkrime janë konsideruar të rëndësishme jo vetëm për anën historike që mbartin, por edhe për vlerën artistike e shprehur në kaligrafi dhe zbukurimet e ndryshme që e shoqërojnë.

Po ashtu në këto materiale mund të gjejmë libra të shkruar me dy kaligrafë apo hadithe (thënie profetike), me zbukurime me ar, Kuran me kapakë prej ari apo lëkurë të veçantë. Dorëshkrime të tilla prej ari kryesisht gjenden në librat e fesë



islame dhe të sektit bektashian apo dorëshkrime që kanë të bëjnë me institucionin e sulltanit.

Në një vështrim të përgjithshëm mund të themi që dorëshkrimet në gjuhët orientale kanë përmbajtje fetare, juridike, gjuhësore e letrare, kulturore etj., në mënyrë specifike, secila prej tyre pasqyron disa aspekte të rëndësishme të jetës. (vazhdon)

- 1 Jusuf Osmani Gazmend Berisha, *Mbrojtja dhe ruajtja e lëndës arkivore*, (Prishtinë: Shkrola, 2007), 19.
- 2 Mehmeti Sadik, (Dorëshkrime orientale në Arkivin e Kosovës), *Edukata Islame*, Viti XXXIII nr.73.
- 3 Hasan Kaleshi, *Dokumente më të vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Jugosllavi*, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, 2012), 28.
- 4 Ekrem Murtezai, *Fjalor i terminologjisë fetare*, Vakf-i (ar. Shumësi vakuf) – “pengoj”, “mbaj” etj.; institucioni dhe fondi mysliman për qëllime bamirësie, i cili krijohet kryesisht në bazë të dhuratave dhe kontributeve vullnetare të myslimanëve, (Prishtinë, 2007), 649-650.
- 5 Hasan Kaleshi, *Dokumente më të vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Jugosllavi*, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës 2012), 29.
- 6 Mehmeti Sadik, (Dorëshkrime orientale në Arkivin e Kosovës), *Edukata Islame*, Viti XXXIII nr.73.
- 7 Hasan Kaleshi, *Dokumente më të vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Jugosllavi*, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës 2012), 30.
- 8 Hasan Kaleshi, *Dokumente më të vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Jugosllavi*, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës 2012), 30.
- 9 Po aty.
- 10 Mehmeti Sadik, (Dorëshkrime orientale në Arkivin e Kosovës), *Edukata Islame*, Viti XXXIII nr.73.
- 11 Vehbi Shatri, *Ramadan ef. Shatri*, (Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës), 43.
- 12 Arkivi i Kosovës. *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane*. (Prishtinë 1978).
- 13 Arkivi i Kosovës. *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane*. (Prishtinë 1978) 9 Faksimili dokumenti nr. 15, nga dokumentet e Lidhjes së Prizrenit.

Historia mbi 100-vjeçare e takimit emocionues ndërmjet babit dhe të birit në haxh

Agron Canolli

Dashuria, vullneti dhe sakrifica për të kryer obligimin e haxhit nuk ka munguar te familja Ymeri, ashtu sikurse edhe te shumë familje të tjera nga Kosova, të cilët pavarësisht rrethanave u janë përgjigjur Krijuesit me kryerjen e këtij obligimi dhe po vazhdojnë t'i përgjigjen edhe sot.

Më shumë se 100 vjet më parë, një histori tejet emocionuese kishte ndodhur ndërmjet një babai dhe të birit nga Kosova teksa po kryenin haxhin. Në një ngjarje krejt e pazakontë dhe e rastësishme, babë e bir ishin takuar teksa po kryenin haxhin – njërin prej 5 kushteve të Islamit. Ky është vetëm fillimi i historisë së familjes Ymeri nga Kosova, lagjja e së cilëve njihet me emrin “haxhiovitë”, pikërisht për shkak të kësaj historie – takimit të papritur ndërmjet babës dhe të birit në haxh.

Në viti e largët 1911, Ymer Ymeri, kishte nisur rrugëtimin e tij nga “Vllasalitë” e Novobërdës për të kryer haxhin. Rrugëtimi i tij disa mujorë, ishte shpërblyer në disa mënyra. Ai përveç se kishte arritur të kryente haxhin, ai aty kishte takuar edhe djalin e tij, Shabanin, që nuk e shihte prej më shumë se 5 vjetëve për shkak se ishte ushtar në Jemenin e largët.

Pasardhësi i kësaj familje, Bajrush Ymeri, rrëfen për historinë e gjyshit dhe stërgjyshit të tij, histori kjo që ruhet brez pas brezi me krenari.


“Në bazë të asaj çfarë më ka treguar gjyshi im, Rasimi i ndjerë, në vitin 1911, stërgjyshi im Ymeri, është nis për në haxh. Tani rruga të cilën ai e ka bërë për haxh në atë kohë nuk dihet si kanë shku, sepse është nis me kali nga këtu dhe sa ka zgjatë nuk e dimë saktë, sigurisht ka zgjatë shumë. Sigurisht, diku tre apo katër muaj. Në të njëjtën kohë, kur Ymeri është nis për haxh, djali i tij ka qenë ushtar i mbretit në Jemen, a ka shku dikun 1905 apo 1906, nja 5 vite ka qenë ushtar në Jemen.”

“Në kohën sa ka shku në haxh edhe historianët tregojnë që Perandoria Osmane ka humbë fuqinë. Ka dashtë me i lëshu ushtarët me shku në shtëpi, mirëpo janë kushtëzuar kushdo me shku i lirë te shtëpia, duhet me shku në haxh. Dhe ky ka shpreh dëshirë. Shabani, djali i Ymeri ka shpreh dëshirë me shku në haxh dhe është shku në haxh. Në ndërkohë, gjatë ceremonisë së haxhit aty, Ymeri është sëmure sikurse që ka ndodhur me raste të tjera të ngjashme. Kur është sëmure, thuhet se një lajmëtar ka hip diku lartë dhe i ka lajmëru njerëzit, se dikush është sëmure prej vilajetit të Rumelisë, sepse ashtu është quajtur kjo pjesë atëherë”, rrëfen ai.

Me t'u lajmëruar për këtë rast, Shabani, arriti ta takoi babanë e tij krejt në çastet e fundit të kësaj jete, teksa asnjëri nuk po u besonin më syve.

“Thotë dikush se një person nga ajo pjesë është i sëmure rëndë dhe mos po e njej dikush. Natyrisht ky është lajmëruar, se këtë histori na e ka tregu neve, e ka tregu Shabani, ushtar që ka qenë në Jemen. Lajmërohet ky dhe afrohet, kur afrohet e sheh babën e vet, natyrisht në fillim vetëm i është duk sikur i është parafytyrohet baba i tij, sepse nuk ka mujt me besu që e gjeti aty, baba që se ka pa djalin që katër apo pesë vite. Emocionet shumë për më tepër në momentet e fund të jetës, fillojnë me qajtë të dytë”, rrëfen tutje pasardhësi i kësaj familje.

Biseda e tyre ishte tejet shkurt, kjo për shkak të gjendjes së rëndë që kishte Ymeri, megjithatë babai i jep disa prej shenjave të tij të birit që t'i kthej në Kosovë.



“Thotë se jam sëmure rëndë dhe du me vdek, dhe i jep shokën. Në shokë i ka kep lirat, qe i ka harxhu derisa ka mbërri në haxh dhe pjesën që ka mbet, ja jep shokën, qelibarin, kutinë dhe ndërron jetë. Pastaj, ai dëshiron me varros atje dhe ka tregu që filloi me gërmu për me ndërtua varrin, mirëpo vendi me zall ishte, varri u shembte dhe një kalimtar që ka qenë i asaj pjese i ndihmon. I thotë se mënyra siç po mendon me varros këtu nuk mundësh, por po të ndihmoj, e ka hapë një pjesë të varrit dhe është shtri afër tij, frynë era dhe e mbulon, sepse nuk mundesh këtu me ndërtu asi varri dhe kështu e ka varros”, thotë tutje Bajrush Ymeri.

Po aq sa emocionues që kishte qenë takimi Ymerit dhe Shabanit, babë e bir, po emocionuese është edhe kthimi i tij në shtëpi, me shenjat e babait që s’dinte askush asgjë për të.

“Pastaj e fillon procesin e kthimit nga haxhi te shtëpitë, ku kemi qenë atëherë te Vllasalitë. Kur vjen këtu te familjarët e tij, gëzohen këtu shumë, sepse ai kishte shkuar në luftë dhe nuk e dinin se a do kthehej gjallë apo jo. I pyet pastaj, se ku është baba. Ata i thonë se baba i ka gjashtë muaj e më tepër që është nis për me shku në haxh, por s’kemi informacione tjera për to. Fillon të qaj, emocionohet dhe ju tregon se babën e kishte gjet në haxh, sepse mbreti na kishte dërgu dhe e kam gjet të gjallë pak dhe në duar të tij kishte vdek dhe se e kishte varrosur. Ja edhe shenjat e tij, shokën, qelibarin që e ka përdorë me pi duhan me të. Atë qelibar është tek anëtarët tonë të familjes, që u ka taku atyre, që është si shenjë që ende e mbajmë që nga atëherë e deri sot”, thotë tutje ai.

Për Ymerin që u nis nga Kosova për të kryer haxhin në vitin 1911 nuk ishte e lehtë aspak rruga e largët për në vendet e shenjta, por as vendimi për t’u nisur.

“Siç e ka tregu gjyshi im se në atë kohë i ka tregu, baba i vet kur është kthi prej haxhit që ka qenë ushtar në Jemen. Ai i ka tregu gjyshit tim, Rasimit dhe djemve të tjerë që pastaj e kemi

dëgju edhe ne në vazhdimësi këtë histori të familjes tonë. Vendimi për me u nis për haxh në 1911, natyrisht s’ka qenë vendim i lehtë për shkak se mënyra e shkuarjes nga këtu deri në haxh, ka qenë këtu me mënyra primitive. Por, valutë tjetër s’ka pas, kanë qenë lirat që u dasht me i harxhu gjatë rrugës që e ka bërë, meqenëse s’ka pas ku me i vendosë, ai e ka përgatit vetën prej shtëpisë. I ka përgatit si gjepa në shok, atëherë janë quajt fallaka dhe aty i ka fut lirat. Në këtë mënyrë e ka bërë rrugën nga këtu deri në haxh. Sa ka zgjatë nuk dihet, por sigurisht se ka zgjatë shumë”, thotë ai.

Bajrush Ymeri, thotë se për këtë familje, kjo ngjarje ka rëndësi të veçantë dhe i bënë krenarë ata. Ndonëse në vete kjo histori ka kuptime të shumëfishta.

“Kujtdo që i tregojmë i doket interesant dhe është interesante, ne e trashëgojmë mbiemrin pikërisht nga ai, Ymeri jonë i parë që ka ndrru jetë në haxh dhe që e ka marrë atë rrugë në atë kohë, sepse sipas asaj që unë kam dëgjuar unë janë diku njerëzit e parë që kanë shkuar haxh. Natyrisht, neve na bënë krenarë me këtë histori që është e veçantë që nuk i ka ndodhë ndoshta askujt, kjo ka qenë rastësi që djali me qëllu ushtar i mbretit në Jemen që sa herë këndohet kjo kënga, “vinë vaporet” mua më parafytyrohet ajo fytyra e babagjyshit tonë të ndjerë që ka qenë ushtar i mbretit, sepse ajo këngë ju kushtohet atyre që kanë shkuar nga Kosova për të luftuar në Kosovë. Krejt kjo histori ka qenë fat i tij, të shkoj në luftë me katër apo pesë vite më tepër, të shpëtojë nga lufta, të shkoj në haxh, të takoj babanë e tij aty, të kthehet përsëri në vendlindje”, thotë ai.

Dashuria, vullneti dhe sakrifica për të kryer obligimin e haxhit nuk ka munguar te familja Ymeri, ashtu sikurse edhe te shumë familje të tjera nga Kosova, të cilët pavarësisht rrethanave u janë përgjigjur Krijuesit me kryerjen e këtij obligimi dhe po vazhdojnë t’i përgjigjen edhe sot.

Udhëtimin që nuk e përshkruajnë dot fjalët

Bajram Zeqiri

Fjalët janë të mangëta, e nuk arrijnë dot t'i përshkruajnë, por edhe lapsat nuk kanë ngjyrë të mjaftueshme për të bërë një përshkrim të denjë të madhështisë së rrugëtimit jetësor të myslimanit – haxhit.

Bashkësia Islame e Kosovës, ashtu sikurse edhe herëve të tjera, edhe këtë vit, me kohë kishte filluar përgatitjet për organizimin e haxhit. Më 6 maj 2024, Drejtoria e Haxhit në Kryesinë e BIK-ut, ftoi në një takim të gjithë udhëheqësit e Këshillave të BI-së anekënd Kosovës, në mënyrë që t'i njoftonte me të gjitha informacionet e nevojshme rreth këtij udhëtimi.

Para se të niseshin dhe të merrnin rrugën drejt Mekës, në të gjithë Këshillat e BI-së, u organizua Duaja e Haxhit, e cila mblodhi rreth vetes haxhilerët e ardhshëm. Përveç tyre, aty prezantuan edhe familjarë të shumtë, të cilët me mallëngjim e lutje, kërkonin e uronin udhëtim të mbarë e haxh të pranuar.

Atyre që tashmë kishin regjistruar emrat e tyre në regjistrat e udhëtimit, sikur ju kishte ngelur ora në një vend dhe nuk po ecte fare.

Emocioneve për fillimin e rrugëtimit iu erdh fundi... Të dielën, më 2 qershor, Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" në Prishtinë, gumëzhinte nga qindra njerëz, të cilët, të veshur me ihramin e bardhë, ishin bërë gati për të nisur udhëtimin jetësor të tyre. Në grupin e parë udhëtuan 215 besimtarë, të cilët pasdite arritën në Xhide. Ata u pritën nga udhëheqësit e Drejtorisë së



Haxhit, të cilët menjëherë i nisën drejt Mekës, për t'i akomoduar në hotel. Rruga drejt Mekës vazhdimisht përshkohej me telbije, me të cilën i përgjigjeshin urdhrin të Zotit për kryerjen e haxhit. Pasditen e së dielës dhe gjatë ditës së hënë, udhëtuan edhe grupet e tjera drejt Mekës, për ta plotësuar kështu numrin prej 1576 besimtarëve, që këtë vit morën rrugën për kryerjen e haxhit.

Besimtarët tanë posa akomodoheshin në hotel, të udhëhequr nga udhëheqësit e tyre, niseshin drejt Qabesë për kryerjen e umres së haxhit temet-tu'. Gjuha nuk e thoshte atë që e ndiente zemra përballë Qabesë. Emocionet e besimtarëve për takimin e parë me Qabenë nuk i përshkruante asnjë fjalë. Ajo, Qabeja, vezullonte me shkëlqimin e saj, i magjepste të gjithë me bukurinë e saj... Udhëheqësit e haxhilerëve kujdeseshin që kohë pas kohe t'u

shpjegonin diç nga historiku i saj, por edhe për duatë dhe lutjet që duhej të bëheshin gjatë tavafit. Pas përfundimit të tavafit, koha ishte për faljen e dy rekateve namaz pas Mekami Ibrahimit, e për të vazhduar më pas me sajën, ecjen ndërmjet kodrave Safa dhe Merve. Gjatë kësaj ecje, përveç duave, me mall kujtohej edhe Haxherja, gruaja e Ibrahimit a.s., sakrifica e saj për të gjetur një pikë ujë për djalëin e saj, Ismailin. E kur përfundoi ecja e shtatë, edhe besimtarët tanë u çlodhën duke pirë ujë zemzemi, e më pas qethën flokët dhe u liruan nga ihrami.

Gjatë qëndrimit në Meke, haxhilerët tanë kishin mundësi të dëgjonin nga një ligjëratë të shkurtër me tematikë rreth haxhit, pas namazit të drekës, në xhaminë e hotelit, e cila mbahej nga hoxhallarët tanë. Përveç ligjëratave për haxhilerë, mualimet e Departamentit të Gruas së BIK-ut, ishin tejet aktive në

mbajtjen e ligjëratave për gra. Ato, përveç ligjëratave të rregullta me tematika të haxhit, organizuan edhe mukabele-lexim Kurani.

Me qëllim të mbarëvajtjes dhe ecurisë sa më të mirë të ditës së Arafatit, udhëheqësit e Haxhit nga të gjithë Këshillat e Bashkësisë Islame të Kosovës, më 10 qershor 2024, mbajtën një takim përgatitës në rrafshnaltën e Arafatit, më konkretisht në vendin ku do të qëndronin besimtarët tanë nga Kosova.

Ata, u njohën për së afërmi me vendin se ku do të qëndrojnë ata në ditën e Arafatit, si do të veprohet me haxhilerët e sëmurë, si dhe rreth organizimit të programit fetar në Arafat.

Takim si ky i tilli, u mbajt edhe njëherë në hotelin në Meke, por që këtë herë u diskutua më në përgjithësi për procedurat dhe ritualet e haxhit, ku udhëheqësit e këshillave lokale u njohën me kohën se kur do të dalin në Arafat, qëndrimin aty, shkuarjen në Muzdelife e në Mina, gjuajtjen e gurëve, si dhe me procedura të tjera të nevojshme.

Qabeja pa dyshim mbetet vendi që zemra e shpirti e do për ta parë e për ta vizituar, por, përveç saj, nga haxhilerët tanë nuk u lanë pa u vizituar edhe vendet historike të Mekës. Ata, në grupe të organizuar vizituan shpellën Hira, aty ku zbritën ajetet e para nga Kurani fisnik dhe shpellën Theur, aty ku i Dërguari ynë, Muhamedi a.s., së bashku me Ebu Bekrin r.a., qëndruan të fshehur gjatë hixhretit të tyre nga Meka për në Medine. Historiku i këtyre dy shpellave ngjalli kërshëri te besimtarët tanë.

Pa dyshim se në jetë, gjërat që do të ndodhin janë të caktuara që moti nga Zoti, Krijuesi i Gjithësisë. E tillë ishte edhe vdekja e haxhi Muharrem Gashit nga Kosova, i cili ndërroi jetë më 13 qershor në Meke. Namazi i xhenazes së rahmetliut u fal në Qabenë e bekuar me namaz të jacisë, ndërsa varrimi i tij u bëhet në varrezat e Mekës, nën përcjellje edhe të udhëheqësve të Haxhit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës. Lusim Zotin që shpirtin e tij ta



ketë mëshiruar, ta ketë falur dhe ta ketë graduar me Xhenet!

Mbrëmjen e 14 qershorit, haxhilerët tanë, grupe-grupe, u nisën drejt Arafatit, aty ku më 15 qershor, ditë e shtunë, së bashku me miliona haxhilerë nga e mbarë bota do ta kryenin njërin prej obligimeve-farzeve themelore të haxhit. Gjithçka rreth qëndrimit aty ishte organizuar kohë më parë. Ashtu siç jemi porositur nga mësimet e Pejgamberit a.s., namazi i drekës dhe ai i ikindisë, u falën të bashkuar, me një ezan e dy ikamete. Pas kësaj, u mbajt edhe një ligjëratë e shkurtër kushtuar vlerës, rëndësisë dhe madhësisë së kësaj dite nga drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora.

“Lutja më e mirë është lutja që bëhet në ditën e Arafatit...” – kështu i kishte porositur shokët e tij Pejgamberi a.s., e kështu vepronin edhe haxhilerët tanë,

të cilët, të përgjëruar e me lot në sy kishin ngritur duart e po kërkonin falje nga Zoti i Madhëruar. Lutjet për falje të mëkateve, për ditë më të mira e për shëndet e begati gjenin vend në gojën e çdo haxhiu. Ditës që çdo haxhi nuk do të donte t’ia shihte fundin përfundoi. Perëndimi i diellit i gjeti haxhilerët tanë të gatshëm për të nisur rrugëtimin e tyre drejt Muzdelifes, aty ku do ta kalonin natën në qiellin e hapur.

Me të arrirë aty, haxhilerët tanë falën namazin e akshamit dhe të jacisë të bashkuar, njësoj siç kishin vepruar në Arafat me drekën dhe ikindinë. Kushtet jo të përshtatshme për ta pushuar trupin në Muzdelife, i lanë vend shpirtit për të pushuar. Lutjet e duatë vazhdimisht i shoqëronin haxhilerët tanë. Mbledhja e guralecëve, me të cilët do të goditej simbolikisht shejtani i mallkuar ishte veprimi i radhës që bënë haxhilerët tanë në Muzdelife.





Ashtu tok të bashkuar, me tekbiere e telbije, haxhilerët tanë lanë Muzdelifen, për ta përshkruar rrugën për në Mina, e pastaj edhe në Xhemerate, aty ku në shenjë kujtimi të Ibrahimit a.s., do ta godisnin simbolikisht shejtanin e mallkuar me 7 gurët te Xhemreja e Madhe.

Të lodhur nga ky udhëtim, por të kënaqur që arritën t'i përfundonin shumicën e obligimeve të haxhit, haxhilerët tanë u kthyen në hotel, për të festuar Kurban Bajramin e për ta uruar njëri-tjetrin për haxh dhe ibadete të pranuar. Të organizuar në grupe, haxhilerët tanë në mbrëmje e kryen edhe tavafin e haxhit, si shtyllë e dytë e haxhit pas Arafatit, ndërsa të nesërmen dhe të pasnesërmen, prapë vazhduan me gjuajtjen e guralecëve me 21 gurë, nga 7 në secilën prej tri xhemerateve.

Pas këtij rituali, qëndrimin të haxhilerëve në Mekë iu erdhi fundi. Haxhilerët po e kryenin edhe tavafin lamtumirës – tavafin më mallëngjyes me Shtëpinë e Zotit.

Ata, më 20 qershor, u nisën drejt Medinës, aty ku Pejgamberi a.s., dha frymën e fundit. Pa dyshim se përshëndetja me Qabenë e bekuar ngjall emocione të pa përshkruara, por që shpresa dhe lutjet për haxh të pranuar, sikur lehtësonin ndarjen e haxhilerëve nga ajo. “Të themi mirupafshim, e jo lamtumirë!”

Mesnata u ndriçua nga disa çaste magjike, të cilat do t'i shoqërojnë haxhilerët tanë deri në fund të jetës. Të

përhumbur në ndjenja e emocione, u gjendën përballë prehjes së tij, Muhamedit a.s., dhe dy shokëve të tij besnikë, Ebu Bekrit r.a. dhe Omerit r.a.. E gjithë historia dhe madhështia e kësaj feje të bukur e të pastër me të cilën Allahu xh.sh. na ka bekuar qëndronte pak metra larg haxhilerëve. Mendimet, ndjenjat, emocionet që përjetuan haxhilerët tanë ishin të shumta. Në heshtje e me lot në sy, falënderonin me zemrën plot Krijuesin e Gjithësisë, që i përzgjedhi t'i jepnin selam e të çmalleshin me të Dërguarin a.s..

Teksa qëndronin ashtu të përhumbur në këmbë para tij dhe e përshëndetnin atë me selame, një lutje dilte krejt natyrshëm nga thellësia e shpirtit: “O Allah, më bëj mua pasues të denjë të shembullit të njeriut më të përkryer të njerëzimit dhe shokëve të tij të nderuar. O Allah, ma bëj të mundur shefatin e Tij në ditën e gjykimit e më ringjall si ymet i Tij!”

Më pas haxhilerët tanë falën edhe nga dy rekate namaz në Reuda (që është një zonë e caktuar në pjesën e parme të Xhamisë së Pejgamberit a.s. dhe që shtrihet midis shtëpisë dhe minberit të Pejgamberit a.s. Për këtë, Pejgamberi a.s. ka thënë: “(Pjesa) midis shtëpisë sime dhe minberit tim është një kopsht prej kopshteve të Xhenetit.”

Organizimi për vizitën e vendeve historike vazhdoi me vizitën në malin e Uhudit (kodrën e shigjetarëve) dhe varrezat e dëshmorëve, ku haxhilerët u njohën nga afër me historinë dhe domethënien e këtyre vendeve. Aty, në prehër të tij, në Uhud, u zhvillua beteja e dytë në historinë islame, e pak metra më tutje, prehen dhjetëra sahabë, trupat e të cilëve toka nuk i treti dhe që i Dërguari i Allahut i vizitonte shpesh. Më pas, haxhilerët tanë i pritën Xhamia Kuba, xhamia e parë e ndërtuar nga Muhamedi a.s. pas hixhretit, e për të cilën ai vetë a.s. tha: “Kush merr abdes në shtëpinë e tij, pastaj niset e vjen në xhaminë Kuba dhe fal aty dy rekate namaz, shpërblimi i tij do të jetë sikurse shpërblimi i kryerjes së umres.”

Edhe ditëve të qëndrimit në Medinën e ndritshme iu erdhi fundi, kështu që më 25 korrik, në Kosovë arriti edhe grupi i parë i haxhilerëve, të cilët do të pasoheshin edhe me arrijtjen e grupeve të tjera, më 26 dhe 27 qershor.

Lusim Zotin e Madhëruar që haxhilerëve t'ua ketë pranuar haxhin dhe të gjitha ibadetet që i kanë kryer!



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZËVENDËSMINISTRIN E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE TË TURQISË, Z. ADNAN ERTEM

Më 5 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim zëvendësministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Turqisë, z. Adnan Ertem.

Myftiu Tërnavë gjatë këtij takimi përmendi bashkëpunimin e mirë që kanë si institucion me DIJANET-in, Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve, TIKA-n dhe me organizata të tjera të Turqisë, duke i falënderuar kështu për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme që kanë dhënë. Ai shfrytëzoi rastin që të falënderojë z. Ertem për punën dhe angazhimin e tij të mëhershëm si drejtor i Përgjithshëm i Vakëfeve të Turqisë në restaurimin e xhamive të vjetra në Kosovë. Ai tha se Drejtoria e Vakëfeve e Turqisë ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në restaurimin e objekteve fetare me rëndësi në vendin tonë, dërgimin për



shërim të të sëmurëve në Turqi, si dhe dërgimin e pakove ushqimore për familjet nevojtare.

Nga ana e tij, zëvendësministri z. Ertem, fillimisht falënderoi Myftiun

Tërnavë për pritjen, e më pas ia rikonfirmoi edhe njëherë gatishmërinë për një bashkëpunim të mëtutjeshëm.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM Z. AREF ALMENHALI

Më 6 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin e Zyrës Rajonale të Gjysmëhënës së Kuqe të Emirateve të Bashkuara Arabe me qendër në Tiranë, z. Aref Almenhali.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit, e më pas e falënderoi atë dhe Gjysmëhënën e Kuqe për ndihmat e ofruar të vazhdueshme dhënë për institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai tha Gjysmëhëna e Kuqe ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm me ndihma si para, gjatë, ashtu edhe pas luftës në Kosovë, ndërsa me Bashkësinë Islame të Kosovës ka realizuar një sërë projektesh të përbashkëta. Myftiu Tërnavë tha se ne si institucion mbesim të përkushtuar që



të vazhdojmë një bashkëpunim të tillë edhe në të ardhmen.

Nga ana e tij, z. Almenhali, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për

gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar me Gjysmëhënën e Kuqe në çuarjen para të projekteve me interes për qytetarët e Kosovës.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË HANIT TË ELEZIT

Më 3 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, zhvilloi një vizitë në Këshillin e Bashkësisë Islame të Hanit të Elezit. Në këtë takim, Myftiu Tërnavë, takoi anëtarët dhe administratën e këtij Këshilli.

Myftiu Tërnavë, fillimisht përgëzoi anëtarët e Këshillit dhe nëpërmes tyre tërë imamët e këtij Këshilli për punën dhe angazhimin e tyre për mbarrëvajtjen e jetës fetare në vend. Ai kërkoi nga kryetari Vila, por edhe nga hoxhallarët e tjerë, që të shtojnë përkushtimin e tyre dhe të vazhdojnë edhe më tej të punojnë për të mirën e besimtarëve, ngase këtë e kemi amanet nga i Madhi Zot.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË KAÇANIKUT

Më 3 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Kaçanikut, në të cilin u prit nga kryetari i këtij Këshilli, Fidaime ef. Fazliu dhe nga anëtarët e Këshillit.

Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që t'i përgëzoi imamët dhe anëtarët e Këshillit për punën dhe kontributin e tyre që janë duke dhënë për mbarrëvajtjen e jetës fetare në Kaçanik. Ai premtoi përkrahjen e Kryesisë së BIK-ut për projektet dhe iniciativat që janë në dobi të besimtarëve. Myftiu Tërnavë gjithashtu shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton për ngritje të infrastrukturës së përgjithshme, gjithnjë për të plotësuar kërkesat dhe nevojat që kanë besimtarët myslimanë në Kosovë.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË FERIZAJT

Më 3 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Ferizajt, në të cilin u prit nga kryetari i këtij Këshilli, Nexhmedin ef. Bajrami, administrata dhe nga anëtarët e Këshillit.

Pas njohjes me gjendjen e përgjithshme të Këshillit nga kryetari Bajrami, Myftiu Tërnavë, shfrytëzoi rastin që të flasë për rolin dhe kontributin e rëndësishëm të imamëve dhe hoxhallarëve që duhet ta kenë në shoqëri. Ai kërkoi nga anëtarët e Këshillit dhe nëpërmes tyre nga gjithë imamët që të shtojnë angazhimin e tyre në shërbim të besimtarëve.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË KAMENICËS

Më 4 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Kamenicës, në të cilin u prit nga kryetari Ferid ef. Dermaku, administrata dhe anëtarët e Këshillit.

Kryetari Dermaku fillimisht e njohu Myftiun Tërnavë me punët dhe angazhimet e Këshillit, duke e falënderuar kështu atë dhe Kryesinë e BIK-ut për përkrahjen e vazhdueshme dhënë për Këshillin.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, përgëzoi kryetarin dhe nëpërmes tij gjithë imamët për punën dhe kontributin e tyre të rëndësishëm që janë duke dhënë për mbarrëvajtjen e jetës fetare.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË VITISË

Më 4 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Vitisë, në të cilin u prit nga kryetari Husamedin ef. Hoxha.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu Tërnavë, takoi edhe administratën dhe anëtarët e këtij Këshillit, me të cilët bashkëbisedoi për sfidat e ecurinë e punëve të imamëve dhe të nëpunësve të tjerë brenda Këshillit. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës mbetet e përkushtuar për ngritje të cilësisë së punës, për çka tha se do të ofrojë përkrahjen e nevojshme sa herë që kërkohet një gjë e tillë.

Nga ana e tij, kryetari Hoxha, falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën dhe për përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë për Këshillin e BI-së së Vitisë.

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË GJILANIT

Më 4 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, në vazhden e takimeve me administratën dhe anëtarët e Këshillave, vizitoi Këshillin e BI-së së Gjilanit, në të cilin u prit nga kryetari i Këshillit Naim ef. Aliu.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë, u interesua për gjendjen e përgjithshme të Këshillit, për të cilën u njoh nga kryetari Aliu.

Ai ofroi përkrahjen e plotë të Kryesisë së BIK-ut për projektet e Këshillit. Gjithashtu Myftiu Tërnavë porosi kryetarin Aliu dhe nëpërmes tij gjithë imamët që të shtojnë angazhimin e tyre për mirëqenien e besimtarëve tanë, ngase një gjë e tillë e kemi amanet nga i Madhi Zot.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI KËSHILLIN E BI-SË SË VUSHTRRISË

Më 5 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Këshillin e Bashkësisë Islame të Vushtrrisë, në të cilin u prit nga kryetari, Ejup ef. Haziri, administrata dhe anëtarët e Këshillit.

Gjatë këtij takimi u diskutua për punët, angazhimet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Këshilli i BI-së së Vushtrrisë. Kryetari Haziri e njohu Myftiun Tërnavë edhe me aktivitetet që zhvillon Këshilli nëpër xhamitë e Vushtrrisë. Myftiu Tërnavë tha se në si hoxhallarë duhet që edhe më tej të punojmë dhe të kontribuojmë në mbarëvajtjen e jetës fetare, ngase e kemi amanet, të cilin duhet ta çojmë në vend.



U MBAJT TRYEZË SHKENCORE KUSHTUAR SHQIPËRUESIT TË KURANIT, MUHARREM BLAKÇORIT

Më 6 qershor 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës organizoi Tryezë Shkencore kushtuar shqipëruessit të Kuranit dhe njëkohësisht njërit prej punëtorëve më të zellshëm të edukimit në frymën islame dhe atdheadashëse, Muharrem Blakçorit.

Në Tryezën e mbajtur në selinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, u çmua roli dhe kontributi i tij. Përkthimet nga Kurani, përgatitja e një fjalor shqip – arabisht dhe Ilmihallit, ishin vetëm disa prej veprave që u dalluan, përkundër periudhës së vështirë në të cilën jetoi Muharrem Blakçori.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, vlerësoi jashtëzakonisht dorëshkrimet e Muharrem Blakçorit, shkrime këto që sipas tij bëhen edhe më domethënëse për periudhën kohore kur ato janë shkruar.

Veç të tjerash, Muharrem Blakçori u vlerësua edhe nga Myftiu i Kavajës, Besnik ef. Leçini edhe në aspektin edukues, ku për vite me radhë,



Muharrem Blakçori edukoi të rinj të shumtë në frymën islame.

Gjatë kësaj tryeze shkencore, Muharrem Blakçori, u konsiderua një misionar i heshtur, që ishte tejet produktiv në rrethanat kohore.

Në anën tjetër, familjari i Muharrem Blakçorit, Xhevdet Blakçori, u shpreh tejet i lumtur që kompetentët e fushës po çmojnë veprën e familjarit të tij.

Gjatë kësaj Tryeze shkencore u bë pranim-dorëzimi i shkrimeve të Muharrem Blakçorit që solemnisht Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavës, ia dorëzoi nipi i tij, Xhevdet Blakçori.

Kjo Tryezë shkencore u nda në dy seanca me gjithsej 10 referues, të cilët nga këndvështrime të ndryshme vlerësuan jetën dhe kontributin e Muharrem Blakçorit.

URIMI I MYFTIUT TË KOSOVËS, NAIM EF. TËRNAVA, ME RASTIN E FESTËS SË KURBAN BAJRAMIT

Të nderuar vëllezër dhe motra,

Të dashur qytetarë!

Nesër është dita e Kurban Bajramit, ditë feste për besimtarët myslimanë në të gjithë botën. Edhe ne në Kosovën tonë i gëzohemi kësaj feste kaq madhështore, e cila shfaqet në shoqërinë e në familjet tona me gëzime e hare, e me një gjuhë falënderuese, duke u përhapur në mesin e të gjithë besimtarëve.

Sot, në ditën më të vlefshme të vitit, në këtë ditë të bekuar të Arafatit, më lejoni që në emër të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, në emër të institucioneve të saj dhe në emrin tim si Myfti i Republikës, t'ju uroj për këtë festë, e cila karakterizohet me kryerjen e haxhit dhe sakrificës së kurbanit, për t'ju afruar kështu edhe më afër mëshirës së pafund të Zotit xh.sh., njëherësh, të dashur qytetarë, ju uroj edhe Ditën e Çlirimit të vendit tonë për të cilën ditë u sakrifkuan breza të shumtë që Kosova të fitojë pavarësinë e saj.

Së bashku me miliona haxhilerë nga e mbarë bota, të cilët sot gjenden në Meken e shenjtë për ta kryer haxhin, janë edhe një numër i konsiderueshëm i vëllezërve dhe motrave tanë nga Kosova dhe vendet e tjera shqiptare, por edhe nga mërgata e largët, të cilët, bëjnë lutje për faljen e mëkateve dhe për begati nga Krijuesi Fuqiptotë.

Ata bëjnë lutje me dashurinë ndaj atdheut, e cila buron nga besimi i drejtë dhe sinqeriteti i thellë, luten për sigurinë e atdheut, me lutjen që bëri Ibrahim i a.s., për Meken e bekuar:

“Dhe kur Ibrahim tha: “O Zoti im! Bëje këtë qytet të sigurt dhe (qytet të paqes)...” (El Bekare, 126).

Të dashur qytetarë,

Festat tona fetare duhet të shfrytëzohen për të sjellë lumturi dhe gëzim në zemrat e atyre që kanë nevojë, duke trajtuar të sëmurët e vizituar të afërmit, duke shkëmbyer urime me miqtë dhe duke i mbjellë këto vlera në mendjet dhe zemrat e fëmijëve dhe të rinjve tanë. Vetëm kështu forcojmë edhe më shumë trungun tonë familjar, e ushqejmë atë me vlerat fetare dhe kombëtare, dhe e ruajmë atë me një pastërti fisnike, ashtu siç e kemi amanet nga të parët tanë.

Andaj, me këtë rast, lus Zotin e Madhëruar që të na mbulojë me paqen, bekimin dhe mëshirën e kësaj dite të bekuar! T'i falë vendit tonë dhe mbarë botës mirësi, begati, siguri dhe stabilitet, e në veçanti të lutemi o Zot që paqja të rikthehet edhe në Palestinë dhe Ukrainë!



Ne si qytetarë të këtij vendi, duhet të punojmë në promovimin e paqes, përhapjen e vëllazërisë dhe tolerancës, larg konflikteve dhe luftërave, gjithherë të gatshëm për t'i konsoliduar vlerat e vëllazërisë dhe bashkëjetesës njerëzore.

Le të mbetet kjo festë simbol i sakrificës, shërbimit dhe bindjes ndaj Zotit të Plotfuqishëm, me thirrjen për qytetarët që të frymëzohen nga kuptimet e unitetit, dashurisë dhe paqes, e larg urrejtjes e përçarjeve.

Vëllezër dhe motra,

Kryerja e haxhit dhe therja e kurbanit janë dy rituale kyçe, të cilat i japin domethënie dhe ia shtojnë vlerën festës së Kurban Bajramit. Haxhi është një ndër veprat më të mira të Zotit i Madhëruar pas besimit. Muhamedi a.s., ka thënë:

“Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim përveç Xhenetit.”

Therja e kurbanit është përkujtim i ngjarjes së Ibrahimit a.s., me birin e tij, Ismailin, dhe hedijen që ia dërgoi Zoti Ibrahimit a.s.. Në shenjë të kësaj, të përkujtimit të synetit të Ibrahimit a.s., edhe ne sot therim kurban.

Zoti xh.sh. thotë: *“Prandaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!”* (El Kevther, 3).

Nuk ka dyshim se kjo festë e çmuar dhe e shtrenjtë për shpirttrat dhe zemrat e myslimanëve, bart brenda vetes shumë kuptime të mëdha të besimit, por mbi të gjitha, kjo është një festë, në të cilën kuptimet e sakrificës dhe shpagimit, janë respektimi i sinqertë dhe besnik i vullnetit të Zotit të Madhëruar.

Qëndrimi i haxhilerëve në rrafshnaltën e Arafatit, është shprehja më elokuede e unitetit të myslimanëve dhe një mishërim i gjallë i kuptimeve të përkushtimit ndaj mësimëve të larta islame. Ky është një thellim praktik i virtyteve dhe vlerave të lavdërueshme njerëzore, të mbushura me unitetin e ndjenjave shpirtërore dhe konfirmim i së vërtetës dhe i barazisë.

Atmosferën e pastër shpirtërore që sjellë në jetën tonë gëzimi i Kurban Bajramit, dhe ndjenjat sublime që ai krijon, pastrojnë zemrat dhe shpirtrat e besimtarëve. Ato krijojnë një gjendje shërimi e gatishmërie, që kërkojnë rishikim dhe vlerësim për të nxjerrë mësim dhe leksione prej tyre, për të rishikuar me përgjegjësi veten e tij, në mënyrë që të shmangët urrejtja e përjashtimi.

Kurban Bajrami është një rast i madh dhe unik, nga i cili frymëzohemi dhe mësojmë prej tij vlerat më të larta të sakrificës dhe shpërblimit. Prej tij nxjerrim kuptimet më të larta të mëshirës, besnikërisë, kënaqësisë dhe nënshtrimit

ndaj Zotit të botëve, për të ndjekur udhëzimet e vulës së të dërguarve, mësuesit tonë, Muhamedit a.s..

Duke përtërirë besëlidhjen e dhënë Zotit xh.sh., ne zotohemi të përhapim vlerat e dashurisë, qytetërimit, tolerancës dhe harmonisë. Me këtë besëlidhje ne jemi dakord që ta forcojmë komunikimin, solidaritetin dhe bashkëpunimin në drejtësi e devotshmëri, nga besimi e deri te shpresa.

Nuk ka dyshim se jemi të vetëdijshëm për sfidat që e rrethojnë vendin dhe popullin tonë, por besimi te Zoti dhe besimi ynë i fortë dhe i sinqertë në vullnetin e popullit tonë, na shtyn të punojmë së bashku për t'i kapërcyer këto sfida dhe për të arritur sigurinë dhe promovimin e paqes dhe stabilitetit.

Edhe njëherë, urime kjo festë e bekuar e Kurban Bajramit për të gjithë besimtarët brenda dhe jashtë Kosovës!

*Myftiu Naim ef. Tërnavë
Prishtinë, më 15 qershor 2024*

MYFTIU TËRNAVA PA NGA AFËR PUNIMET NË NDËRTIMIN E XHAMISË QENDRORE NË PRISHTINË

Më 15 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, në prag të festës së Kurban Bajramit, pa nga afër punimet në ndërtimin e Xhamisë Qendrore në Prishtinë.

Myftiu Tërnavë, nga përgjegjësit e ndërtimit, u njoh me ecurinë dhe zhvillimin e punimeve.



BESIMTARËT MYSLIMANË FESTUAN FESTËN E KURBAN BAJRAMIT

Më 16 qershor 2024, besimtarët myslimanë festuan festën e Kurban Bajramit, festë kjo e cila vije pas kryerjes së haxhit. Kjo feste simbolizon sakrificën e besimtarëve ndaj Zotit dhe humanitetin mes njëri-tjetrit.

Ceremonia kryesore e faljes së namazit të Bajramit u mbajt në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, me mesazhe për paqe, solidaritet, harmoni dhe dashuri ndaj njëri-tjetrit.

Ceremonia filloi me faljen e namazit të sabahut, të cilit i priu Sami ef. Fetahu, ndërsa ligjëratën kushtuar festës së Kurban Bajramit e mbajti Hetem ef. Sopjani. Namazit të Kurban Bajramit i priu kryeimami i Prishtinës, Burhanudin ef. Hashani, ndërsa hytben e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë.

“Sot është ditë feste e gëzimi për të gjithë besimtarët myslimanë. Në këto ditë fisnike, janë ditë që bashkojnë zemrat e të gjithë besimtarëve gjithandej, ku do që janë, për të përjetuar me shpirt gëzimin e harenë dhe duke e falënderuar Allahun për begatitë dhe të mirat që na i ka dhuruar Ai. Kjo është festë që i afron rreth sofrës familjet dhe të afërmit e tyre. E mbi të gjitha, festa e Kurban Bajramit është këshillë dhe rikujtim i mësimave dhe porosive hyjnore, të cilat e ndihmojnë besimtarin për organizimin e jetës në këtë botë dhe për të qenë faqebardhë e të shpëtuar në botën tjetër. Kjo, ashtu siç është festë në Tokë, po ashtu është festë edhe në qiell. Po, po! Sepse, krahas njerëzve, festojnë edhe engjëjt – krijesa të të Gjithëmëshirshmit Allah”, tha gjatë ligjëratës Hetem ef. Sopjani.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në këtë hytbe potencoi rëndësinë e kryerjes së haxhit si shtyllë e Islamit si dhe rëndësinë e therjes së kurbanit.

“Zoti i Madhëruar i ka caktuar dy festa fetare për robërit e tij myslimanë,



Fitër Bajramin dhe Kurban Bajramin. Ai i ka ligjësuar ato për vendime dhe kuptime të mëdha, përfshirë këtu edhe falënderimin dhe lavdërimin e Tij. Ne festojmë Kurban Bajramin dhe jemi të lumtur, falënderojmë Zotin e Madhëruar për gjithçka që na ka dhuruar dhe gjithçka që do të na dhurojë në të ardhmen.


Kryerja e haxhit dhe therja e kurbanit janë dy rituale kyçe, të cilat i japin domethënie dhe ia shtojnë vlerën festës së Kurban Bajramit. Haxhi është një ndër veprat më të mira të Zotit i Madhëruar pas besimit. Muhamedi a.s., ka thënë: “Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim përveç Xhenetit”, tha ai.

Myftiu Tërnavë nga kjo hytbe përçoi mesazhet e tij për paqe në gjithë botën, duke shtuar se dashuria ndaj atdheu është simbol i identitetit, historisë dhe krenarisë.

“Shprehja e dashurisë për atdheun në lutjet e përditshme, është një ndjenjë e natyrshme, e lindur në brendësinë shpirtërore, dhe që rritet me rritjen tonë. Ajo na jep ndjenjën se asgjë nuk krahasohet me ngrohtësinë e tokës ku jemi krijuar

dhe ushqyer. Dashuria ndaj atdheut është një dhuratë e pashtershme, është simbol i identitetit, historisë, qytetërimit e krenarisë, prandaj themi se është detyrë jona që ta duam, ta ruajmë dhe ta mbrojmë vatanin tonë. Në këtë mënyrë bëhemi qytetarë të një vendi ku jetohet me dinjitet, e për t’u bërë të tillë, kërkohet që të jemi bashkë, t’i qëndrojmë besnikë atdheut, duke e promovuar atë në të gjitha fushat dhe në çdo vend, por edhe në Mekën e largët.”

Festa e Kurban Bajramit për besimtarët myslimanë vije pas kryerjes së obligimit të haxhit, ku edhe nga Kosova shumë besimtarë po kryejnë këtë obligim. Ndërsa që nga falja e namazit të Bajramit besimtarët myslimanë therin kurban për tri ditë me radhë.



BIK-U HAPI DYERT PËR FESTËN E KURBAN BAJRAMIT

Më 16 qershor 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ashtu sikurse edhe herëve të tjera, tradicionalisht hapi dyert e selisë për të pranuar urimet me rastin e festës së Kurban Bajramit.

Liderë shtetëror, fetarë, politikë, ambasadorë dhe përfaqësues të tjerë vizituan sot selinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, me ç'rast uruan Myftiun e Kosovës, Naim ef. Tërnavë dhe gjithë besimtarët myslimanë për festën e Kurban Bajramit.

Festa e Kurban Bajramit, vije pasi haxhilerët nga e mbarë bota kryejnë kushtin e pestë të Islamit – haxhin.



Kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti me bashkëpunëtorë



Nënkryetaria e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci me bashkëpunëtorë



Kryetari i LDK-së, z. Lumir Abdixhiku me bashkëpunëtorë



Përfaqësuesi i PDK-së, z. Bedri Hamza me bashkëpunëtorë



Kryetari i AAK-së, z. Ramush Haradinaj me bashkëpunëtorë



Ambasadori i Turqisë në Kosovë, z. Tunç Angli



Përfaqësuesi i Kishës Katolike, z. Agim Qerkini

MYFTIU TËRNAVA VIZITOI PËR NGUSHËLLIME FAMILJEN E HAXHI MUHARREM GASHIT

Më 18 qershor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, qëndroi për vizitë

ngushëlluese në familjen e haxhi Muharrem Gashit, i cili ndërroi jetë gjatë qëndrimit në Qabënë e bekuar, ku kishte shkuar për ta kryer haxhin.

Myftiu Tërnavë tha se vdekjet e tilla si e haxhi Muharremit, janë për t'u lakmuar, andaj ne lusim Zotin e Madhëruar, që rahmetliun ta ketë marrë në mëshirën e Tij, t'ia ketë falur mëkatet, ta gradojë me Xhenet, si dhe ta ngjallë me pejgamberët, dëshmorët dhe njerëzit e mirë.

“Ne si besimtarë jemi të bindur në caktimin e Zotit për momentin e dorëzimit të shpirtit. Prandaj edhe ne, bashkë me ju familjarët, kemi ndër dhimbje e mërzi për vdekjen e familjarit tuaj” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Familjarët e rahmetliut e falënderuan Myftiun Tërnavë për vizitën, si dhe gjithë udhëheqësit e haxhit, për kujdesin dhe trajtimin e veçantë që kanë pasur për babanë e tyre.



DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMËT MUSTAFA DHE RAQI

Më 13 qershor 2024, drejtori për Diasporë i Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, priti në takim imamin e Qendrës Islame “Dituria” në Landskrona të Suedisë, Burhan ef. Mustafën. Ndërsa më 24 qershor 2024, priti në takim imamin e Xhamisë Shqiptare “Drita” në Vanta të Finlandës, Sami ef. Raqi.

Gjatë këtyre takimeve, drejtori Simnica, shfrytëzoi rastin që t'i njoh ata me ecurinë e punëve dhe zhvillimeve në Bashkësinë Islame të Kosovës, si dhe për bashkëpunimin që kanë me qendrat islame në diasporë. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton që të kenë edhe më tutje bashkëpunim në të gjitha fushat me rëndësi për besimtarët myslimanë.

Nga ana e tij, imami Burhan Mustafa falënderoi për pritjen dhe më pas falënderoi drejtorin Simnica për bashkëpunimin e deritanishëm që ka pasur ai dhe institucioni i BIK-ut me qendrat islame në diasporë, e në veçanti me xhaminë “Dituria” në Landskrona në Suedi. Ai gjatë kësaj vizite, dorëzoi edhe një sasi të vitrave të tubuara gjatë muajit Ramazan nga mërgata jonë.

Po ashtu edhe imami Sami ef. Raqi, e falënderoi drejtorin Simnica për bashkëpunimin e deritanishëm që ka pasur ai dhe institucioni i BIK-ut me qendrat islame në diasporë, e në veçanti me Xhaminë “Drita” në Vanta në Finlandë, si xhami e hapur rishtazi. Ai gjatë kësaj vizite, dorëzoi edhe një sasi të vitrave të tubuara gjatë muajit Ramazan dhe përmbushi porosinë e kurbaneve nga mërgata jonë.



SHPËRNDARJA E MISHIT TË KURBANIT 2024

Më 29 qershor 2024, Bashkësia Islame e Kosovës përmes Shoqatës Humanitare "Bereqeti" ka filluar me shpërndarjen e mishit të kurbanit. Afër 20 ton mish kurban ka arritur me kontingjentin e parë, e të cilët menjëherë është shpërndarë në komuna të ndryshme, te familjet nevojtare.

I gjithë procesi, që nga therja në ditët e Kurban Bajramit dhe deri te shpërndarja e tij është monitoruar nga ekipi i veçantë i Bashkësisë Islame të Kosovës, duke bërë kështu që kurbanit t'i plotësojë të gjitha normat fetare.

Këtë proces e pa nga afër edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili falënderoi gjithë besimtarët për besimin e dhënë për therjen e këtyre kurbaneve, duke lutur Zotin që t'ua ketë pranuar sakrificën.

Gjatë javës në vijim pritet të vijë edhe pjesa e tjetër e mishit të kurbanit, ku pjesa më e madhe do t'i dedikohet rasteve të ndjeshme në Kosovë. Ky mish kurban që erdhi të shtunën në mesditë, u shpërnda menjëherë gjatë ditës së sotme në Prizren, Dragash dhe Vushtrri, ndërkohë që pandërprerë përgjatë gjithë javës së ardhshme, aksione për shpërndarjen e mishit do të zhvillohen në gjithë Kosovën.

Afër 20 mijë kurbane janë therur nën organizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës për Kurban Bajram, duke përmbyllur kështu obligimin e tyre përmes institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës.



DITURIA ISLAME • Nr. 404 KORRIK 2024